

# RAPORTI I VETËVLERËSIMIT PËR AKREDITIMIN INSTITUCIONAL

Universiteti i Vlorës

"Ismail Qemali"

Maj 2020





# Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë

**FORMATI I RAPORTIT TË VETËVLERËSIMIT PËR AKREDITIMIN INSTITUCIONAL**

GRUPI I VETËVLERËSIMIT :

1. PhD Enkelejd A. Mëhilli Kryetar
2. Prof. Assoc. Kristofor Lapa Anëtar
3. PhD Sokol Bana Anëtar
4. Dr. Blenard Xhaferi Anëtar
5. Dr. Fatjona Kamberi Anëtar
6. Dr. Ilda Kanani Anëtar
7. Dr. Jonada Zyberaj Anëtar
8. Dr. Lorena Alikaj Anëtar
9. Jenila Zenelaj Anëtar (Student)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"
VLORË

Data: 18/05/2020

# Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë

## FORMATI I RAPORTIT TË VETËVLERËSIMIT PËR AKREDITIMIN INSTITUCIONAL

GRUPI I VETËVLERËSIMIT :

| | | | |
|---|---|---|---|
| 1. | PhD Enkelejd A. Mëhilli | Kryetar | Firma |
| 2. | Prof. Assoc. Kristofor Lapa | Anëtar | Firma |
| 3. | PhD Sokol Bana | Anëtar | Firma |
| 4. | Dr. Blenard Xhaferi | Anëtar | Firma |
| 5. | Dr. Fatjona Kamberi | Anëtar | Firma |
| 6. | Dr. Ilda Kanani | Anëtar | Firma |
| 7. | Dr. Jonada Zyberaj | Anëtar | Firma |
| 8. | Dr. Lorena Alikaj | Anëtar | Firma |
| 9. | Jenila Zenelaj | Anëtar (Student) | Firma |

Data: 18/05/2020

**Përmbajtja**


1 Hyrje në procesin e Vetëvlerësimit 3

2 Historiku i IAL 5

3 Shkurtimet 7

1 FUSHA E VLERËSIMIT: ORGANIZIMIN DHE MENAXHIMI I INSTITUCIONIT 9

2 FUSHA E VLERËSIMIT: BURIMET 23

3 FUSHA E VLERËSIMIT: KURRIKULA 35

4 FUSHA E VLERËSIMIT: MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KËRKIMI 44

5 FUSHAT E VLERËSIMIT: STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE 55

Përfundimet dhe vlerësimi përgjithshëm 65

Lista e evidencave mbështetëse të IAL-së 67


REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

## 1 Hyrje në proçesin e Vetëvlerësimit

Universiteti "Ismail Qemali" i Vlorës vjen në proçesin e akreditimit institucional pas një eksperince të suksesshme tre vite më parë, ku Institucioni me Vendim Nr.71 datë 21.09.2017 u akreditua për një periudhë kohore tre vjeçare nga Bordi i Akreditimit i ASCAL. Proçesi i akreditimit është në vazhdimësi të kësaj eksperince dhe synon plotësimin e standardeve të cilësisë nga UV. Me qëllim një funksionim të suksesshëm dhe arritjen e rezultateve të kënaqshme në punën e tij UV bazohet në standardet e cilësisë të përcaktuara nga legjislacionin në fuqi.

Për të monitoruar zbatimin e standardeve të cilësisë u hartua raporti i vlerësimit të brendshëm në përputhje me kriteret dhe standardet e parashikuara. Hartimi i këtij raporti realizohet nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm - GVB të Institucionit.

GVB është ngritur me Vendim Rektorati Nr 11. datë 06.12.2019 dhe u riorganizua më vonë në përbërjen aktuale të tij me vendim Nr 11/1 datë 19.12.2019. Në ngritjen e GVB dhe në përzgjedhjen e anëtarëve të tij Rektorati mori parasysh eksperiencën e mëparshëm të anëtarëve si dhe në rezultatet e kënaqshme të punës së këtij grupi. Në përbërjen e GVB-së u pa e arsyeshme të ishin pjesëmarrës edhe dy zëvendës rektorët e institucionit për të lehtësuar punën dhe ndihmuar në koordinimin me njësitë, drejtoritë dhe sektorët e UV. GVB-ja në përbërjen e tij ka përfaqësues nga të katër fakultetet e Institucionit dhe po ashtu përfaqësues nga studentët. Nga momenti i ngritjes së tij e në vazhdim anëtarët e grupit, janë koordinuar duke bashkërenduar punën ndërmjet tyre. Për hartimin e raportit u ndoqën këto faza:

a. Grupi i punës me qëllim lehtësimin e punës bëri një ndarje të secilës fushë për çdo anëtar. Kuptohet që kjo ndarje nuk ishte ezauruese pasi çdo fushë dhe çdo dokument i administruar diskutohej së bashku nga të gjithë anëtarët.

b. Fillimisht u studiuan standardet e cilësisë dhe kriteret përcaktues të këtyre standardeve për cdo fushë.

c. Takimet me drejtoritë dhe sektorët ishin një tjetër proçedurë, që u ndoq nga grupi i punës, me qëllim që të merrej informacioni i nevojshëm nga çdo instance dhe për çdo fushë.

d. Mbledhja e dokumentacionit dhe diskutimi i çdo dokumenti të administruar nga të gjithë anëtarët e grupit të punës.

e. Hartimi i pjesës narrative të raportit duke përputhur çdo kriter me evidencat përkatëse që ilustrojnë përmbushjen e tij.

**Etapat e proçedurës së vlerësimit të brendshëm nga IAL**

1. Aplikimi në Agjencinë e Sigurimit të Cilesisë në Arsimin e Lartë për aplikim për fillimin e procesit të vlerësimit të jashtëm institucional;

2. Ngritja e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm nga Rektorati;

3. Trajnimi i GVB nga stafi i ASCAL në kuadër të Akreditimit Institucional për proçesin në tërësi dhe për çdo paqartësi të mundshme: për këtë janë vendosur në dispozicion materialet

udhëzuese për vlerësimin, organizimin e grupit, detyrat, të drejtat dhe përgjegjësitë e secilit;

4. Kryerja e vlerësimit të brendshëm sipas udhëzimeve përkatëse të ASCAL;

5. Përgatitja e dosjes së vetëvlerësimit;

6. Hartimi i raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB) sipas udhëzimeve dhe pas konsultimit të përmbajtjes së tij me stafin e institucionit;

7. Dorëzimi në ASCAL i Raportit të Vlerësimit të Brendshëm me të gjithë dokumentacionin mbështetës.

Në kuadër të rekomandimeve të kaluara, UV ka ndërrmarë një sërë hapash me qëllim përmbushjen e tyre.

Për rekomandimin nr. 1 UV ka hartuar udhëzues specifik për implementimin e metodave inovative në mësimdhënie, ka nënshkruar marrëveshje në nivele të ndryshme (ndërinstitucionale, KA1 etj) me qëllim mobilitetet e stafit akademik, administrativ dhe studentëve, është antarësuar në rrjete ndërkombtare si dhe ka mbështetur stafin për të kryer vit sabatik.

Për rekomandimin nr. 2 janë rikonstruktuar godina të ndryshme të Institucionit (psh. Godina A, Godina B, Rektorati), ka filluar proçesi për ndërtimin e një godine të re për Fakultetin e Shëndetit Publik si dhe është marrë me qera një Godinë me qëllim zhvillimin e aktivitetit mësimor nga FSHP. Paralelisht, çdo Fakultet ka biblotekën e vet (përveç FSHP) ndërsa pajisje elektronike u janë shpërndarë Fakulteteve sipas nevojave.

Për rekomandimin nr. 3, UV ka ngritur Njësinë e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional.

Për rekomandimin nr. 4, UV ka filluar një metodë më efektive në monitorimin e të diplomuarve të vetë dhe paralelisht ka zhvilluar takime me stakeholdersa lokal.

Për rekomandimin nr. 5, UV ka ngritur Këshillin studentor.

Për rekomandimin nr. 6, UV ka ndërrmarë një sërë masash për inkurajimin dhe pjesëmarrjen e stafit akademik në aktivitete kërkimore shkencore si dhe ka organizuar ose ka qenë bashkorganizator në konferenca kombëtare/ndërkombëtare.

Të gjitha këto prezantohen në detaje tek materiali në vijim.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"
VLORË

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

## 2 Historiku i IAL

Universiteti i Vlorës u themelua më 10 tetor 1994, me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.105, datë 28.02.1994. Për hapjen e tij u bë një punë disa mujore për përgatitjen e planeve, programeve dhe përzgjedhjen e stafit akademik. Ndihmesë shumë të madhe në këtë proçes kanë dhënë Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë dhe Mjekësisë të Tiranës. Universiteti filloi aktivitetin me tre fakultete: Fakultetin e Tregtisë (me degët Biznes dhe Turizëm), Fakultetin e Inxhinierisë Detare dhe Infermierisë. Përzgjedhja e këtyre fakulteteve u bë mbi bazën e traditës që ekzistonte në Vlorë për këto disiplina. Në vitin 1919 në qytetin e Vlorës është hapur shkolla e mesme Tregtare. Tradita e saj u pasurua kur në Vlorë u hap filiali i Universitetit të Tiranës për degën e Ekonomikut i cili funksionoi në vitet 1970-1980. Në vitin 1960 në Vlorë filloi funksionimin Shkolla e Lartë e Marinës, tradita e të cilës shërbeu si bazë për Fakultetin e Inxhinierisë Navale (sot Fakulteti i Shkencave Teknike). Mbi traditën e Shkollës së Mesme Mjekësore, hapur në 1967 (e vetmja në vendin tonë), u ngrit Fakulteti i Infermierisë (sot Fakulteti i Shëndetit Publik). U krijua një grup pune i drejtuar nga Dr.Sezai Bazaj i cili më pas u emërua dhe Rektori i universitetit. Universiteti filloi punë në dy godina me 162 studentë në të katër degët e tij. Stafi akademik përbëhej nga 10 pedagogë të brendshëm dhe 31 pedagogë të jashtëm të përkushtuar. Në fillimet e tij emërtimi i universitetit ishte "Universiteti Teknologjik Ismail Qemali" Vlorë. Prej vitit 2007 universiteti mban emërtimin Universiteti "Ismail Qemali" i Vlorës, shkurt UV. Universiteti filloi të rritej në programet e studimit që ofronte, në numrin e studentëve dhe të stafit akademik. UV duke ju përshtatur kërkesave të komunitetit për formimin e specialistëve të ndryshëm, duke u fokusuar në jugun e Shqipërisë, filloi të ofrojë larmishmëri programesh studimi si Gjuhët e huaja, Mësuesi, Teknologji Informacioni, Inxhinieri Elektrike, Shkenca Navigacionale, Drejtësi, Inxhinieri Mekanike etj. Prej vitit akademik 2005-2006, në UV filloi ristrukturimi i programeve të studimit në përputhje me kërkesat e proçesit të Bolonjës si dhe të krediteve ECTS. Në historinë e tij 25 vjeçare UV ka përdorur në mënyrë efektive burimet njerëzore dhe logjistike të institucionit dhe ka bërë hapa në përmirësimin e vazhdueshëm të infrastrukturës dhe rritjen e kapaciteteve. Proçesi i mësimdhënies në të gjitha programet e studimit kryhet në mjediset universitare Godina A, B dhe C si dhe godina D që përfshin ambjente të marra me qera për zhvillimin e proçesit mësimor të Fakultetit të Shëndetit Publik. Aktualisht, UV ofron programe studimi të të tre cikleve (bachelor, master dhe doktoraturë). UV ofron 27 programe të ciklit të parë të studimeve Bachelor (6 në FE, 11 në FSHT, 8 në FSHH dhe 2 në FSH), 33 programe te ciklit të dytë të studimeve (20 master profesional dhe 13 master shkencor) si dhe programin e ciklit të tretë të studimeve "Doktoraturë në Matematikë". Në UV aktualisht në mësimdhënie është angazhuar 276 personel akademik i kualifikuar, nga të cilët 208 staf me kohë të plotë dhe 67 staf me kohë të pjesshme dhe të ftuar. 14 anëtarë të stafit mbajnë gradën Prof.Dr., 36 Prof.Asoc., 125 Dr., dhe 100 Msc. Tashmë në organikën e vetë UV numëron katër fakultete, katër qendra kërkimore shkencore dhe një qendër ndërdisiplinore. Përveç stafit akademik në ofrimin e shërbimeve cilësore të studentëve dhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies është i angazhuar dhe personeli ndihmësakademik (41 në nivel institucioni me karakter administrativ dhe 15 në nivel njësie bazë me karakter mësimor) dhe administrativ (35 në nivel institucioni, 23 në nivel njësie bazë dhe kryesore). Ndërkohë që numri i studentëve që ndjekin studimet në UV që nga koha e themelimit ka pësuar rritje. UV tashmë është një institucion i madh i arsimit të lartë me më shumë

se 14 500 studentë të diplomuar deri më tani. Për vitin akademik 2018-2019 në UV u regjistruan gjithsej 1049 studentë të rinj kryesisht nga jugu i Shqipërisë por nuk mungojnë dhe studentë nga Kukësi, Skrapari, Gramshi etj. Që nga koha e themelimit të tij UV ka pasur traditë organizmin e veprimtarive kërkimore shkencore të fushave të ndryshme. Konferenca e parë shkencore në nivel kombëtar u organizua në 1996 mbi "*Arritjet në fushën e Kirurgjisë*". Në 2002 me iniciativën e Ambasadës Italiane u zhvillua konferenca e parë shkencore ndërkombëtare "*Mbi turizimin alternativ dhe të qendrueshëm*". Përgjatë viteve në UV nuk kanë munguar veprimtaritë shkencore. Përmendim konferencën shkencore ndërkombëtare *"New Challenges in Digital Communication"* e mbështetur nga NATO Advance Study Institute (2008), *"Financial Callenges and Economic Prespectives"* (2009), *"Application of Computer Algebra, ACA"* (2010), *"Free Sofware in Balcans"* (2010) etj. Tashmë, në vazhdim të traditës, UV është një Institucion i arsimit të lartë i orientuar drejt kërkimit shkencor. Kërkimi në UV synon të mbështesi mësimdhënien dhe mësimnxënien në funksion të rritjes së cilësisë duke inkurajuar stafin dhe studentët për të qënë aktiv në fushën e kërkimit shkencor duke u ofruar mbështetje financiare, organizim të konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare për të promovuar punën kërkimore dhe dijet e reja. Stafi akademik i UV boton artikuj në revista ndërkombëtare me bord editorial, të indeksuara dhe me faktor impakti me seli botimi në vendet e Bashkimit Evropian (BE) dhe Organisation for Economic Co-operation and Development (OECD). Në historinë e tij 25 vjeçare UV ka vijuar përpjekjet e tij për bashkëpunime të vazhdueshme me shumë universitete të Rajonit, Evropiane dhe të SHBA-ve. Në sajë të këtyre marrëveshjeve, kryesisht në kuadër të programeve Erasmus + KA 107, UV ka arritur të jetë përfitues i një numri të konsiderueshëm shkëmbimesh të stafit akademik, ndihmësakademik/administrativ dhe të studentëve. Gjithashtu, UV është anëtarë i disa rrjeteve universitare si EUCEN, ASECU, BLACK-SEA, ENSP, CMU si dhe prej 22 mars 2019 është anëtar i Magna Charta Observatory. Tashmë, UV ka përvojë të gjerë në implementimin dhe menaxhimin e fondeve për projekte të ndryshme ku është identifikuar si një partner i drejtë dhe i besueshëm. UV aktualisht është partner në projektet vijuese: *"Reconnecting universities and enterprises to unleash regional innovation and entrepreneurial activity"* – (KNOWHUB), "*Sustainable development of Blue economies through higher Education and innovation in Western Balkan Countries*" – BLUEWBC, "*Reforming doctoral studies in Montenegro and Albania*"- (MARDS), "*Blue Growth and curriculum development of Marine Fishery in Albania*"- (ALMARS) "*Developing teacher competencies for a comprehensive VET system in Albania*" – (TEAVET) etj. Në funksion të ruajtjes dhe rritjes së vazhdueshme të cilësisë në mësimdhënie, mësimnxënie dhe kërkim shkencor UV i është nënshtruar akreditimit periodik institucional dhe të programeve të studimit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

**Shkurtimet**

| | |
|---|---|
| Agjencia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë | **ASCAL** |
| Bordi i Administrimit | **BA** |
| Drejtoria Rajonale e Shëndetit Vlorë | **DRSH Vlorë** |
| Drejtorinë e Përgjithshme e Pronave Intelektuale | **DPPI** |
| Drejtorisë së Edukimit për Ciklin e I-rë dhe të II-të | **DECI/II** |
| Drejtorisë së Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore. | **DKBNJ** |
| Drejtorisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit Institucional | **DSBCZI** |
| Fakulteti i Ekonomisë | **FE** |
| Fakulteti i Shëndetit Publik | **FSHP** |
| Fakulteti i Shkencave Humane | **FSHH** |
| Fakulteti i Shkencave Teknike | **FSHT** |
| Grupi i Vlerësimit të Brendshëm | **GVB** |
| Grupi i Vlerësimit të Jashtëm | **GVJ** |
| Institucione të Arsimit të Lartë | **IAL** |
| Këshilli i Etikës | **KE** |
| Këshilli Studentor | **KS** |
| Komisionet e marrëdhënieve me studentet për çdo Fakultet | **KMSF** |
| Komisionet e Sigurimit të Cilësisë së Brendshme për çdo Fakultet | **KSBCF** |
| Komisioni i dhënies së gradës shkencore "Doktor" | **KDGD** |
| Komisioni i marrëdhënieve me studentët në nivel institucional | **KMSI** |
| Komisioni i Sigurimit të Cilësisë së Brendshme në nivel institucional | **KSBCI** |
| Korniza Shqiptare e Kualifikimeve | **KSHK** |
| Menaxhimi i Sistemeve të Informacionit | **MIS** |
| Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë | **MASR** |
| Njësinë e Auditimit të Brendshëm të Cilësisë | **NJABC** |
| Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional | **NJSBC** |
| Qendra e Shërbimeve Arsimore | **QSA** |
| Qendra Kërkimore Shkencore | **Q.K.SH** |
| Qendra Studimore Ndërdisiplinore e Zhvillimit Rajonal | **RDC** |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

| | |
|---|---|
| Sektori i Financës dhe Realizimit të Buxhetit | **SFRB** |
| Sektori i Këshillimit të Karrierës, ALUMNIT dhe aktiviteteve kulturore-sportive | **SKKAAK** |
| Sektori i Kurrikulave edhe Shërbimit ndaj Studentit | **SKSHS** |
| Sektori i Tekonologjia së Informacionit | **IT** |
| Sektori i Promovimit Akademik dhe Botimeve Shkencore | **SPABS** |
| Senati Akademik | **SA** |
| Sistemi i informacionit i UV-së | **UVMS** |
| Standardi Europiani Kualifikimit të Kompetencave/Aftësive profesionale dhe Punësimit | **ESCO** |
| Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim | **SKZHI** |
| Sustainable Development Goals | **SDG** |
| Universiteti "Ismail Qemali" i Vlorës | **UV** |
| Urdhëri i Infermierit të Shqipërisë | **UISH** |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

# 1 FUSHA E VLERËSIMIT: ORGANIZIMIN DHE MENAXHIMI I INSTITUCIONIT

| Autonomia |
|---|
| **Institucioni dhe strukturat e tij funksionojnë në përputhje me statutin e institucionit.** *(Kreu III Standardi I.1)*<br><br>Universiteti "Ismail Qemali" i Vlorës (UV) ka miratuar një Statut të ri i cili është në përputhje me Ligjin e Arsimit të Larte 80/2015 [E1.1]. Satuti është miratuar nga Senati Akademik (SA) [E1.2], Bordi i Administrimit (BA) [E1.3] dhe nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) [E1.4]. Statuti është përmirësuar dhe përshtatur me qëllim të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet nënligjore. Për shkak të vonesës së miratimit të Statutit nga MASR, UV ka funksionuar me rregulloren ekzistuese në rastet kur ajo nuk binte në kundërshtim me Ligjin [E1.5]. Paralelisht, ajo është përditësuar në bazë të ligjit të arsimit të lartë dhe pas daljes së akteve nënligjore [E1.6 Fq. 51-61]. Pas miratimit të Statutit nga MASR, UV ka ngarkuar zyrën Juridike për hartimin e rregullores së re. Senati i UV ka miratuar një rregullore të brendshme të re [E1.7]<br>Rregullorja e re përbëhet nga 135 nene [E1.7] ndërsa Statuti [E1.1] nga 94 nene [E1.1]. Fakultetet dhe Departamentet e UV funksionojnë në përputhje me Statutin si dhe në Bazë të Rregulloreve të tyre. Secili Fakultet ka Rregulloren e vet si dhe çdo Njësi Bazë ka rregullore të miratuar [E1.8.-E1.10]. Rregulloret e Njësive Kryesore [E1.11-E13] dhe atyre Bazë janë të miratuara nga SA [E1.14-E1.17]. Qëndrat Kërkimore kanë Rregulloret e tyre të miratuara dhe ato nga SA [E1.18-E1.19]. |
| **Institucioni organizohet në mënyrë të tillë që të sigurojë efiçiencë në menaxhim.** *(Kreu III Standardi I.2)*<br><br>Institucioni menaxhohet efektivisht nga organet kompetente. Ai ka autonomi akademike, financiare dhe vetorganizative. Organet kryesore drejtuese të UV janë SA, BA, Rektorati, Dekanati, Këshilli i Etikës dhe Komisionet e Përhershme. Të gjitha kompetencat dhe detyrimet e organeve drejtuese janë të përcaktuara qartë në Ligjin e Arsimit të Lartë si dhe ne Statutin e UV [E1.1]. Neni 19 i Statutit të UV [E1.1] përcakton qartë funksionet e SA i cili miraton paraprakisht buxhetin vjetor dhe afatmesëm dhe ia përcjell BA për miratim. SA mblidhet periodikisht për të diskutuar çështje të rëndësishme institucionale që kanë të bëjnë me edukimin, kërkimin shkencor edhe/ose çështjet financiare. SA ka rregulloren [E1.21] e vet dhe është i detyruar të mblidhet të paktën një herë në muaj (Rregullore SA neni 6). Gjatë 3 viteve të fundit, SA ka marrë më shumë se 315 vendime (65 vendime në 2020, 65 vendime në 2019, 84 vendime në 2018 dhe 103 vendime në 2017) https://univlora.edu.al/komisionet/. Sipas nenit 40 pika 3a, Administratori i UV përgatit/harton projekt buxhetin vjetor mbi bazën e kërkesave të njësive kryesore dhe njësive bazë, në planin strategjik të UV dhe në bazë të planit buxhetor afatmesëm. Rektorati, harton politikat ekonomike dhe buxhetore të Institucionit duke u bazuar në nevojat e Fakulteteve/Departamenteve si dhe në Planin Strategjik [E1.1, neni 26]. Rektorati është organi kryesor i cili harton dhe paraqet në SA projekt-planin e zhvillimit strategjik të Institucionit si dhe përcakton përparësitë në plotësimin e kërkesave të njësive për financime mbi të cilat hartohet projekt buxheti vjetor. Sektori i Financës dhe Realizimit të Buxhetit (SFRB) asiston në gjithë proçesin e mësipërm. SFRB, mbledh dhe harton projekt buxhetin sipas kërkesave të Njësive Bazë dhe atyre Kryesore. Neni 26, pika 3b, thekson |



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

qartazi që Rektorati është organi që formulon kriteret për shpërndarjen e burimeve financiare, materiale dhe njerëzore. Neni 86 pika 4 e Statutit të UV, thekon se Rektorati i propozon BA ndarjen e të ardhurave të përfituara nga kryerja e shërbimeve/veprimtarive të institucionit me pjesëmarrjen e personelit Akademik [E1.1].

Në strukturën e vet, UV ka ngritur Sektorin e Promovimit Akademik dhe Botimeve Shkencore (SPABS) [E1.22]. Sektori përbëhet nga tre persona (përgjegjësi, specialist për promovimin akademik dhe ciklin e 3-te të studimeve dhe specialist për kërkimin shkencor dhe publikimet). Një nga objektivat kryesore të UV është promovimi i personelit Akademik Me këtë qëllim UV ka miratuar në buxhetin e tij një fond specifik për kërkimin shkencor [E1.23]. Edhe plani i Veprimit në bazë të rekomandimeve të Grupit të Vlersimit të Jashtëm (GVJ) e parashikon këtë [E1.24, E1.25]. Po ashtu, UV ka mbështetur financiarisht mobilitetin dhe pjesëmarrjen e stafit akademik në konferenca/symposziume/aktivitete shkencore jashtë vendit. Për të nxitur promovimin dhe trajnimin e vazhdueshëm të kërkuesve të rinj, UV ka miratuar një strategji specifike për Trajnimin e Vazhdueshëm të Kërkuesve të Rinj [E1.26]. Misioni kryesor i kësaj strategjie është krijimi i një kulture kërkimore shkencore dhe akademike e mbështetur në parimet për kërkimin dhe inovacion e cila bazohet tek Karta dhe Kodi Evropian për Kërkuesit, të cilën UV e ka mbështetur [E1.27].
UV ofron Doktoraturë në Matematikë, çka i mundëson stafit akademik vazhdimin e studimeve doktorale dhe mundësinë për promovim të mëtejshëm. Në Fakultetin e Shkencave Teknike (FSHT) ku ofrohet Doktoratura, UV ka ngritur Komisionin e Dhënies së Gradës Doktor [E1.28] si dhe ka ndërtuar një Rregullore specifike [E1.29]. Një shembull konkret i dhënies së titullit Doktor i Shkencave (nga momenti i ngritjes së jurisë së vlerësimit deri në momentin e marrjes së Diplomës Doktorate) paraqitet tek [E1.30].
Me qëllim promovimin e stafit akademik gjatë periudhës 2017-2019 UV ka organizuar trembëdhjetë (5 në 2017, 3 në 2018 dhe 5 në 2019) konferenca ndërkombtare në bashkëpunim me Universitete prestigjioze Evropiane [E1.31].
Në funksion të promovimit dhe nxitjes është edhe vendimi i SA *"për financimin e botimeve dhe pjesëmarrjes në konferenca shkencore të stafit akademik të universitetit Ismail Qemali", Vlorë"* [E1.32]. Ky vendim nga një anë promovon publikimin në revista prestigjoze me faktor impkti dhe nga ana tjetër rrit konkurencën midis pedagogëve dhe kërkuesve shkencorë të UV.
Me qëllim edhe promovimin e stafit të ri, UV ka miratuar strategjinë e integrimit dhe trajnimit te stafit të ri të rekrutuar [E1.33]. Bazuar në vizionin e kësaj strategjie, synohet rekrutimi i stafit të ri premtues dhe të kualifikuar në përmbushje të misionit, qëllimeve dhe objektivave të UV përmes ofrimit të mundësive të barabarta. Me rastin e 25-vjetorit të themelimit, UV ka promovuar me çertifikata "Nderi" dhe "Mirënjohje" personel akademik, të cilët kanë luajtur një rol kryesor në zhvillimin e Institucionit [E1.34].
Bordi i Aministrimit është organi më i lartë kolegjial Administrativ i cili garanton mbarëvajtjen financiare dhe administrative [E1.1, neni 23]. Kriteret dhe përbërja e BA përcaktohen qartë në ligjin 80/2015, VKM Nr. 782, datë 26.12.2018, Statuin e UV Neni 24 dhe Rregulloren e BA [E1.35]. Disa nga funksionet kryesore të BA janë: garantimi i qëndrueshmërisë financiare, miratimi i planit strategjik, miratimi i buxhetit vjetor, miratimi i numerit të personelit, përcaktimi i rregullave për shpërndarjen e të ardhurave që siguron institucioni nga ushtrimi i veprimtarive të tij, etj. Në detaje funksionet e BA përcaktohen në Statutin e UV Neni 25 dhe Rregulloren e BA neni 4 [E1.1, E1.35].
Në Satutin e UV (Neni 28) është e përcaktuara qartë funksionimi i Këshillit të Etikës (KE) [E1.1]. SA ka miratuar anëtarët e rinj të KE [E1.36]. KE shqyrton çështjet që lidhen me etikën në

veprimtarinë e Universitetit, shprehet me vendim dhe i propozon Rektorit marrjen e masave disiplinore. UV funksionon në bazë të Kodit të Etikës [E1.37] dhe Kodit të Etikës në Kërkim [E1.38]. Sipas Urdhërit të MASR me Nr. 8 datë 14.01.2020, KE i është shtuar edhe kontrolli antiplagjiaturë dhe verifikimi i ligjshmërisë i fitimit të gradës shkencore dhe titullit akademik. SA ka miratuar kriteret dhe standartet antiplagjiaturë [E1.39]. Dekanati është organi më i lartë kolegjial në nivel Njëse kryesore dhe përbëhet nga Dekani (i cili e drejton), zv. Dekani/ët, drejtuesit e njësive bazë dhe administrator i Njësisë Kryesore (nëse ka Njësia). Neni 27 i Statutit [E1.1] të UV paraqet qartë funksionet e Dekanatit. Atje merren vendime dhe propozime të ndryshme dhe i përcillen Rektorit/Rektoratit/SA që kanë të bëjnë me përdorimin e burimeve njerëzore dhe matëriale e më gjerë. Dekanatit diskuton cështje që kanë të bëjnë me programet e studimit, kriteret e pranimit. Dekanati, paraqet në Rektorat planin vjetor, harton dhe miraton paraprakisht rregulloren e brendshme jep lejen etike për të kryer kërkime shkencore etj. [E1.40]. Dekani është autoriteti drejtues i Njësisë Kryesore dhe përfaqsuesi i tij ligjor [E1.1, neni 34, E1.20, E1.41a, E1.41b, E1.41c]. Sipas Rregullores së zgjedhjeve (E1.42 neni 15, 21), Dekani zgjidhet me votë të fshehtë nga personeli akademik me kohë të plotë i njësisë kryesore dhe studentët në masën 10 % (dhjetë për qind) të totalit të përgjithshëm të votave [E1.42]. Sipas ligjit 80/2015 (Neni 45) dhe Statutit të UV (Neni 38) dhe rregullores së zgjedhjeve (Neni 16, 22) drejtuesi i Njësisë Bazë zgjidhet nga personeli akademik me kohë të plotë i njësisë bazë [E1.1, E1.42]. Në bazë të rezultateve të votimeve të zgjedhjeve të 2016 në UV, Komisioni Institucional Zgjedhor (KIZ) ka shpallur fituesit [E1.43]. Pas shpalljes së fituesve nga KIZ, janë emëruar autoritetet drejtuese të UV [E1.44]. Institucioni, ka hartuar dhe miratuar rregulloren e re të zgjedhjeve [E1.45]. UV si Institucion i Arsimit të Lartë ofron studime në të tre ciklet. Për këtë arsye, ka ngritur Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore Doktor pranë Fakultetit të Shkencave Teknike [E1.28]. Për arsye të mos përmbushjes të numërit të akademikëve me titullin Profesor, UV nuk ka ngritur ende Këshillin e Profesorëve.

**Institucioni favorizon debatin konstruktiv.** *(Kreu III Standard I.3)*

bledhet me nismën e kryetarit të tij dhe zhvillon mbledhje të paktën një herë në muaj. Anëtarët e SA njoftohen nga sekretari për datën dhe rendin e ditës në mënyrë elektronike ose shkresore dhe janë të detyruar të konfirmojnë ose jo pjesmarrjen e tyre (Rregullore SA neni 13). Mbledhja drejtohet nga kryetari i SA dhe vetëm në rast mungese objektive mbledhja thirret dhe drejtohet nga nën-kryetari. SA mund të thirret edhe në seancë të jashtëzakonshme me kërkesën e një të tretës së numërit të anëtarëve [E1.21 neni 6]. Organizimi i mbledhjeve bëhet nga sekretari i SA ndërsa dita e mbledhjes dhe lajmërimi i anëtarëve caktohet nga Kryetari. Të gjitha matërialet dhe rendi i ditës vihen në dispozicion të anëtarëve të paktën një ditë para mbledhjes [E1.21, neni 11]. Vetëm në raste emergjente mund të mos ndiqet kjo procedurë. Rendi i ditës propozohet nga Kryetari i SA dhe miratohet në fillim të mbledhjes. Kërkesa për çështje të cilat duhet të futen në rendin e ditës duhet të paraqiten të paktën tre ditë para mbledhjes me shkresë (Rregullore e SA, neni 12). Mbledhja e SA mund të zhvillohet vetëm në rastet kur janë prezent 50% +1 të anëtarëve. Vendimet e SA zbatohen nga Njësitë Bazë dhe Njësitë Kryesore. Në këto raste, Institucioni monitoron, procesin nëse vendimet zbatohen apo jo [E1.46].

**Institucioni respekton kufijtë e autonomisë së tij.** *(Kreu III Standardi I.4)*

UV me vendime të SA ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional (NJSBC) [E1.1 neni 13, E1.22, E1.47]. NJSBC, ka si objektiv rregullimin e

veprimtarisë së strukturave dhe njësive të ngritura në UV në funksion të Sigurimit te Brendshem të Cilësisë [E1.48]. Qëllimi kryesor i Njësisë (Neni 3), është hartimi i politikave dhe ofrimi i shërbimeve cilesore në përputhje me standartet kombëtare dhe ndërkombëtare duke ngritur një sistem efektiv të sigurimit, i cili udhëheq aktivitetet akademike, funksionet administrative dhe financiare në institucion. NJSBC asiston në vlersimin e programeve të studimit (Neni 7) si dhe metodat e instrumentat e vlerësimit (Neni 8). Sipas strukturës së UV [E1.22], NJSBC përbëhet nga tre persona: Përgjegjesi i Njësisë dhe dy specialist (specialisti për raportimin me ASCAL dhe specialist për vlerësimin Institucional).
Institucioni, përveç NJSBC, ka ngritur Njësinë e Auditimit të Brendshëm të Cilësisë (NJABC) [E1.49]. NJABC është në varësi të BA [E1.22]. Ajo përbëhet nga një Përgjegjës, një specialist jurist dhe një specialist ekonomist. Sipas Planit strategjik të Njësisë [E1.50], misioni i saj është *"...të japë siguri të arsyeshme për Titullarin e Universitetit "Ismail Qemali "Vlorë, në mënyrë të pavarur dhe objektive, këshilla për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në Universitet".* Njësia ka hartuar dhe planin e punës për vitet 2019 dhe 2020 dhe është duke e implementuar [E1.51].
Institucion ka punuar shumë për afrimin e Akademikëve më të mirë në Shqipëri si dhe për bashkëpunimin me Institucione e Akademikë/Kërkues shkencor jo vetëm në rajon por edhe më gjerë. Për angazhimin e ekspertëve më të mirë, UV ka ngritur Rrjetin e studiuesve Shqiptarë në Diasporë [E1.52]. Rrjeti në fjalë ka si qëllim rritjen e bashkëpunimit me ekspertë të ndryshëm shqipëfolës të cilët funksojnojnë si ura lidhëse midis Institucioneve [E1.52]. Kjo iniciativë ka si qëllim ndërveprimin e punës akademike dhe asaj shkencore Brenda këtij rrjeti, në dobi të rritjes së cilësisë në Universitet. Këta persona ofrojnë ekspertizën e tyre pa kosto për UV. Me qëllim angazhimin e ekspertëve të Jashtëm, përveç Rrjetit të Diasporës UV ka ngritur dhe Bordin Konsultativ [E1.1 Neni 20]. Ky Bord është organ Kolegjial me qëllim kryesor konsultimin e SA dhe Rektorit për implementimin dhe zbatimin e politikave sa më efikase universitare dhe eksperiencave më të mira perëndimore. SA ka miratuar përbërjen e bordit konsultativ [E1.53]. Në këtë Bord, marrin pjesë 15 Profesorë/kërkues shkencorë të cilët janë të angazhuar në Universitete prestigjoze si Harvard School of Public Health. University of Birmingham, Università di Salento, Università Leonardo Da Vinci, University of Crete etj Me qëllim mirëfunksionimin e UV, SA dhe Rektori mbajnë kontakte me personalitetet dhe miqtë e Institucionit të cilët kanë marrë titullin Doktor Honoris Causa nga UV për konsultime/këshillime në çështje të ndryshme akademike dhe shkencore [E1.54].
Sipas Strategjisë së Zhvillimit dhe Planit Strategjik [E1.55, E1.56] të UV, një nga qëllimet dhe linjat strategjike të zhvillimit është Ndërkombëtarizimi dhe Bashkëpunimi/Partneriteti. Në strukturën e tij, Institucioni ka ngritur Sektorin e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë [E1.1 dhe E1.22]. Ky sektor është pjesë e Drejtorisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit Institucional (DSBCZI) ku janë të angazhuar 3 persona. Përveç përgjegjësit, sektori ka një specialist për marrdhëniet me Jashtë dhe një specialist për hartimin e projekteve. Në kuadër të përfitimit të sa më shumë fondeve Evropiane UV ka hartuar Strategjinë e Ndërkombtarizimit [E1.57]. Vitet e fundit UV ka punuar shumë në procesin e ndërkombtarizimit me qëllim aplikimin e sa më shumë projekteve Evropiane e më gjerë. Çdo vit (2017-2020) numëri i aplikimeve të UV në projekte Evropiane është në rritje [E1.58]. Vetëm në vitin 2020 UV ka aplikuar deri tani në 22 projekte Europiane (ERASMUS+), ndërsa në vitin 2019 UV aplikoi në 33 projekte të huaja dhe në vitin 2018 në 21 të tilla. Një listë e detajuar e projekteve të aplikuara dhe thirrjet specifike prezantohet tek Evidenca [E1.58]. Kjo listë është akoma më e gjatë por këtu duhet të theksohet se nuk janë paraqitur projektet

| |
|---|
| në të cilat pedagogët/kërkuesit shkencor të UV kanë aplikuar por që nuk kanë nevojë për bashkëfinancim. Për momentin UV është duke implementuar 11 projekte me financim nga programet evropiane e më gjerë [E1.59]. UV ka fituar dhe është duke implementuar pesë (5) projekte ERASMUS+, dy (2) INTERREG IPA Cross Border Albania-Greece, një (1) INTERREG Adriatiko-Jonian, një (1) EASME, një (1) projekt të financuar nga Ministria e Jashtme e Norvegjisë dhe një (1) projekt i financuar nga Global Bridges. Arritja e këtyre rezultateve ka ardhur si pasojë e këmbëngulejes në këtë fushë e cila ka patur si rezultat nënshkrimin e 40 marrëveshjeve (2017-2020) me Institucione Jashtë Shqipërisë [E1.60]. Me qëllim përfitimin e financimeve nga programet Evropiane, UV ka nënshkruar marrëveshjeve me Institucione Evropiane me qëllim mobilitetin e studentëve, pedagogëve dhe stafit ndihmës akademik/administrative. Nga viti 2017 deri tani UV ka nënshkruar 56 marrëveshje (marrëveshje KA1) me qëllim mobilitetet afatshkurtëra [E1.61]. Nga marrëveshjet e fundit të përmendura, nga viti 2017 deri më sot kanë përfituar mobilitete afatshkurtëra me financim Evropian 98 studentë, 111 pedagogë dhe 23 personel ndihmës akademik/administrativ të UV nga të gjitha Fakultetet dhe Departamentet [E.162, E1.63, E1.64].<br>Paralelisht me ato më lartë, UV organizon aktiviete të ndryshme me qëllim Trajnimin e Stafit Akademik mbi Teknikat e Shkrimit të një Projekt-Propozimi Cilësor dhe rritjen e kapaciteteve (https://univlora.edu.al/aktivitete/). |
| **Institucioni harton një strategji zhvillimi.** *(Kreu III Standardi I.5)* |
| Ndër vite UV ka ndërtuar një kulturë bashkëpunuese. Të gjitha vendimet që merren nga Organet Kolegjiale dhe autoritetet drejtuese të UV diskutohen gjerësisht. Shumë herë dokumenta ose çështje të ndryshme diskutohen në disa mbledhje më qëllim përmirësimin e dokumentit dhe zbardhjen e dokumentit final. Plani Strategjik [E1.55] është një nga dokumentat kryesore për UV dhe për këtë arsye hartimi i tij kërkoj një punë shumë të madhe nga Njësitë Bazë dhe Njësitë Kryesore. Fillimisht në nivel Institucioni u ngrit një grup pune [E1.65] me qëllim hartimin e një strategjie Zhvillimi të Institucionit [E1.66]. Kjo strategji zhvillimi u miratua nga SA [E1.67]. Paralelisht, Rektori i UV përgatiti një model Plani Strategjik i cili iu shpërnda Njësive Bazë dhe Kryesore. Në bazë të atij modeli edhe Fakultetet/Departamentet e UV përgatitën Planet Strategjike të tyre. Shembuj Plani Strategjik Fakulteti dhe Departamentesh jepen tek [E1.68] dhe tek https://univlora.edu.al/strategjia-e-zhvillimit/ (FSHT) dhe https://univlora.edu.al/strategjia-fshp/ (FSHP). Hartimi u zhvillua në këtë mënyrë me qëllim përfshirjen e të gjithë akademikëve dhe Njësive të Institucionit. Në bazë të këtyre më lart, UV që prej 2018 ka një Plan Strategjik të ri i cili është në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit 2017-2024. Plani Strategjik është miratuar nga SA [E1.69] dhe BA [E1.70]. Ky plan strategjik para se të miratohej është diskutuar gjerësisht si në SA [E1.71] ashtu dhe në BA [E1.72]. Sipas Planit Strategjik [E1.55], UV është krijuar për të qenë në shërbim të dijes, edukimit dhe mirëqënies së shoqërisë shqiptare. UV synon të mbetet një universitet publik i njohur dhe i kërkuar jo vetëm në territorin e Shqipërisë por edhe më gjerë, duke u mbështetur fuqishëm në vlerat e tij në mësimdhënie cilësore, kërkim dhe hulumtim profesional, integritet dhe dinjitet social. Plani Strategjik i UV ka përcaktuar qartë objektivat si dhe skenaret e Zhvillimit për pesë vitet e ardhshme (faqja 26-36). Për secilin skenar paraqiten linjat strategjike, dhe për çdo linjë strategjike paraqiten metodat dhe mekanizmat për arritjen dhe plotësimin e tyre. Skenari i parë ka të bëj me **NDËRKOMBTARIZIMIN** e UV. Linjat strategjike për arritjen e këtij objektivi paraqiten tek faqet 27-30). |

| |
|---|
| Skenari i dytë **UNIVERSITETI SMART (SMART UNIVERSITY)** dhe linjat strategjike paraqiten tek faqet 30-32.<br>Skenari i tretë ka të bëj me krijimin e një Universiteti **Lider Profesional** dhe linjat strategjike për arritjen e këtij objektivi paraqiten tek faqet 32-36.<br>Të gjitha objektivat dhe skenaret janë të paraqitura me detaje tek plani strategjik. Për çdo skenar, dhe linjë strategjike janë specifikuar veprimet ose më saktë Plani i Veprimit, Instrumentat për arritjen e tyre, afati kohor, përgjegjësitë për ti implementuar, si dhe kostua e çdo veprimi. Në detaje këto prezantohen tek Plani Strategjik i UV faqja 42-80 [E1.55].<br>**Objektiva Strategjike** të UV sipas strategjisë së Zhvillimit janë të fokusuara dhe prezantohen tek faqet 37-40.<br>Statuti [E1.1], Strategjia e Zhvillimit [E1.66] dhe Plani Strategjik [E1.55] janë në koherencë dhe synojnë implementimin e misionit dhe qëllimeve të UV. Institucioni ka si mision ofrimin e programeve të studimit në fusha të ndryshme në tre ciklet e studimit të arsimit të lartë, si dhe programe studimi me karakter profesional, referuar niveleve 5, 6, 7, dhe 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve [E1.1, neni 3]. Misioni i dytë i UV është nxitja e njohurive dhe shkencës përmes punës kërkimore shkencore, punës akademike, aktivitetit krijues dhe bashkëpunimit me të tretët. UV e zhvillon veprimtarinë e tij në disa drejtime si mësimdhënie bashkohore, shërbime më ndikim në komunitet, punë kërkimore shkencore bazë dhe të aplikuar etj. [E1.1, neni 3]. Disa nga qëllimet e UV janë zhvillimi i kulturës, shkencës dhe ekonomisë, zhvillimin e veprimtarisë brenda sistemit arsimor kombëtar e ndërkombtar, ofrimi i mundësive të barabarta, nxitja e ndërkombtarizimit etj. (E1.1, Statuti Neni 4). |
| **Institucioni publikon raportin vjetor, e paraqet atë pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe para personelit akademik dhe studentëve.** *(Kreu III Standardi I.6)* |
| UV çdo vit përgatit raportin vjetor të tij ku pasqyrohen të gjitha aktivitetet [E1.73, E1.74]. Në raportin vjetor të vitit të fundit akademik (2018-2019) pasqyrohen qartë të gjitha aktivitetet e UV [E1.74]. Raporti prezanton në detaje bashkëpunimet ndërinstitucionale, projektet dhe veprimtarinë kërkimore shkencore të çdo Fakulteti/Departamenti/Pedagogu, prezanton programet dhe tarifat e shkollimit për vitin e ardhshëm akademik si dhe të dhënat për gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar të paktën një cikël studimesh pranë UV. Detaje prezantohen edhe për numrin e studentëve aktual, numërin e studentëve ekselent etj. Po ashtu, në raport paraqiten akte të ndryshme të brendshme si p.sh ndryshime në Statut dhe Rregullore. Fusha të tjera që përfshihen në Raportin Vjetor janë aktivitetet e NJSBC, të dhënat e Këshillave studentorë dhe përfaqësimi i tyre në organet drejtuese të IAL-së. Të dhëna për mobilitetin e stafit akademik, ndihmës akademik dhe administrative dhe studentëvë të cilët kanë përfituar mobilitete nga programme të ndryshme paraqiten tek raporti vjetor.<br>Përveç anës akademike, në raportin vjetor prezantohet me detaje edhe aktiviteti i BA si dhe Raporti vjetor financiar i UV. Së fundmi, raporti paraqet edhe aktivitetet e auditit të brendshëm të UV [E1.74]. Raportet vjetore që UV përgatit dhe paraqet, janë në përputhje me ligjin e Arsimit të Lartë, aktet nënligjore si dhe Statutin dhe Rregulloren e brendshme të UV.<br>Raporti vjetor është i rëndësishëm për Fakultetet/Departamentet dhe të gjitha Njësitë që operojnë në UV. Raporti përveç se prezanton hollësisht gjithë aktivitetet e IAL-së, është një mundësi e mirë për përmirësimin e Institucionit. Informacioni i paraqitur në raport u mundëson autoriteteve dhe organeve drejtuese përcaktimin e pikave të forta dhe të dobta për ndërmarjen e hapave për |

përmirësim. Ky raport ndihmon po ashtu edhe në proçesin e vlerësimit të Brendshëm dhe të jashtëm të Institucionit. Rregullorja e NJSBC [E1.48] pasyron qartë se qëllimi i kësaj Njësie është ngritja e një sistemi efektiv që udhëheq aktivitetet akademike, dhe funksionet administrative dhe financiare të Institucionit (Neni 3). NJSBC ka si synim kontrollin e Cilësisë duke bashkëpunuar me Agjencinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (ASCAL) [E1.48, neni 16 pika 1]. Raportet vjetore të Institucionit shërbejnë si dokumenta referues nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVB) të Cilësisë për vlerësimin e brendshëm dhe prezantimin e situatës reale. Paralelisht, raportet vjetore vlejnë për vlerësimin e UV nga GVJ. Raporti vjetor miratohet nga SA [E1.75] dhe BA [E1.76]. Pas miratimit, Rektori e përcjell Raportin Vjetor tek drejtuesit e Njësive Kryesore dhe Drejtuesit e Njësive Bazë. Të fundit, e përcjellin Raportin tek stafi akademik dhe ndihmës akademik që ata kanë në varësi. Paralelisht UV publikon në faqen zyrtare të saj Raportin Vjetor si dhe ia përcjell MASR [E1.77].

**Organizimi i Institucioneve të Arsimit të Lartë**

**Institucioni ngre struktura të përshtatshme për realizimin e misionit dhe qëllimit të tij.** *(Kreu III Standardi II.1)*

Autonomia dhe liria akademike përcaktohen nga Ligji Nr. 80/2015 (Neni 3) dhe Statuti i UV. Sipas Statutit të UV [E1.1, Neni 5, pika 1] "*UV përfshin në programet mësimore e studimore dhe garanton shprehjen e lirë të ideve shkencore, kulturore, politike, sindikale e fetare...*" dhe sipas Statutit neni 6 pika 2 UV, e zhvillon veprimtarinë e tij institucionale në mënyrë autonome. Po ashtu, bazuar tek neni 3 Pika 3. personeli akademik i përfshirë në mësimdhënie ose kërkim shkencor në UV, gëzon autonomi dhe liri akademike. Rregullorja e UV, po ashtu siguron autonominë dhe lirinë akademike (Rregullore e UV, Neni 4).

Autonomia dhe liria akademike që UV ka i jep mundësinë të realizoj qëllimet dhe misioni e saj siç janë të përcaktuara në Statut (Neni 3, 4, 6), Strategjinë e Zhvillimit (faqet 9-10) dhe Plani Strategjik [E1.1, E1.55, E1.66].

Kjo liri shprehet në liri në mësimdhënie, liri në kërkim shkencor dhe liri në krijim [E1.1 nenet 3-6]. Pedagogët e UV kanë liri të hartojnë syllabuset dhe programet mësimore, gëzojnë liri të kryejn aktivitet kërkimor shkencor sipas fushës dhe interesave shkencore të tyre si dhe janë të lirë në krijimin e patentave, shpikjeve etj.

Me qëllim ushtrimin e autonomisë brenda kompetencave, UV në përbërjen e tij, ka njësi organizative Kryesore, Bazë dhe ndihmëse [E1.1, neni 8]. UV përbëhet nga katër (4) Njësi Kryesore (Fakulteti i Ekonomisë, Fakulteti i Shëndetit Publik, Fakulteti i Shkencave Humane dhe Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore) [E1.1, neni 9]. Në total UV ka gjiashtëmbëdhje (16) Njësi Bazë [E1.1, neni 10]. Ato janë:

1. Fakulteti i Ekonomisë (FE):
    a. Departamenti i Biznesi
    b. Departameni i Financës dh Kontabilitetit
    c. Departamenti i Ekonomiksit
2. Fakulteti i Shëndetit Publik (FSHP)
    a. Departamenti i Infermierisë
    b. Departamenti i Kujdesit Shëndetsor
3. Fakulteti i Shkencave Humane (FSHH)
    a. Departamenti i Drejtësisë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

b. Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë
c. Departamenti i Edukimit
d. Departamenti i Gjuhëve të Huaja
4. Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore (FSHT)
a. Departamenti i Inxhinjerive dhe Teknologjisë Detare
b. Departamenti i Shkencave Detare
c. Departamenti i Fizikës
d. Departamenti i Biologjisë
e. Departamenti i Matematikës
f. Departamenti i Shkencave Kompjuterike
g. Departamenti i Kimisë

UV në strukturën e vet, në bazë të legjislacionit në fuqi, ka ngritur Qendra Kërkimore-Shkencore. Në total 4 Qendra Kërkimore Shkencore funksionojnë në UV të cilat janë:

1. Qendra e Kërkimit Shkencor e Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore;
2. Qendra e e Kërkimit Shkencor e Fakultetit të Ekonomisë;
3. Qendra e e Kërkimit Shkencor e Shëndetit Publik;
4. Qendra e e Kërkimit Shkencor e Albanologjisë dhe Ballkanistikës.

Përveç Njësive Kryesore dhe Bazë, UV ka në përbërjen e tij edhe struktura/njësi ndihmëse [E1.1, neni 13]. Njësitë ndihmëse janë në varësi të Rektorit, Administratorit ose BA. Struktura e Njësive është e miratuar nga SA [E1.22]. Njësitë ndihmëse në UV janë:

1. Drejtoria e Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore
2. Drejtoria e Edukimit për Ciklin e I & II
3. Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit Institucional
4. Sektori i promovimit akademik dhe botimeve shkencore
5. Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse
6. Sektori i Auditit

Drejtoritë 1, 2, 3 dhe SPABS janë në varësi të Rektorit ndërsa Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse është në varësi të Administratorit. Sektori i Auditit është në varësi të BA [E1.22].

UV ofron programme në të tre ciklet e studimit [E1.78]. Në total ofrohen 61 programe studimi (Bachelor, Master Profesional, Master Shkencor dhe Doktoraturë). FSHT ofron 21 programe studimi (Bachelor, Master Profesional, Master Shkencor dhe Doktoraturë) ndërsa FSHP ofron 6 programe studimi (Bachelor, Master Profesional dhe Master Shkencor). FSHH ofron 18 programe studimi (Bachelor, Master Profesional, Master Shkencor) ndërsa FE ofron 16 programe studimi (Bachelor, Master Profesional, Master Shkencor). UV ka hartuar dhe miratuar Strategjinë e Kërkimit Shkencor [E1.79]. Në këtë strategji pasqyrohet qartë që UV zhvillon kërkim shkencor bazë dhe aplikativ [E1.79, faqja 4]. Secili nga Fakultetet ka strategjinë e vet të kërkimit shkencor dhe po ashtu zhvillon kërkim shkencor bazë dhe të zbatuar [E1.80]. Në FSHP zhvillohet Kërkim Shencor aplikativ në laboratorët dhe qendrën simulatore [E1.81 dhe https://univlora.edu.al/laborator-fshp/].

Me qëllim plotësimin e një nga objektivave kryesore që UV ka (Lider në Rajon dhe zhvillimin e aktiviteteve me të tretë), është ngritur Qendra Studimore Ndërdisiplinore e Zhvillimit Rajonal (RDC) [E1.82]. Qendra ka në misionin e saj aktivitete multifunksionale në drejtim të organizimit, menaxhimit dhe zhvillimit të edukimit dhe trajnimit, mbështetje dhe zhvillim të punës kërkimore shkencore dhe projekteve në fusha ndërdisiplinore, promovimi i inovacionit, ndërtimi i një sistemi

cilësor të edukimit etj [E1.1, neni 12 dhe E1.83]. RDC funksionon në bazë të Rregullores [E1.83] dhe Strategjisë së saj [E1.84]. RDC mundohet të siguroj edukim në vazhdim në zonën e Vlorës duke patur si target grup studentët dhe alumni të UV [E1.83].

Fakultetet e UV plotësojnë kriteret dhe përbëhen nga të paktën 3 Njësi Bazë. Bazuar në orgnigramën e UV [E1.85], FE përbëhet nga tre (3) Departamente, FSHT nga shtatë (7) Departamente dhe FSHH nga katër (4). Në bazë të Ligjit 80/2015 (Neni 26), FSHP ka në përbërjen e tij dy (2) Departamente dhe një Qendër Kërkimore-Shkencore e cila funksionon si njësi bazë [E1.1 neni 9 dhe neni 10].

Njësitë bazë kanë të paktën shtatë anëtarë prej të cilëve tre kanë gradë shkencore. Tek evidenca [E1.86], [E1.87], [E1.88] dhe [E1.89] paraqiten pedagogët e çdo Njësie Bazë dhe grada e tyre shkencore në FE, FSHP, FSHH dhe FSHT respektivisht.

Të gjitha informacionet mbi Fakultetet, Departamentet, stafin akademik etj. mund të gjenden në faqen zyrtare të UV, http://univlora.edu.al/ e cila funksionon edhe në anglisht për pjesën më të madhe të rubrikave.

**Organet drejtuese lehtësojnë vendimmarrjen nëpërmjet favorizimit të debatit në këshillat e institucionit.** *(Kreu III Standardi II.3)*

Komisionet e përhershme janë organe kolegjiale të cilat kryejnë funksione në fushat e përcaktuara në statut (E1.1, Neni 22). Anëtarët e Komisioneve të përhershme nuk mund të jenë pjesë e autoriteteve Drejtuese ose anëtarë të organeve kolegjiale. Sipas Nenit 28 të Statutit të UV, KE shqyrton çështjet që lidhen me etikën në veprimtarinë e Universitetit, shprehet me vendim dhe i propozon Rektorit marrjen e masave disiplinore. Këshilli i ri i etikës së Institucionit është ngritur me vendim SA [E1.36].

UV me vendimin e SA ka miratuar krijimin dhe funksionimin e komisioneve të përhershme [E1.90]. Komisionet e miratuara janë:

1) Komisioni i Sigurimit te Cilësisë së Brendshme në nivel institucional. (KSBCI);
2) Komisioni i marrëdhënieve me studentët në nivel institucional, (KMSI);
3) Komisionet e Sigurimit të Cilësisë së Brendshme për çdo Fakultet,(KSBCF);
4) Komisionet e marrëdhënieve me studentet për çdo Fakultet (KMSF);
5) Komisioni i dhënies së gradës shkencore "Doktor", (KDGD).

KDGD është ngritur ne 26.02.2018 [E1.28]. Një proçedurë nga momenti i ngritjes së jurisë për vlerësimin e disertacionit të një kandidati deri në firmosjen e diplomës nga Dekani dhe Rektori paraqitet tek evidenca [E1.30].

Përveç këtyre komisioneve më lart, në Statutin e UV [E1.1, Neni 22], parashikohen edhe Komisioni i Promovimit të Personelit Akademik i cili përbëhet nga shtatë (7) anëtarë.

**Partneriteti**

**Institucioni kryen studimin e tregut për realizimin e misionit dhe qëllimit të tij.** *(Kreu III Standardi III.1)*

UV bën përpjekje për të patur kontakte të vazhdueshme me aktorët rajonal si stakeholder-at, bizneset, institucionet publike e private, punëmarrësit kryesor të studentëve etj. Për këtë arsye organizon takime periodike me qëllim diskutimin me ta mbi pikat e forta dhe të dobëta të studentëve dhe përmirësimin e programeve të studimit ku është e nevojshme. Takimi i fundit u organizua në datën 18.12.2019 pranë UV. Në këtë takim ishin të pranishëm anëtarët e Rektoratit të UV dhe

bashkëpuntore/përfaqsues të jashtëm si Zyra e Punës Vlorë, Dhoma e Tregtisë, Zyra Arsimore Vlorë-Himarë, BKT, Kryetari i Operatorëve Turistik, Urdhëri i Infermierit, Drejtoria Rajonele e Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria Rajonale e Mbrojtjes së Mjedisit, AlbSale Vlora Shpk etj [E1.91].
Me qëllim kontaktin sa më të madh me operatorët turistik rajonal, çdo vit UV merr pjesë në Hapjen e Sezonit Turistik të Vlorës që organizohet nga Bashkia e Vlorës (https://univlora.edu.al/2019/05/21/hapja-e-sezonit-turistik-te-vlores-panairi-kulinar-vlora-turistike-ju-mirepret/). Përveç këtyre më lart, UV merr pjesë në panairin e punës që organizohet çdo vit nga Zyra e Punës Vlorë. Relacion i detajuar për pjesëmarrjen e UV në panairin e punës për vitin kalendarik 2019 paraqitet tek [E1.92].
UV mban kontakte edhe me operatorët Rajonalë si Urdhëri i Infermierit Vlorë, Fier etj. duke u informuar vazhdimisht për numrin e infermierëve që parashikohet të dalin në pension vitet e ardhshme [E1.93 faqja 15 dhe 52]. Paralelisht, për hapjen e programeve te reja UV realizon studim të tregut me qëllim njohjen reale të nevojave dhe mënyrën e adresimit të tyre. Shembuj studimi të tregut prezantohen tek [E1.94 faqja 42-50] për programin e ri Bachelor në përkthim-redaktori në anglisht për qëllime të posaçme dhe tek [E1.95 faqja 46-47] për programin e ri Program Profesional "Akuakulturë dhe Higjienë e Produkteve të Peshkimit".
UV ka ngritur pranë Drejtorisë së Edukimit për Ciklin e I & II Sektorin e Këshillimit të karrierës, ALUMNI dhe aktiviteteve kulturore-sportive. Ky sektor monitoron rregullisht punësimin e të diplomuarve. Në fillim të çdo viti kalendarik, Rektori i UV dërgon një shkresë të gjitha Institucioneve Publike në Qarkun e Vlorës me qëllim monitorimin dhe gjurmimin e ish studentëve të diplomuar në UV. Me shkresën u përcillet edhe një formular specifik i cili përmban informacion mbi nivelin e studimeve që punonjësit e këtyre Institucione kanë kryer pranë UV. Evidenca [E1.96] prezanton proçedurën e monitorimit dhe gjurmimit nga momenti që dërgohet kërkesa dhe formulari deri në përgjigjen e Institucioneve. Përveç kontakteve me Institucionet e Rajonit të Vlorës, UV kontakton edhe me ish student të saj me email me qëllim të monitorojë nëse këta studentë janë të punësuar apo jo [E1.97]. Një praktikë e mirë paraqitet edhe tek [E.1.93 faqja 52] ku paraqitet numri i punonjësve në shërbime shëndetsore parësore dhe dytësore dhe sa nga ata kanë përfunduar një cikël studimesh në UV.
Në faqen zyrtare të saj, UV ka ndërtuar një kënd specifik për Alumni (https://univlora.edu.al/alumni/). Në këtë kënd, ish studentët e UV mund të kërkojnë informacione të ndryshme ose të regjistrohen përmes formularit të Regjistrimit UV Alumni. Bazuar në këto të dhëna, UV ka ndërtuar një database të Alumnit të cilën e përditëson vazhdimisht [E1.98].
Aktiviteti i Institucioni zhvillohet në bazë të legjislacionit në fuqi duke repektuar rregullat e konkurencës. UV miraton dhe bënë publike kriteret [E1.99], kuotat e pranimit si dhe tarifat e studimit [E1.100]. Kriteret e pranimit publikohen tek portali https://ualbania.al/ dhe një kopje i përcillet MASH. Shembull i publikimit të kuotave, kritereve dhe tarifave të studimit jepet në këtë link (https://ualbania.al/Universitet/Info/7?fakultetID=62&degaID=264). Në gjithë proçedurën për thithjen e sa më shumë studentëve, UV ndjek vlerat dhe parimet akademike e morale.
Institucioni ndjek dhe zbaton të gjitha ligjet dhe rregullat për prokurimet publike. Çdo prokurim publikohet tek http://www.app.gov.al/ dhe ndiqen të gjitha proçedurat sipas legjislacionit në fuqi.

**Institucioni ndjek një strategji të hapur për bashkëpunimin dhe partneritetin në nivel rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar.** *(Kreu III Standardi III.2)*

UV kushton rëndësi të madhe tek bashkëpunimi me partner lokalë, kombëtarë e ndërkombëtarë. SA ka miratuar Strategjinë e Ndërkombtarizimit të UV 2016-2020 [E1.57]. UV bashkëpunon me autoritete lokale për arritjen e qëllimeve të veta. Çdo vit UV bashkëpunon me Bashkinë e Vlorës për Organizimin e Ceremonisë së diplomimit në Pallatin e Lojrave me Dorë. Në raste të tjera, UV bashkëpunon me partnerë lokalë/rajonalë (Qarku i Vlorës) në projekte Evropiane ose me Institucione të tjera si Banka Kombëtare Tregtare për mundësimin e punësimit të studentëve. Shembuj të tjerë bashkëpunimi në nivel kombëtar është p.sh bashkëpunimi me Certipass digital skills për platformën Europiane EiPASS *ose bashkëpunimi me Qendrën për Nismën Ligjore Qytetare.* marrëveshje të tjera në nivel kombëtar janë marrëveshja me Drejtorinë e Përgjithshme e Pronave Intelektuale (DPPI) [E1.101] dhe organizimi i aktiviteteve të përbashkëta, ose bashkëpunimi me Postën e Shqipërisë për dhënien e Kartës së Studentit ose me AADF. Lista me aktivitete të ndryshme bashkëpunimi prezantohet tek evidenca [E1.102].

Po ashtu, UV bashkëpunon me IAL të tjera kombëtare me qëllim kërkimin shkencor [E1.103], pjesëmarrjen në projekte Evropiane [E1.59], organizimin e aktiviteteve të përbashkëta etj.

1) *https://univlora.edu.al/2019/10/16/konferenca-shkencore-nderkombetare-me-teme-marredheniet-shqiptaro-kineze-tradita-gjendja-dhe-e-ardhmja/*
2) *https://univlora.edu.al/2020/01/16/thirrje-per-pjesemarrje-ne-konferencen-e-7-te-shkencore-sfidat-shkencore-per-zhvillim-te-qendrueshem,-2020-18-prill-2020-struge/?fbclid=IwAR3LBy3WKL-KJxm4v49rSplX3HMUobgicKvF-_UfwMqIIrREDaky-4EGhok*
3) *https://univlora.edu.al/2019/11/22/konferenca-e-katert-per-studime-gjuhesore-letrare-dhe-kulturore-languages-travel-the-world-challenges-and-perspectives-in-language-literary-and-cultural-studies-in-the-technological-era/*
4) *https://univlora.edu.al/2018/10/29/1st-international-conference-on-marketing-and-tourism-2018-icmt-2018/*
5) *https://univlora.edu.al/2019/09/25/konferenca-e-dyte-nderkombetare-per-kerkime-te-reja-dhe-perparime-ne-shkencen-kompjuterike-dhe-teknologjine-e-informacionit-krp-shkti-2019/*
6) *https://univlora.edu.al/2018/06/06/konferenca-e-katert-nderkombetare-e-shkencave-te-aplikuara/*

Strategjia e Zhvillimit thekson rëndësinë e bashkëpunimit me qëllim zhvillimin e Institucionit (E1.66, faqja 13-20). Ky qëllim paraqitet qartë tek Plani Strategjik i UV [E1.55]. Një nga skenarët kryesor të UV është Ndërkombtarizim/Globalizimi i UV. Te faqet 27-30 paraciten linjat strategjike për arritjen e këtij qëllimi ndërsa në faqet 42-56 paraqitet plani i veprimit i detajuar për arritjen e kësaj objektive.

Institucioni kontakton dhe organizon takime me punëdhënësit me objektiv studimin e tregut, diskutimin mbi nevojat që ai ka dhe me qëllim përfundimtar drejtimin e studimeve të reja drejt nevojave reale. Para se të marri pjesë në projekte kombëtare edhe/ose ndërkombtare ose para se të hapi programme të reja studimi UV studion hollësisht tregun e punës, nevojat lokale edhe/ose rajonale. Vitet e fundit UV, duke u bazuar edhe te tradita e saj shumëvjeçare është fokusuar në projekte kërkimore shkencore që kanë të bëjnë me fushën e mësuesisë, shëndetit publik etj. Në fushën e shëndetit publik ka aplikuar në thirrjen Horizon 2020 projektin kërkimor shkencor me titull IMPULSE.EU, ndërsa në fushën e Arsimit të Lartë po mundohet të hapi doktoratura në kuadër të projektit MARDS. Përveç traditës, UV fokusohet edhe tek trendi kombëtar e ndërkombëtar për aplikimin e projekteve. Në këtë kuadër ka filluar implementimin e projektit me titull KNOWHUB i cili ka si qëllim ndërtimin e inkubatorëve për krijimin e start-up-eve si dhe bashkëpunimin me

bizneset gjë që parashikohet edhe tek skenari i tretë tek Plani strategjik i UV. Lista e projekteve të aplikuara dhe atyre në implementim nga UV prezantohet tek Evidencat [E1.58 dhe E1.59].
UV para se të kërkojë hapjen e një programi të ri studimi, studion tregun në detaje. Shembuj studimi të tregut prezantohen tek [E1.94, faqja 42-50] dhe [E1.94, (faqja 46-47].
Në kuadër të riorganizimit të programit të studimit të Drejtësisë (nga program Bachelor 3-vjeçar në program të integruar 5-vjeçar), Departamenti i Drejtësisë ka kryer një studim tregu të detajuar me qëllim vërtetimin e kontributit dhe nevojën e riorganizimit. Departamenti ka studiuar trendin vendas dhe rajonal të punësimit, nevojat e tregut të punës që ky riorganizim programi do të përmbushë, punësimi potencial i studentëve, marrëveshjet/ kërkesat paraprake nga operatorë privatë/institucione publike për punësim etj. [E1.104, faqja 51-56].
Siç u theksua edhe më lart, në kuadër të zbatimit të strategjisë dhe planit strategjik, UV bashkëpunon me partnerë lokalë e rajonalë. Një listë e detajuar e bashkëpuntorëve/ marrëveshjeve prezantohet tek [E1.41a, E1.41b, E1.41c, E1.105].
Nënshkrimi i marrëveshjeve mund të iniciohet nga stafi akademik, zyra e marrdhënieve me jashtë ose organet kolegjiale të UV. UV ka punuar shumë në drejtimin e nënshkrimit të marrëveshjeve me Institucione homologe. Universiteti ka më shumë se 40 marrëveshje bashkëpunimi (Memorandum of Understanding) aktive ndërsa të tjera nuk janë rinovuar [E1.106]. Duke patur parasysh që shumë marrëveshje nënshkrueshin por ngeleshin në letra, UV ka hartuar një procedurë/udhëzim specifike për implementimin e marrëveshjeve dhe vlerësimin e tyre nëse duhet të rinovohen apo jo [E1.107]. Detaje mbi implementimin e marrëveshjeve (nëse janë aplikuar projekte të përbashkëta, janë zhvilluar mobilitete ose aktivitete këkimore shkencore, ose aktivitete të tjera) me çdo Institucion homolog paraqitet tek Evidenca [E1.108].

**Institucioni ndjek një strategji bashkëpunimi me institucionet të tjera mbështetëse.** *(Kreu III Standardi III.3)*

Institucion bashkëpunon me shumë Institucione të ndryshme për ofrimin e shërbimeve ndaj studentëve. Në bashkëpunim me Postën e Vlorës ofron kartën e studentit (http://arsimi.gov.al/pakti-per-universitetin-vlore-nis-shperndarja-e-kartave-te-studentit/) ndërsa Bashkia ofron kapacitetet e saj për organizimin e aktiviteteve të ndryshme si ceremonia e diplomimit, aktivitete sportive etj (https://www.facebook.com/690071477689556/posts/2437335219629831/).
Me qëllim finalizimin e studimeve në UV, studentët janë të detyruar të kryejnë praktika mësimore. Për këtë arsye, UV bashkëpunon me Institucione të shumta si Drejtoritë Arsimore, spitalet e Vlorës e Fierit, Bankat, Gjykatën, Qarkun e Vlorës etj [E1.105].

**Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e personelit akademik dhe të studentëve në nivel ndërkombëtar.** *(Kreu III Standardi III.4)*

Një nga objektivat e UV është ndërkombtarizimin. Duke u bazuar tek ky objektiv, UV ka hartuar strategjinë e Ndërkombtarizimit [E1.57]. Paralelisht, ka organizuar edhe/ose ka marrë pjesë si bashkëorganizator në shumë aktivitete ndërkombtare. Një listë e konferencave ndërkombëtare që UV ka organizuar paraqitet tek Evidenca [E1.31]. Disa aktivitete të tjera ndërkombëtare që UV ka marrë pjesë së fundmi janë edhe:

1. https://univlora.edu.al/2020/02/04/pedagoget-e-fakultetit-te-shendetit-publik-marren-pjese-ne-trajnimin-walk-through-for-universities-on-universal-treatment-curriculum-for-substance-use-disorders/
2. https://univlora.edu.al/2019/12/18/dita-kombetare-informuese-erasmus/

3 https://univlora.edu.al/2019/12/13/uctm-uv-ëorkshop-dy-ditor-mbi-kerkimin-shkencor-me-impakt-ne-zhvillimin-e-qendrueshem/
4 https://univlora.edu.al/2019/11/11/universiteti-ismail-qemali-nenshkruan-anetaresine-ne-magna-charta-universitatum/
5 https://univlora.edu.al/2019/11/11/takim-bashkepunimi-nderinstitucional-ne-fusher-e-arsimit-te-larte-me-institucione-te-arsimit-te-larte-te-kines/
6 https://univlora.edu.al/2019/10/29/erasmus-seminar-contact-me-ballkanin-perendimore/

UV ka ndjekur politika ambicioze për nënshkrimin e një numëri të madh marrëveshjesh me Institucione homologe Evropiane. UV ka hartuar *Rregulloren për Implementinin e marrëveshjeve ndër-Institucionale në kuadër të programit Erasmus+ KA107 International Credit Mobility* [E1.109]. Për këtë arsye ka nënshkruar 56 marrëveshje KA1 për mobilitete të shkurtra për stafin akademik, ndihmës akademik dhe studentët [E1.61]. Nga këto marrëveshjet, nga viti 2017 deri më sot kanë përfituar mobilitete afatshkurtëra me financim Europian 98 student, 111 pedagogë dhe 23 personel ndihmës akademik/administrativ të UV nga të gjitha Fakultetet dhe Departamentet [E1.62, E1.63, E1.64]. Paralelisht, UV në planin e veprimit për rekomandimet e GVJ ka parashikuar në buxhetin e vet një fond specifik për mobilitetin e stafit akademik në aktivitete shkencore e trajnuese jashtë vendit [E1.23]. Paralelisht, UV ka asistuar dhe ka inkurajuar stafin e vet akademik për të kryer vit Sabatik [E1.110].
Përveç Strategjisë së Ndërkombtarizimit [E1.57], dhe *Rregullores Erasmus+* [E1.109], me qëllim tërheqjen e sa më shumë studentëve të huaj, UV ka hartuar Guidën Erasmus+ [E1.111]. Guida Erasmus+ e cila është vetëm në gjuhën angleze, prezanton të gjitha hapat nga momenti që një student i huaj do zgjedhi Universitetin e Vlorës për të ndjekur një periudhë të shkurtër studimet e veta, deri tek momenti që ai do largohet. Detaje ofrohen për opsionet e ndryshme se si do të vi në Vlorë, proçedurat për marrjen e lejes së qëndrimit, akomodimin etj. Hapat e përmendura më lart janë politikat bazë që UV ka hartuar dhe po implementon për integrimin e studentëve të huaj. Gjatë gjithë periudhës që studentët e huaj frekuentojnë leksione në UV, Sektori i Mardhënieve me Jashtë komunikon me ta dhe i asiston në çdo problematik që ata hasin. Me qëllim tërheqjen e sa më shumë studentëve të huaj, UV ka përgatitur dhe publikuar në web të gjitha kurset që mund të ofrohen në gjuhë të huaj (përjashtuar programet e studimit që ofrohen nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja) [E1.112]. Këto politika kanë patur si pasojë rritjen e studentëve të huaj që zgjedhin UV për të kryer për një periudhë studimet e tyre [E1.62].
UV punon për integrimin e stafit të ftuar dhe të studiuesve të huaj. Institucioni ka ngritur Rrjetin e Diasporës [E1.52] me qëllim funksionimin e diasporës si një urë lidhëse midis UV dhe Institucioneve Evropiane e më gjerë. Me vendim të SA, çdo Fakultet mund të ftojë 2 pedagog të huaj për të dhënë leksione dhe shpenzimet e tyre mbulohen ekskluzivisht nga buxheti i UV [E1.113, E1.11.a]. UV fton pedagogë nga Universitete të tjera të Shqipërisë ose të rajonit. Listë e detajuar e pedagogëve të ftuar paraqitet tek Evidencat [E1.114a, E1.114b, E1.114c]. Në kuadër të marrëveshjeve KA1, tre vitet e fundit 43 pedagog të huaj kanë vizituar Institucionin dhe kanë zhvilluar aktivitete mësimore edhe/ose kërkimore [E1.63].

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" – VLORË

**Përfundimi dhe Vlerësimi**

UV ka punuar maksimalisht jo vetëm për të plotësuar mangësitë/dobësitë/rekomandimet e GVJ në proçesin e kaluar, por edhe për të aplikuar praktika të mira në bazë të eksperiencave evropiane. Hartimi dhe zhvillimi i një skeme për trajnimin e vazhdueshëm të personelit të ri të rekrutur, bashkëpunimi dhe ndërkombëtarizimi i UV/së me rritjen e mobiliteteve dhe numërin e aplikimeve dhe thithjes së fondeve të huaja janë vetëm disa nga arritjet e UV. Paralelisht, krijimi i Bordit Konsultativ dhe takimet periodike me stakeholders-at lokal janë disa nga praktikat e mira. Paralelisht, UV ka krijuar Njësinë e Sigurimit dhe Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë si dhe ka hartuar jo vetëm një Strategji Zhvillimi dhe një Plan Strategjik të detajuar, por është duke i implementuar me rezultate të dukshme pozitive deri tani. UV ka hartuar një statut dhe një rregullore të re në bazë të ligjit të ri dhe akteve nënligjore. Me qëllim përmbushjen e misionit dhe qëllimeve të veta, UV është e organizuar në struktura të posaçme me detyra të ndara. Vendimarrja bëhet pas diskutimit dhe debatit konstruktiv të çdo propozimi dhe mendimi. Të gjitha këto i sigurojnë institucionit një menaxhim efikas. Përpjekjet e shumta të UV/së për monitorimin sistematik të punësimit të të diplomuarve janë përmirësuar me rezultate të dukshme, por ka ende shumë punë për t'u bërë.

Bazuar mbi analizat dhe evidencat e raportuara në këtë raport, GVB konkludon se *standartet për fushën Organizimin dhe Menaxhimi i Institucionit përmbushen* **Plotësisht.**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

## 2 FUSHA E VLERËSIMIT: BURIMET

| Menaxhimi i Burimeve Njerëzore |
|---|
| **Institucion ndjek një politikë të hapur të punësimit dhe të rekruktimit të burimeve njerëzore.** *(Kreu III Standardi IV.1)* |
| Organigrama e plotë e universitetit është e publikuar në faqen e tij zyrtare (https://univlora.edu.al/en-organigrama/) sipas pozicioneve përkatëse. [E1.1, E1.85]. Krahas punësimit me kohë të plotë, universiteti punëson edhe burime njerëzore me kohë të pjesshme për nevojat e tij institucionale [E1.5, E2.1, E2.2, E2.3 E2.4, E2.5].<br><br>Për çdo pozicion të ri që paraqitet, bëhet publikimi i vendeve të lira te punës në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në faqen zyrtare (https://univlora.edu.al/2019/12/04/njoftim-punesimi-27/) në statut dhe pastaj proçedohet në bazë të neneve 27, 28, 29 të rregullores së UV-së [E1.5] dhe vendimit te SA mbi proçeduarat e punësimit [E2.5] në transparencë të plotë me bazën ligjore. [E2.5.a, E2.5.b,]<br>UV-ja ndjek politika inkurajuese për promovimin e stafit të tij [E1.32, E1.33] me kohë të plotë ose të pjesshme, të ftuar apo me kontratë duke ofruar mundësinë e promovimit në doktoraturë në matematikë për të gjithë stafin e interesuar [E1.30] apo trajnime të vazhdueshme [E1.26] në institucion dhe duke nxitur pjesëmarrjen e stafit në këto aktivitete. Ndër aktivitetet që janë bërë për këtë qëllim mund të përmendim trajnimin mbi "Hapat dhe Teknikat e Shkrimit të një Projekt Propozimi Cilësor", "Sesion informues nga përfaqësues të zyrës Kombëtare Erasmus + në Shqipëri" (https://univlora.edu.al/aktivitete/) etj të cilat kanë për qëllim nxitjen dhe promovimin e personelit akademik.<br>Sipas nenit 31 të Rregullores së UV/së [E1.5], njësitë kryesore përpara fillimit të çdo semestri ose gjatë vitit akademik, bazuar në nevojat e domosdoshme për realizimin e proçesit të mësimdhënies, përcjellin për miratim në Rektorat listën emërore të personelit akademik te ftuar, me kontratë me kohë të plotë ose të pjesshme, duke iu përmbajtur numrit të miratuar nga Këshilli i Administrimit për këtë kategori punonjësish. Konkurimi për personelin akademik për të dyja kategoritë bëhet nëpërmjet vlerësimit të dosjes. Kandidati duhet të plotësojë së pari kërkesat e përgjithshme të përcaktuara në nenin 28 te Rregullores së UV dhe kritere specifikë të përcaktuar në rregulloret e njësive kryesore. Përzgjedhja bëhet në përputhje me ligjin 80/2015 të arsimit të lartë (të ndryshuar) dhe rregulloren e punësimit të UV/së [E2.5].<br>Vendimi i SA, [E2.6] përcakton qartë rregullat dhe proçedurat për punësimin e personelit ndihmësakademik dhe hapat respektivë që ndiqen për rekrutimin e personelit [E2.6, E1.1, E1.5] që nga momenti i shpalljes së një vendi vakant për personel ndihmës akademik nga njësia bazë/njësia kryesore/njësi tjetër në nivel institucional, së cilës personeli i shërben, përgatitija e kërkesës, shpallja e konkursit, miratimi i kritereve ose kualifikimeve të kërkuara për vendin vakant, kërkesa që i përcillet njësisë përkatëse për t'u rishqyrtuar, njoftimi i konkursit publik në Web-in e institucionit si dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike, afati 14 ditor që u lihet kandidatëve për të aplikuar nga publikimi i njoftimit në Web-in e institucionit, ngritja e një komision ad-hoc me urdhër të Rektorit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kandidaturave i cili proçedon sipas hapave qe kërkohen ne këtë rast në përputhje me rregulloren dhe proçedurën e punësimit të UV-se dhe deri në përzgjedhjen e kandidatit fitues [E2.7] |

Nga objektivat kryesore të UV, në kuadër të rritjes së cilësisë së tij të brendshme është edhe rekrutimi i personelit akademik që është kualifikuar në universitet e prestigjoze ndërkombëtare dhe në politikat e punësimit që ndiqen nga UV këtyre kandidatëve u jepet përparësi [E2.8].

**Institucion ndjek një politikë integruese të personelit akademik, personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ.** *(Kreu III Standardi IV.2.*

UV ndjek një politikë integruese të të gjithë të punësuarve të tij, me kohë të plotë, të pjesshme, të ftuar apo me kontratë në zbatimin në mënyrë rigoroze dhe korrekte të proçedurës së punësimit të personelit të tij qoftë ai akademik, apo administrativ [E1.66, E1.26]. Në statutin dhe rregulloren e tij të brendshme janë përcaktuar qartë kriteret dhe proçedurat e punësimit [E2.5 E.2.9] dhe kjo gjë zbatohet në përputhje me bazën ligjore. Në kuadër të integrimit të personelit të ri akademik UV ka miratuar Strategjinë për Trajnimin e Vazhdueshem të Kërkuesve të Rinj [E1.26] dhe Kartën dhe Kodin Evropian për Kërkuesit të cilat nxisin dhe integrojnë personelin në politikat dhe trajnimet e UV/së për këtë qëllim. [E1.27]

Në të njëjtën kohë, universiteti e angazhon stafin në organizimin e ditëve të hapura, [ E2.10, E2.11, E2.12] apo atyre të informimit të maturantëve në shkolla të mesme të ndryshme të qytetit, rajonit dhe më gjerë për të promovuar UV dhe për të tërhequr sa më shumë studentë që të bëhen pjesë e programeve të studimit të ofruara prej tij. Këto takime informuese shoqërohen me mjete informative shoqëruese si broshura [E2.13], fletëpalosje, postera, prezantime powerpoint etj të cilat shpalosin dhe japin një panoramë të shkurtër të politikave që ndjek universiteti dhe programeve të tij të studimit [E2.14]. Më shumë detaje lidhur me këtë gjë, gjenden tek faqja web e UV-së. (https://univlora.edu.al/category/aktivitete/) UV favorizon dhe përkrah integrimin e personelit ne jetën sociale të tij. Ai nxit dhe inkurajon pjesëtarët e stafit të vet të bëhen pjesë e aktivitete të ndryshme me karakter argëtues, informues, letrar, sportiv etj të organizuara nga institucioni, apo edhe nga institucione apo organizma të tjerë në rrethin e Vlorës [E2.15, E2.16] dhe jo vetëm.

**Institucion ndjek një politikë të vlerësimit të aftësive të personelit të tij.** *(Kreu III Standardi IV.3)*

Universiteti ndjek një plan trajnimi sipas prioriteteve të përcaktuara në planin e tij të zhvillimit strategjik [E1.55 ] dhe në strategjinë e miratuar të kërkimit shkencor [E1.79] .
Nga qëllimet kryesore të viteve të fundit dhe një nga politikat më të rëndësishme të UV/së është dhe ndërkombëtarizimi i tij [E1.57]. UV-ja ka hartuar dhe zbaton strategjinë për kërkuesit e rinj [E1.26, E.2 19]. Ai inkurajon promovimin dhe trajnimin e stafit me aktivitetet që ofron në ambientet e tij për këtë qëllim dhe mbështet financiarisht pjesëmarrjen e tyre në konferenca dhe aktivitete shkencore brenda dhe jashtë vendit së bashku me botimin e artikujve në buletine dhe revista shkencore prestigjioze me qëllim kryesor rritjen e nivelit shkencor të personelit të vet [E2.20]. Në të njëjtën kohë universiteti nxit, mbështet dhe financon pjesëmarrjen e stafit në vitin sabatik [E 1.110, E1.110.a] për të kryer studime kërkimore- shkencore në universitete jashtë vendit. UV/ja vlerëson arritjet e personelit të tij duke bërë një vlerësim të performancës së tyre në dy nivele, nga departamenti dhe nga Njësia e Sigurimit të Cilësisë së Brendshme. Proçedura e ndjekur për këtë lloj vlerësimi evidentohet në evidencën. [E2.22]

UV ka aktualisht të ngritur një komision për gradën shkencore "Doktor" në Matematikë, në përbërjen e të cilit bën pjesë një profesor nga Universiteti i Prishtinës, Kosovë. [E2.23, E2.24] Përsa i përket kriterit ku si parakusht kërkohet një ekperiencë 1 vjeçare në dhënien e titullit "Profesor", mund te themi se kjo praktikë nuk është e aplikueshme në UV, por vetëm ne Universitetin e Tiranës pasi UV-ja nuk i përmbush kushtet për dhënien e titullit "Profesor".

**Institucion ndjek një politikë të zhvillimit social.** *(Kreu III Standardi IV.4)*

Krahas anagazhimit në jetën akademike dhe kërkimore shkencore, personeli i UV-së është përfshirë edhe në aktivitete të tjera me karakter social ku ai jep kontributin e vet në shoqëri dhe komunitet [E1.55]. Në këtë kuadër, vlen të përmenden si shembuj të praktikës së mirë kontributi i përfaqësuesve të Fakultetit të Shëndetit Publik të cilët organizojnë vazhdimisht një numër aktivitetesh me karakter social dhe ndërgjegjësim të popullatës për çështje të prekshme dhe me ndikim në komunitetet, si për shembull "Dhuro Gjak", " Dita botërore kundër HIV dhe AIDS", lufta kundër kancerit, duhanpirjes apo edhe fushata ndërgjegjësimi për shëndetin mendor, apo atë të gruas. (https://univlora.edu.al/sherbime-per-komunitetin-promocion-shendetsor) [E2.25] Një tjetër shembull i praktikës së mirë që vlen të përmendet është edhe ngritja e Klinikës së Ligjit pranë Departamentit të Juridikut [E2.26], i përzgjedhur nga Qëndra Evropiane dhe Ambasada Amerikane që financojnë këtë projekt. organizimi i pjesëve teatrale nga studentë të Univlorës, organizime aktivitetesh [E2.26, E2.27, E2.28] me karakter sportiv [E2.15] argëtues, informues etj. Në këtë logjikë, mund të thuhet se politikat e ndjekura dhe zbatuara nga institucioni janë në përputhje të plotë me ligjin, jo vetëm për studentët dhe punonjësit e tij, por edhe më gjerë, duke dhënë kontributin e tij në komunitet [E1.1].

**Institucioni siguron menaxhimin efikas të burimeve njerëzore.** *(Kreu III Standardi II.2)*

Në statutin e UV-së përkatësisht në nenet 45, 46 janë përcaktuar qartë funksionet dhe hierarkia e burimeve njerëzore të rekrutuara. Ai siguron një menaxhim efikas të burimeve njerëzore për caktimin e përgjegjësive sipas funksioneve respektive, duke vlerësuar dhe zbatuar me rigorozitet jo vetëm bazën e tij ligjore, [E1.1, E1.5] por edhe kapacitete njerëzore të rekrutuara. Çdo anëtar i personelit është i pozicionuar në varësi të funksionit dhe qëllimit të rekrutimit në UV. [E 2.30, E2.31].

**Menaxhimi Financiar**

**Institucioni harton buxhetin në përputhje me procedurat e përcaktuara.** *(Kreu III Standardi VI.1)*

UV i shpërndan dhe i përdor burimet financiare në përputhje me rregullat dhe standartet e programit buxhetor dhe menaxhimit financiar publik [E1.1, neni 87]. Ai harton projekt buxhetin në fillim të çdo viti në varësi të kërkesave dhe propozimeve konkrete që vijnë nga njësitë bazë dhe kryesore [E2.32], si dhe buxhetin afatmesëm në varësi të rregullave dhe procedurave të vendosura nga Ministria e Financave dhe rregullorja e BA [E2.33]. Hartimi i buxhetit, si për çdo institucion tjetër të arsimit të lartë bëhet sipas strukturës së Buxhetit të Shtetit, të përcaktuar me udhëzim të Ministrit të Financave të Republikës së Shqipërisë. Pas hartimit buxheti i propozuar diskutohet në senat [E2.32] dhe në bordin e administrimit [E2.33] të institucionit. Pas miratimit

| |
|---|
| buxheti i detajuar [E2.34] kalon për menaxhim në zyrën e financës dhe delegohet në varësi të kërkesave apo nevojave të njësive bazë të paraqitura më parë [E2.35 ]. |
| **Institucioni siguron mjetet e nevojshme për të zbatuar politikën financiare.** *(Kreu III Standardi VI.2)*<br><br>Sipas nenit 13 të Statutit, Administratori është përgjegjës për zbatimin e politikës financiare. Nën varësinë e tij janë Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, Sektori i Financës dhe realizimit të buxhetit, sektori i prokurimeve dhe sektori i shërbimeve. Ndërsa nën varësinë e Bordit të Administrimit, i cili është organi më i lartë kolegjial administrativ i UV-së që garaton mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij, është sektori i auditit.<br>Zyra e financës harton raporte financiare të detajuara [E1.23] dhe zbaton me përpikmëri dhe rigorozitet buxhetin e hartuar [E1.24] duke ndjekur një politikë transparente të shpërndarjes së burimeve financiare të cilën e publikon rregullisht në faqen e internetit të Univlorës. (https://univlora.edu.al/raporti-financiar/)<br>Gjithashtu Sektori i Menaxhimit të Buxhetit, është përgjegjës për respektimin e rregullave të kontabilitetit, në përputhje me rregullat dhe kriteret e administrimit financiar të institucioneve të tjera publike [E2.36]. Universiteti analizon të gjithë treguesit e monitorimit të zbatimit të politikave financiare [E2.37] dhe zbaton rregullat e kontabilitetit në bazë të legjislacionit përkatës në fuqi si edhe rregullat e administrimit financiar të cilat janë të njëjta për institucione të tjera. Në mbledhje periodike të BA [E2.38, E2.39] analizohen treguesit e zbatimit të politikës financiare, rezultatet e detajuara të të cilave publikohen rregullisht në faqen e internetit të UV/së (https://univlora.edu.al/raporti-financiar/). |
| **Institucioni ndjek një politikë të kontrollit buxhetor dhe financiar.** *(Kreu III Standardi VI.3)*<br><br>Institucioni i nënshtrohet rregullisht auditimit të tij të brendshëm që kryhet nga sektori i auditit. [E2.40]. Në Vendimin e SA (Nr. 83, datë 12.12.2016) u vendos për krijimin dhe funksionimin e njësisë së auditimit të brendshëm të UV-së [E2.41].<br>Në zbatim të pikës 1 të nenit 116 të Ligjit 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë" veç auditit të brendshëm UV/ja i nënshtrohet edhe auditit të MASR-së. Këto kontrolle janë periodike [E2.42] dhe të gjitha raportet që krijohen pas inspektimeve së bashku me rekomandimet përkatëse bëhen publike dhe diskutohen në mbledhje të Bordit të Administrimit [E2.43] dhe me personelin e UV-së.<br>Raportet e KLSH-së, e auditit të MASH-it dhe të auditit të vetë institucionit diskutohen rregullisht në mbledhjet e BA [E2.44] dhe vendimet e këtyre mbledhjeve bëhen publike edhe në faqen zyrtare të UV/së (https://univlora.edu.al/bordi-i-administrimit/). |
| **Menaxhimi i Sistemeve të Informacionit** |
| **Institucioni disponon një sistem të informimit.** *(Kreu III Standardi VII.1)*<br><br>UV ka siguruar strukturat përkatëse për zhvillimin dhe përhapjen e informacionit qoftë në nivel vertikal por edhe në nivel horizontal. Veprimtaria e këtyre strukturave është përcaktuar qartë në Statutin e UV-së (neni 29-50, fq. 23-35) [E1.1] në rregullore dhe aktet e brendshme vetërregulluese. Koordinimi dhe funksionimi i marrëdhënieve institucionale ndërfakultetore në |

UV janë përcaktuar me Vendim të SA-së mbi "Rregullimin dhe ushtrimin e kompetencave të autoriteteve dhe organeve drejtuese" [E2.45].
Duke iu referuar Vendimit të SA-së mbi "Miratimin e disa ndryshimeve në organigramën e UV-së" [E1.85] përgjegjës për koordinimin dhe Menaxhimin e Sistemeve të Informacionit (MIS) në UV është sektori i IT-së, i cili është në varësi të DKBNJ. Veprimtaria e këtij sektori koordinohet në nivel institucional nga përgjegjësi i sektorit dhe në nivele të njësive kryesore nga specialistët e IT-së në to. Gjithashtu, përgjegjës për koordinimin e MIS në sektorin e Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun është *Specialisti i Informacionit,* i cili shërben për koordinimin e informacionit të brendshëm dhe një *Specialist (përkthyes dhe kurator WEB-i),* i cili shërben për koordinimin e informacionit të jashtëm.
Për të mbështetur dhe lehtësuar funksionimin e proçedurave akademike, administrative dhe dixhitalizimin e të dhënave, UV ka siguruar Sistemin e Menaxhimit të Informacionit mësimor UVMS [E2.46], [E2.47]. UV është një institucion që ndjek një politikë të mirë dhe transparente në lidhje me menaxhimin, zhvillimin dhe publikimin e informacionit si brenda institucionit por edhe jashtë tij, duke ruajtur konfidencialitetin e të dhënave.
UV zhvillon një politikë të qartë mbi mënyrën e regjistrimit, administrimit dhe përpunimit të të dhënave [E2.48]. Informacioni që sigurohet nga MIS [E2.46] shërben për hartimin e raporteve vjetore dhe periodike të DSBCZI, DECI/II si dhe DKBNJ. NJSBCVI përpilon raportin e analizës së pyetësorëve, formulari i të cilit është miratur me Vendim të SA-së [E2.49a] [E2.49b]. Të dhënat e pasqyruara në këtë raport japin një informacion të rëndësishëm për Njësitë Kryesore/Bazë për përmirësimin e mëtejshëm të veprimtarisë akademike dhe programeve mësimore. Gjithashtu, UV ka vënë në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik një adresë të posaçme elektronike për adresimin e ankimimeve, e miratuar kjo me Vendim të SA-së [E2.50]. Nëpërmjet platformës së vet dixhitale [E2.51] u ofron mundësi studentëve dhe çdo grupi interesi, të kenë në çdo kohë, një pasqyrë të qartë orientuese, ndihmuese dhe transparente për ofertën akademike, administrative, sociale, kulturore e sportive të UV-së, brenda dhe jashtë proçesit mësimor [E2.52]. Kjo faqe ofron informacion në lidhje me historikun, përbërjen dhe funksionimin e institucionit, statutin dhe rregulloret e drejtorive dhe departamenteve përkatëse, numrin e studenteve dhe stafit akademik, etj. [E2.46]. Njëkohësisht UV bën publike raportin e saj vjetor, i cili përmban të dhëna statistikore në nivel njësie kryesore/bazë por edhe në nivel institucional, në përputhje me programin e saj të transparencës [E2.53, E2.54].

**Institucioni bashkërendon veprimtaritë në fushën e teknologjisë së informacionit.** *(Kreu III Standardi VII.2)*

Për të mundësuar koordinimin e informacionit qoftë horizontalisht apo vertikalisht, UV ka aplikuar UVMS-në, një sistem i integruar për menaxhimin e mësimdhënies dhe shërbimeve të tjera për studentët [E2 47]. Qëllimi primar i sistemit është menaxhimi i të dhënave të studentëve dhe përmirësimi i proçeseve akademike dhe administrative. Secili përdorues pajiset me një fjalë-kalim dhe kod sigurie për të menaxhuar llogarinë e tij. Të dhënat e siguruara nga UVMS janë të dhëna të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme vetëm nga personat e autorizuar.
UV ka përcaktuar qartë personelin përgjegjës, i cili ka akses në të dhënat personale manuale dhe ato elektronike. Struktura përgjegjëse për menaxhimin e databazës së programit kompjuterik është zyra e IT-së. Përgjegjësi i Zyrës së IT-së përgjigjet për proçese të tilla si: grumbullimi, regjistrimi, ruajtja, renditja, përshtatja, rregullimi, shfrytëzimi, përdorimi, bllokimi, fshirja ose

shkatërrimi i të dhënave personale që bëhen nëpërmjet këtij program kompjuterik. Theksojmë se personeli që ka akses në këto të dhëna, i përdor ato në përputhje me rregulloren për "Mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale", rregullore kjo e miratuar me Vendim të SA-së, e cila është në përputhje me Udhëzimin nr. 07, datë 09.06.2010 "Për përpunimin e të dhënave personale në sektorin e arsimit" [E2.53].
Çdo dokumentacion i bazuar në të dhënat e UVMS, verifikohet me databazën në hardcopy (regjistra e ndryshëm apo dokumenta të tjera) dhe merr formë ligjore kur nënshkruhet nga personi përgjegjës. Komunikimi midis stafit akademik/ ndihmësakademik - student dhe anasjelltas realizohet nëpërmjet adresave zyrtare të email-it të stafit dhe studentëve (emer.mbiemer@univlora.edu.al). Zyra e IT-së ka vënë në dispozicion manualet e përdorimit të tij për stafin akademik dhe për studentet [E2.55].

UV ka në dispozicion të personelit dhe të studentëve 1 (një) sallë audiovizive, tre (3) salla kompjuterash dhe 1 (një) sallë multimedia. UV ofron disa salla mësimore të cilat janë të pajisura me mjete audio vizive si projektorë, dërrasa inteligjente apo kompjutera në varësi të programit të studimit dhe lëndës përkatëse. Për zhvillimin e orëve laboratorike UV ka vënë në dispozicion të çdo fakulteti/departamenti 25 laboratorë mesimorë ku ndër ta, laboratorë informatike ka 1 (një) në Godinën A dhe 2 (dy) në Godinën B [E2.56]. Çdo laborator përmban softe kompjuterike përkatëse në varësi të kërkesave të departamentit [E2.57]. Aktualisht UV nuk ofron programe të edukimit në distancë.

**Institucioni menaxhon pasuritë e paluajtshme.** *(Kreu III Standardi VI.3,*

Në nenin 89 të Statutit të UV-së [E1.1] shprehet qartë se UV ka marrë nën administrim 3 (tre) Godina shtetërore nën pronësinë e MASR-së [E2.58]. Godina A në të cilën ndodhet Rektorati dhe Fakulteti i Ekonomisë ka një sipërfaqe 3740 $m^2$, Godina B në të cilën ndodhet Fakulteti i Shkencave Humane ka një sipërfaqe 3040 $m^2$, Godina C në të cilën ndodhet Fakulteti i Shkencave Teknke ka një sipërfaqe 3800 $m^2$, si dhe Godina D (godinë e marrë me qera) në të cilën ndodhet Fakulteti i Shendit Publik ka një sipërfaqe 2777.6 $m^2$ [E2.13]. Në vitin 2018 me Vendim VKM Nr. 658 dt. 30.10.2018, UV ka marrë në dispozicion një sipërfaqe "truall" për të cilën UV ka të drejtë ta administrojë për qëllimet e veta [E2.59].
UV ka në dispozicion 3 (tre) godina shtetërore dhe ka kryer vazhdimisht punime të një master-plani mbi sigurinë, rehabilitimin, zgjerimin, dhe ristrukturimin e pasurive të paluajtshme. Më poshtë po përmendim disa vendime që UV ka ndërmarrë gjatë viteve 2017-2019 për të realizuar veprimtarinë e tij: rikonstruksioni i Godinës B [E2.60]; rikonstruksioni i Godinës A & C [E2.61]; rikonstruksioni i tualeteve dhe biblotekës në Rektorat [E2.62]. Gjithashtu, UV ka ndërmarrë me Vendim SA-së nisjen e proçedurave për ngritjen e godines së re për të plotësuar kërkesat e Fakultetit të Shëndetit Publik, e parashikuar kjo në buxhetin e UV-së për vitin 2020 [E2.63].
Menaxhimi i aseteve në UV përcaktohet në nenin 87 të Statutit të saj [E1.1]. UV ka në strukturën e vet Sektorin e Shërbimeve [E 1.85], që merret me menaxhimin e aseteve të saj sipas një plani të përcaktuar. Zyra e mirëmbajtjes është përgjegjëse për mbarëvajtjen e tyre. Për të lehtësuar procedurat administrative së fundmi, UV ka aplikuar një soft kompjuterik për menaxhimin e aseteve afatshkurta dhe afatgjata. Gjithashtu, UV për të plotësuar nevojat e të tretëve ka miratuar me Vendim SA cmimin per dhënien me qera të disa ambjenteve të saj [E2.64].

UV mbikëqyr projektet e ndërtimit dhe të rindërtimit të aseteve të saj nëpërmjet kontraktimit të ekspertëve të jashtëm. Mbikëqyrja dhe kolaudimi i rikonstruksioneve të projekteve të ndërtimit dhe rindërtimit është bërë konform VKM-së Nr. 354 dt. 11.05.2016.

**Institucioni siguron ruajtjen, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë së tij akademike, kulturore dhe shkencore.** *(Kreu III Standardi VII.4)*

UV ka vënë në dispozicion të studentëve, pedagogëve, studiuesve dhe stafit të këtij Institucioni 3 (tre) biblioteka me 3 (tre) salla leximi, me personel 4 (katër) vetë, me vendndodhje, përkatësisht Biblioteka qendrore, në Godinën A (Rektorati), që mbulon dhe Fakultetin e Ekonomisë me personel 2 (dy) specialistë, Biblioteka B, në Fakultetin e Shkencave Humane me 1 (një) specialist (që mbulon edhe Fakultetin e Shëndetit Publik) dhe Biblioteka e re në godinën C, në Fakultetin e Shkencave Teknike me 1 (një) specialist/e. Sektori i Biblotekës Shkencore pranë UV-s, ndjek një politikë të ruajtjes së trashëgimisë së tij akademike, kulturore dhe shkencore, duke shërbyer si një strukturë e depozitimit të infomacionit të shkruar dhe elektronik dhe të organizimit të aktiviteteve ku promovohen libra, autorë dhe tendenca bashkëkohore kulturore, shkencore e letrare.

Çdo pedagog (me kohë të pjesshme ose të plotë) dorëzon tekstet mësimore dhe/ose tekstet e ushtrimeve që ka përdorur dhe përdor në kurset e tij pranë Sektorit të Shërbimeve të Librit për tu ardhur në ndihmë studentëve, të cilët nuk kanë mundësi financiare për ti blerë ato [E2.65]. Theksojmë se çdo publikim i stafit akademik ka plotësuar kriteret e publikimit të tyre në përputhje me Vendimin e miratuar nga SA [E2.66]. Gjithashtu, çdo pedagog dorëzon listën e punimeve të diplomës së ciklit të dytë dhe të tretë në hard copy tek të dyja Biblotekat e UV-së (Sektori i Shërbimeve të Librit) [E2.65]. Çdo veprimtari kërkimore-shkencore e stafit akademik është në përputhje me "Rregulloren e Etikës mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore dhe botuese" e miratuar me Vendim të SA-së [E2.67].

SA ka miratuar listën e disa botimeve që do të përbëjnë "minibibliotekë zyre" në formë pakete për zyrat e autoriteteve drejtuese, kryesekretareve, sekretarive mësimore dhe administratës (sektorë, drejtori) me qëllim që secili autoritet e punonjës i Universitetit të ketë njohuri të përgjithsme për gjuhën shqipe, shkrimin e saj, popullin shqiptar, identitetin, vlerat kombëtare, historinë, kulturën dhe letërsinë shqipe, Kosovën, arbëreshet etj. [E2.68]. UV ka marrë në pronësi Opusin e trashëgimisë kulturore të Lefter Çipës, të cilat përbëjnë një pasuri kombëtare jo vetëm për studentët e fushës, që vijojnë studimet e nivelit të dytë, por edhe për pedagogët dhe studiuesit shqiptarë apo të huaj. Gjithashtu, UV ka botuar *Bibliografinë e "Botime të pedagogëve të Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë, pjesa 1 (1994-2006)*, ndërsa *Bibliografia "Botime të pedagogëve të Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë, Libra. Pjesa 2 (2006-2020)* është në proçes. UV ndjek një politikë të vlerësimit dhe zhvillimit të pasurive të tij akademike, kulturore dhe shkencore, duke mbështetur stafin akademik në botimet e artikujve shkencore në Buletinin e UV-së, promovimin e librave dhe krijimin e arkivës dixhitale [E2.69]. UV promovon shembuj të praktikave të mira, nxit e inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies e kërkimit shkencor nëpërmjet mbështetjes financiare [E2.70]. UV boton periodikisht dhe vë në dispozicion të stafit dhe studentëve Buletinin e saj Shkencor (nga viti 2013- me ISSN 2310-6719), i cili përmban artikujt shkencorë të pedagogëve të UV-së, të autorëve të tjerë shqiptarë apo të huaj. Ky Buletin është hapur në vitin 2001 dhe shërben si një pasuri jo vetëm për UV-në por edhe më gjerë. 13 buletinet e para (nga viti 2001- 2008) janë

regjistruar në programin COBISS.Net dhe po vijohet me përditësimin e artikujve të boletinëve me ISSN. Për dixhitalizimin e standardizuar dhe të unifikuar të librit/ tekstit mësimor apo artikujve shkencorë të nevojshëm, UV është në proçes unifikimi me rrjetin e Bibliotekave Universitare me lider Bibliotekën e Akademisë së Shkencave, për përmbushjen e planit kombëtar për dixhitalizimin e Bibliotekave Universitare dhe atyre të rrjetit.

**Institucioni ndjek një politikë të menaxhimit të aseteve të tij.** *(Kreu III Standardi VII.5)*

UV është hapur me Vendim VKM Nr.105 dt. 28.02.1994, me disa fakultete, ku iu dha në përdorim nga MASH 3 (tre) Godina: A, B, C [E1.1, neni 89]. Këto godina janë rikonstruktuar vazhdimisht për të përmirësuar kushtet për zhvillimin e veprimtarisë akademike dhe administrative. Me zgjerimin e degëve dhe fakulteteve, në përputhje me kërkesat e tregut, UV ka rritur kapacitetet e saj fizike duke marrë me qera Godinën D, në të cilën zhvillon veprimtarinë e tij FSHP. Gjithashtu, UV ka marrë në administrim një sipërfaqie truaili prej 6301 m$^2$ me Vendim VKM Nr. 658 dt. 30.10.2018, në zonën kadestrale 8602, me Nr. pasurie 2/149 të MASR-së të cilën e ka shfrytëzuar për zhvillimin e aktiviteteve sportive në funksion të studentëve [E2.59].
Godina e Rektoratit (Godina A) është godinë me 4 kate dhe ka një sipërfaqe 1360 m$^2$. Në të ndodhen zyrat e Rektoratit dhe Administratës së UV-së. Godina e Fakultetit Ekonomik (Godina A) është godinë me 4 kate, ka një sipërfaqe 2360 m$^2$, në të cilën ndodhen 11 salla leksionesh me kapacitet total prej 724 vëndesh, 8 salla seminari me kapacitet total prej 345 vëndesh, 1 laborator mësimor dhe 1 bibliotekë me 70 vënde leximi. Godina e Fakultetit të Shkencave Humane ka një sipërfaqe 3040 m$^2$, është godinë me 4 kate, në të cilën ndodhen 14 salla leksionesh me kapacitet total prej 800 vëndesh, 6 salla seminari me kapacitet total prej 200 vëndesh, 3 laboratorë mësimorë dhe 1 bibliotekë me 40 vënde leximi. Godina e Fakultetit të Shkencave Teknike ka një sipërfaqe 3800 m$^2$, është godinë me 5 kate, në të cilën ndodhen 6 salla leksionesh me kapacitet total prej 610 vëndesh, 3 salla seminari me kapacitet total prej 150 vëndesh, 14 laboratorë mësimorë dhe 1 bibloteke me 30 vënde leximi. Godina e Fakultetit të Shëndetit Publik ka një sipërfaqe 2056 m$^2$, është godinë me 2 kate, në të cilën ndodhen 3 salla leksionesh me kapacitet total prej 225 vendesh, 3 salla seminari me kapacitet total prej 150 vëndesh, 6 laboratorë mësimorë [E2.56]. Institucioni siguron akses interneti në të gjitha godinat që disponon, në çdo zyrë stafi apo sektori të tij. Gjithashtu, ai siguron internet Wi-fi në të 4-ta godinat për tu ardhur në ndihmë studenteve dhe stafit akademik. Theksojmë se të gjitha godinat plotësojnë standartet e sigurisë nëpërmjet monitorimit me kamera dhe mbrojtjes me polici private.
Vazhdimisht UV ka kryer investime duke restauruar Godinat A, B, C dhe vë në dispozicion ambiente pune komode për të realizuar veprimtarinë e tij. Në total në UV ndodhen 92 zyra të cilat zënë një sipërfaqe të përgjithshme prej 3085 m$^2$, të ndara si më poshtë [E2.56]:

- Në Godinën e Rektoratit (Godina A), në të cilën ndodhen zyrat e rektoratit dhe administratës së UV-së, ka gjithsej 16 zyra me një sipërfaqe 475 m$^2$.
- Në Godinën e Fakultetit Ekonomik (Godina A) ka gjithsej 15 zyra me një sipërfaqe 425 m$^2$.
- Në Godinën e Fakultetit të Shkencave Humane (Godina B), ka gjithsej 25 zyra me një sipërfaqe 475 m$^2$.
- Në Godinën e Fakultetit të Shkencave Teknike (Godina C), ka gjithsej 26 zyra me një sipërfaqe 900 m$^2$.
- Në Godinën e Fakultetit të Shëndetit Publik (Godina D), ka gjithsej 10 zyra me një sipërfaqe 555 m$^2$.

| |
|---|
| Çdo anëtar i personelit akademik dhe ndihmësakademik është i pajisur me bazë logjistike (tavolinë, karrike, dollapë, pc apo laptop, printer e fotokopje, kondicioner, mjete kancelarike etj) si dhe gëzon akses në internet në funksion të realizimit të detyrave profesionale respektive. Sipërfaqet e mjediseve që Universiteti ka vënë në dispozicion të stafit akademik për kryerjen e aktivitetit të tyre didaktik dhe shkencor janë në raport të drejtë me numrin e tyre dhe në përputhje të plotë me standartet shtetërore. |
| **Institucioni ngre një strukturë logjistike administrative për kryerjen e funksioneve me interes të përbashkët** *(Kreu III Standardi VII.6)* |
| UV ka ngritur një strukturë logjistike administrative me qëllim kryerjen e funksioneve me interes të përbashkët. FSHH, FSHP dhe FSHT, nëpërmjet teknologjisë së tyre laboratorike, ofrojnë shërbime për të tretë, në përputhje me nevojat e tregut. Më konkretisht, pranë Departamentit të Drejtësisë në FSHH është ngritur Klinika e Ligjit e cila ofron shërbime falas për një grup të caktuar të popullatës [E2.26]. Po ashtu, FSHP gjatë promovimeve të saj në "Ditët e Shëndetit" vë në dispozicion logjistikën e saj dhe ofron shërbime shëndetsore falas në popullatë [E2.25]. Ndërsa, Q.K.SH pranë FSHT-së e cila është e pajisur me laboratorë të fushave të ndryshme si: biologji, kimi, mjedis, inxhinieri etj., ka kapacitet e mundshme për të ofruar shërbime ndaj të tretëve sa herë ka shfaqje interesi [E2.57]. UV nuk kryen anketime mbi këto shërbime logjistike. |
| **Menaxhimi i Veprimtarisë së Institucionit** |
| **Institucioni siguron mjedise dhe infrastrukturë të përshtatshme për veprimtarinë akademike-shkencore.** *(Kreu III Standardi V.1)* |
| UV ka në dispozicion të studentëve, pedagogëve, studiuesve dhe stafit të tij 3 (tre) godinave (godina A, B dhe C) dhe një ambjent me qera (Godina D), të cilat janë ristrukturuar herë pas here për të përmirësuar dhe plotësuar standartet e mësimdhënies në to [E2.60], [E2.61], [E2.62]. Në mënyrë periodike UV i nënshtrohet inspektimit të ujit të pijshëm nga DRSH Vlorë si dhe inspektimit Shtetëror Shëndetësor nga Dega Rajonale e Qarkut Vlorë [E2.71]. Këto godina janë të ndërtuara me materiale cilësore bashkëkohore të cilat plotësojnë kushtet higjieno-sanitare për studentët dhe personelin akademik e administrativ. Gjatë rikonstruksioneve të kryera, është siguruar që të treja godinat A, B dhe C të plotësojnë standartet teknike të projektit duke ofruar akustikë të mirë në ambientet e mësimit dhe të jenë të izoluara nga zhurmat, luhatjet e temperaturës dhe lagështirës. Godinat A, B, C dhe D shtrihen në qendër të zonës urbane, duke shmangur kështu zonat të zhvillimit industrial apo zonat me ndotje të cilat gjenden në periferi të qytetit [E2.72]<br>Me qëllim përmbushjen e objektivave të mësimdhënies, UV siguron mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë akademike dhe administrative. Konkretisht UV disponon auditor mësimi (53 salla), ambiente për laboratorë në fakultete (25 laboratorë), ambiente për personelin pedagogjik në departamentet përkatëse (76 zyra), ambiente për personelin administrativ pranë zyrave të rektoratit (16 zyra), ambiente teknike dhe magazinimi (në çdo godinë): 1 (një) sallë Senati, 1 (një) sallë audiovizive, tre (3) salla kompjuterësh dhe multimedieje. Gjithashtu, UV siguron 3 (tre) salla bibloteke të cilat janë të pajisura me mjete audio vizive si projektorë, dërrasa inteligjente dhe kompjutera [E2.56]. |

Bazuar në Raportin e MASR-së mbi "Verifikimin e kapaciteteve pritëse për pranimet në programet e studimit, sipas kuotave të deklaruara për vitin akademik 2019-2020, UV ofron një normativë te pritshme sipas fakulteteve si më poshtë:

- Fakulteti i Shkencave Teknike ofron një normativë të pritshme prej 4.7 $m^2$/ student.
- Fakulteti i Ekonomisë ofron një normativë të pritshme prej 2.4 $m^2$/ student.
- Fakulteti i Shkencave Humane ofron një normativë të pritshme prej 3 $m^2$/ student.
- Fakulteti i Shendetit Publik ofron një normativë të pritshme prej 3.4 $m^2$/ student [E2.73].

Referuar VKM Nr. 418, dt. 10.05.2017, UV për të përmbushur normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme është duke ngritur godinën e saj të re, e cila është parashikuar në buxhetin e vitit 2020 [E2.74].

UV ka vënë në dispozicion të formimit praktik të studentëve mjedise të posaçme, të cilat janë të përshtatshme dhe të mjaftueshme për zhvillimin e proçesit praktik mësimor. Në total UV zotëron 25 laboratorë mësimorë të cilët janë të pajisur me pajisje elektronike dhe të IT-së, sinjal internet free, të cilat garantojnë realizimin e proçesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodave teknologjike bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. Gjithashtu, laboratorët mësimor sigurojnë infrastrukturën e duhur për zhvillimin dhe realizimin e orëve laboratorike [E2.57]. Bashkëpunimi me institucionet vendase, publike dhe private, ka qenë në kuadër të realizimit të praktikave mësimore të ofruara në programin e ciklit të parë dhe të dytë të studimit (Master Profesional) në degët përkatëse.

UV i plotëson normativat teknike të ndriçimit natyral, sipërfaqja e dritareve mbulon minimalisht (15 – 20) % të sipërfaqes së dyshemesë dhe ndriçimi është i orientuar nga krahu i majtë i studentit, dhe lartësia e ambienteve është jo më e vogël se 3.0 m (tavan-dysheme) [E2.60], [E2.61]. Aktualisht vetëm Salla "Rilindja" dhe Godina C janë të vetme struktura që kane kapacitete për më shumë se 200 studentë dhe kanë dalje emergjente. UV ka një sistem të mbrojtjes së shkarkesave atmosferike si dhe një sistem të mbrojtjes kundra zjarrit. Çdo godinë është e pajisur me sinjalizues dhe në hollet e çdo godine janë të instaluara bomblat kundra zjarrit si dhe hidratantët, të cilët janë të shoqëruar edhe me sinjalistikën përkatëse. Në mënyrë periodike UV ka paraqitur kërkesën e saj për të blerë police sigurimi nga zjarret dhe rreziqet shtesë [E2.75].

Institucioni siguron në pjesën më të madhe të sallave dhe zyrave sisteme ajri të kondicionuar ndërkohë që Godinat B dhe C kanë të instaluar sistemin e ngrohjes së centralizuar (kaldaja) [E2.76]. UV disponon burime alternative për furnizimin me energji elektrike (1 motogjenerator në Godinën A dhe 1 motogjenerator në Godinën B) [E2.77], si dhe rezerva të mjaftueshme të ujit të përdorshëm (nga një depozitë uji për çdo godinë) [E2.78].

**Institucioni disponon dokumentacion të plotë të veprimtarisë akademike në letër (hardcopy) dhe në formë elektronike.** *(Kreu III Standardi V.2)*

Referuar organigramës [E1.85] së UV-së, dhe në zbatim të Ligjit për Arsimin e Lartë, Universiteti ka ngritur në strukturën e tij sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arkivës, si pjesë e DKBNJ, si një strukturë përgjegjëse për mbledhjen, krijimin, regjistrimin, ruajtjen dhe arkivimin e dokumentave në nivel institucional. Zyra e Burimeve Njerezore është struktura përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të angazhuar në programet e studimit. Ndërsa zyra e Protokoll-Arkivës dhe sekretaritë mësimore të çdo njësie bazë dhe kryesore janë përgjegjëse për mbledhjen, regjistrimin, ruajtjen, përditësimin dhe arkivimin e dokumentacionit institucional dhe të të dhënave personale të studentëve.

Detyrat e këtij sektori rregullohen nëpërmjet rregullores "Për krijimin, regjistrimin, ruajtjen, shërbimin, dorëzimin e dokumentave në UV e miratuar nga SA [E2.48]. Ndërsa, ruajtja dhe administrimi i dokumentacionit akademik dhe administrativë në fakultete dhe departamente është përcaktuar qartë me Vendim të SA [E2.79].
UV ka një strukturë të posaçme, pra Sektorin e IT-së, e cila është përgjegjëse për dixhitalizimin e të dhënave, ruajtjen e dokumentacionit në formë elektronike dhe për mbledhjen e statistikave [E2.80]. Sistemi kompjuterik UVMS administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve te angazhuar në realizimin e programit [E2.47].
UV ka në organigramen [E 1.85] e vet Sektorin e Kurrikulave dhe Sherbimit të Studentëve si pjesë të DECI'II, i cili është përgjegjës për mbledhjen e statistikave. Ky sektor grumbullon informacion rreth studentëve dhe stafit akademik të çdo fakulteti nga sekretaritë përkatëse. Grumbullon informacion nga Burimet Njerëzore për stafin akademik. Grumbullon informacion nga Financa për fondin e pagës, sigurimet shoqërore, numrin e punonjësve të brendshëm dhe të jashtëm si dhe grumbullon informacion për studentët bursistë nga specialistët e shërbimit të studentëve [E2.81].
Çdo student që regjistrohet për herë të parë në UV, i jepet një numër unik matrikullimi që e shoqëron deri në marrjen e diplomës ose çertifikatës, duke respektuar udhëzimet e MASR-së. Regjistrimi, përdorimi dhe përpunimi i të dhënave personale të studenteve bëhet prej sekretarisë mësimore ne përputhje me ligjin Nr.9887, datë 10.3.2008 për mbrojtjen e të dhënave personale në Shqipëri.

UV në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, mban në formë të shkruar dhe elektronike:

a) Regjistrin themeltar të studentëve;
b) Regjistrin e arritjeve akademike ku hyn dhe proçesverbali i çdo provimi apo detyrimi tjetër akademik;
c) Regjistri i lëshimit të diplomave dhe çertifikatave.

UV disponon të dhëna të përgjithshme për programin, formën, planin mësimor, të shoqëruar me kreditet e detyrueshme të studimeve. I gjithë dokumentacioni ruhet pranë sekretarive të çdo departamenti/ fakulteti përgjegjës dhe në Rektorat [E2.79]. UV i ka dedikuar studenteve një hapësirë në faqen e saj të Web-it, e cila u mundëson atyre marrjen e informacionit në lidhje me oraret e provimeve, kalendarin akademik, bibliotekën etj.. Po ashtu studentet mund të marrin informacion mbi kurrikulat, regjistrimet në leksione dhe seminare, leksionet e postuara, sallat e mësimdhënies etj. nëpërmjet aksesit të tyre në sistemin informativ UVMS. Në strukturën e tij organizative UV ka sektorin e Kurrikulave dhe Shërbimit ndaj Studentëve, sektor i cili ndër funksionet e tij operative ka përgatitjen dhe përmbledhjen e kurrikulave dhe syllabuseve për çdo program studimi në çdo semestër.
Sekretaria mësimore e çdo Fakulteti apo Departamenti përpilon, administron dhe është përgjegjëse për mirëmbajtjen e regjistrit themeltar (bazë) të studentëve [E1.6]. Ky regjister plotësohet ne formë të shkruar dhe elektronike, pa korrigjime dhe nuk ndryshohet për asnjë arsye. Ai mbahet në ruajtje të përhershme [E2.82].
Sekretaritë mësimore të Fakulteteve dhe Departamenteve të UV-së, ndjekin dhe regjistrojnë hap pas hapi gjithë aktivitetin studimor të studentit sipas planit specifik të studimit, deri në

përmbushjen e plotë të detyrimeve akademike të studentit. Ato mbajnë një regjistër bazë të studentëve me të dhënat e tyre personale, vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit, të dhëna mbi diplomën ose diplomat e marra bashkë me suplementin e diplomës etj., të formatuara këto sipas standardeve shtetërore [E2.83]. Regjistri i arritjeve akademike plotësohet me shkrim, pa korrigjime dhe nuk ndryshohet për asnjë arsye.

**Përfundimet dhe Vlerësimi**

UV ka një përmirësim të dukshëm në fushën e burimeve njerëzore, qoftë në ngritjen e strukturave dhe legjislacionit përkatës, qoftë në proçedurat e ndjekura për këtë qëllim. NJSBC është aktive në përmbushjen e misionit të saj. UV ka bërë përpjekje të vazhdueshme për kualifikimin e stafit mësimdhënës, me organizimin e disa aktiviteteve për këtë qëllim. Mbetet ende punë për t'u bërë në këtë drejtim, apo edhe në angazhimin e pedagogëve të huaj në mësimdhënie dhe në juritë e promovimit, pasi kjo rrit performancën dhe përmirëson imazhin dhe besueshmërinë e institucionit në nivel ndërkombëtar.

Menaxhimi financiar bëhet në përputhje me kuadrin dhe proçedurat ligjore të përcaktuara dhe UV ndjek politika financiare transparente të cilat publikohen rregullisht në faqen zyrtare të institucionit. Për të mbështetur dhe lehtësuar funksionimin e proçedurave akademike, administrative dhe dixhitalizimin e të dhënave, UV ka ngritur Sistemin e Menaxhimit të Informacionit mësimor UVMS. Struktura përgjegjëse për menaxhimin e tij është zyra e IT-së e cila menaxhon dhe publikon çdo informacion apo dokumentacion në kuadër të informimit, funksionimit, mbarëvajtjes dhe transparencës së gjithë aktivitetit të institucionit.

Infrastruktura logjistike dhe fizike është në përmirësim të vazhdueshëm për t'u vënë në funksion të mbarëvajtjes së gjithë aktiviteteve të institucionit. Gjatë kësaj periudhe janë ndërmarrë investime të konsiderueshme për rikonstruksionin e godinave ekzistuese, përmirësimin e logjistikës në auditorë dhe zyra, apo ngritjen e laboratorëve. Për të rritur kapacitetet pritëse UV ka parashikuar në buxhetin e vitit 2020 një investim për ngritjen e një godine të re. Bazuar mbi analizat dhe evidencat e raportuara në këtë raport, GVB konkludon se *standartet për fushën Burimet përmbushen* **Kryesisht.**

# 3 FUSHA E VLERËSIMIT: KURRIKULA

| **Programet e Studimeve të ofruara** |
|---|
| **Institucioni ofron programe në përputhje me misionin dhe kushtet e infrastrukturës së tij.** *(Kreu I Standard I.1)* |
| UV, si IAL publike ofron programe studimi, në të tre ciklet e studimit, Bachelor (27), Master Profesional (20), Master i Shkencave (13), Doktorale (1) [E3.1,E.1.78]. Në funksion të rritjes së transparencës me publikun, si dhe të thithjes së opinionit të tij për përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit, UV siguron mundësinë që programet e studimit të ofruara prej tij të njihen nga publiku. Çdo Fakultet dhe Departament në faqen zyrtare të internetit (http://univlora.edu.al/) hedh të dhënat lidhur me programet e studimit që ofron për çdo cikël (programin dhe planin mesimor, sylabuset, etj).(https://univlora.edu.al/programi-mesimor-bachelor-ne-infermieri-mami/) Gjithashtu në stendat e njoftimeve çdo departament afishon planin e studimeve, me të cilin njihen jo vetëm studentët, por edhe publiku i gjerë sa herë është prezent fizikisht në ambjentet e UV-së. Në strategjinë e çdo njësie akademike dhe administrative të UV-së (Rektorat, Fakultet, Departament, Administratë) eshtë mbajtja e kontakteve me shkollat e mesme për informimin e nxënësve me ofertën didaktike të UV-së, me synim thithjen e studentëve cilësorë. Kjo realizohet nëpërmjet ditëve të hapura informative me nxënësit e shkollave të mesme, kontakteve formale apo jo formale të autoriteve drejtuese të UV-së me drejtorët e shkollave të mesme, Drejtoritë Arsimore Rajonale, etj. Këto aktivitete koordinohen me Sektorin e Këshillimit të Karrierës, ALUMNIT dhe aktiviteteve kulturore-sportive (SKKAAK) [E2.12, E3.2].<br>Themelimi i UV-së në vitin 1994 u bazua mbi traditën shumëvjeçare unikale që ekzistonte në rajonin e Vlorës (Shkolla e Lartë e Marinës, Shkolla e mesme Mjeksore, Shkolla Tregtare) [E3.3]. Pikërisht me fushat e turizmit, detarisë, ekonomisë, infermierisë UV krijoi fillimisht profilin e vetë institucional. Gradualisht me konsolidimin e këtyre profileve, për t'iu përgjigjur edhe zhvillimeve dinamike rajonale UV ka konsoliduar profilin e tij edhe në fushat e mësimdhënies, shkencave humane, shkencave kompjuterike, juridike, inxhinierike dhe natyrore [E1.78, E3.1]. UV ofron programe studimi unikale në rang vendi duke qenë i vetmi IAL që ofron programe studimi në fushën e Inxhinierisë Detare (Bsc, Msc. Inxhinieri Navale), që e bën UV-në pikë reference për bashkëpunimet në këtë fushë, jo vetëm me partnerë brenda vendit, por edhe në bashkëpunimet ndërkombëtare. UV dhe Universiteti Politeknik i Tiranës (UPT) janë të vetmet Universitete në vend që ofrojnë programe studimi Inxhinierike (Inxhinieri Navale, Inxhinieri Mekanike, Inxhinieri Elektrike). Oferta e larmishme didaktike i ka mundësuar UV-së identifikimin me një profil të veçantë kundrejt Universiteteve të tjera në vend.<br>UV ndjek një politikë të qartë për pranimin e studentëve në programet e studimit, bazuar në kritere. Statuti i UV-së, përcakton parimet e përgjithshme të pranimit të studentëve në të treja ciklet e studimit (Neni 58 Ciklin I; Neni 60 Ciklin II; Neni 62 Ciklin III) [E1.1]. Në ciklin e parë të studimeve pranimet bëhen mbi bazën e kritereve që propozohen nga njësia bazë dhe miratohen nga SA dhe vendosen në dispozicion të Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSA) [E3.4]. Këto kritere vihen në dispozicion dhe bëhen publike nga UV, të paktën një vit para fillimit të pranimeve të rradhës në Institucion, së bashku me informacionin e nevojshëm mbi fakultetin përkatës dhe programet që ofron. (Neni 58/pika 4), [E3.5, E3.6, E3.7]. Në programet e studimit të ciklit të dytë (MS dhe MP), bazuar në propozimet e njësive bazë dhe kryesore, SA i UV-së miraton kriteret e |

pranimit për çdo program studimi të ofruar [E.3.5, E.3.8]. Në ciklin e tretë të studimeve kriteret propozohen nga njësia bazë dhe miratohen nga SA (Neni 62, pika ç – Statuti UV). Prej disa vitesh akademike nuk ka pranime në ciklin e tretë, për shkak të mos akoordimit të kuotave doktorale nga MASR

Të gjitha programet e studimit që ofrohen nga UV janë të organizuara në mënyrë të kujdesshme, për të harmonizuar të gjithë komponentet e tyre, duke respektuar legjislacionin në fuqi lidhur me organizimin e programeve të studimit (**VKM Nr. 41, datë 24.1.2018**). Kujdes tregohet që veprimtaritë formuese të programit të studimit të organizohen në disiplina të formimit bazë; disiplina karakterizuese të programit; disiplina ndërdisiplinore dhe/ose integruese me një ose më shumë grupe disiplinash (të ngjashme dhe/ose integruese me disiplinat karakterizuese); disiplina plotësuese (të fokusuara në përftimin e aftësive në gjuhë të huaj, aftësive informatike, komunikuese, etj); detyrime përmbyllëse (përgatitja e tezës së diplomës ose provimi përfundimtar, si dhe të respektohet shpërndarja në përqindje e krediteve lëndore për secilin grup të disiplinave të formimit [E3.9(a -f)].Hartimi dhe miratimi i strukturës dhe dosjes së plotë të çdo programi mësimor bëhet nga njësia bazë, në përputhje me aktet nënligjore të MASR, dhe më pas përcillet për miratim prej njësisë kryesore në SA [E3.10a, E3.10b]. Në UV programet e studimit i nënshtrohen vlerësimeve periodike dhe analizave vjetore [E3.11 (a ÷ c), E1.73, E1.74] për të analizuar performancën e këtyre programeve dhe nxjerrjen e përfundimeve përkatëse. Bazuar në këto përfundime, indikacioneve që vijnë nga burime brenda dhe jashtë UV[-së], si dhe ndryshimeve që pësojnë këto programe në universitete të tjera, programet e studimit në UV riorganizohen duke synuar përmirësimin e vazhduar dhe përputhjen e tyre me legjislacionin në fuqi [E3.12a, E3.12b]. Për riorganizime në masën mbi 20 për qind të përmbajtjes së tyre, të shprehur në kredite, pas një cikli të plotë studimi, kërkohet edhe miratimi nga MASR [E3.13].

UV ka vendosur rregulla të qarta për kontrollin e dijes, të sanksionuara në Rregullore, Kreu 7, Neni 61[E1.5]. Kontrolli i dijes realizohet nëpërmjet kontrolleve të pjesshme, mbarëvajtjes semestrale dhe provimit final. Rregullorja dhe statuti përcaktojnë edhe limitet e shtrirjes së peshës së këtyre vlerësimeve në raport me vlerësimin final. Me fillimin e vitit të ri akademik çdo pedagog dorëzon syllabusin e lëndës në departament, i cili verifikohet për sa i përket respektimit të kërkesave për vlerësimin dhe kontrollin e dijes kundrejt kërkesave të parashikuara nga Rregullorja e UV[-së] dhe VKM[-së] **Nr. 41, datë 24.1.2018**. Syllabusi i miratuar [E3.14] u bëhet i ditur studentëve orën e parë të zhvillimit të lëndës.

**Formimi i vazhdueshëm është pjesë integrale e programeve të studimeve.** *(Kreu I Standardi I.2)*

UV ka ofruar programe studimi të formimit të vazhduar, të cilat kryesisht janë ofruar në kuadër të projekteve ndërkombëtare. Prej Dhjetorit 2016 në FSHT, në kuadrin e projektit Tempus MARED, janë ofruar disa kurse të formimit të vazhduar për studentët dhe detarët, për plotësimin e njohurive të studentëve dhe detarëve sipas kërkesave të tregut të punës. Aktualisht në kuadrin e projektit TEAVET, po ofrohen kurse të formimit të vazhduar për mësuesit [E 3.15]. FSHP ofron disa kurse të formimit të vazhduar [E3.16]. Përpjekje po bëhen edhe nga Fakultetet dhe Departamenet e tjera të UV[-së]. Aktualisht UV, nuk ofron studime pa shkëputje nga puna, kjo edhe për shkak të ndyshimeve ligjore të Ligjit për Arsimin e Lartë. Statuti i UV[-së] Neni 55, pika b parashikon edhe studimet me kohë të zgjatur, si formë e studimeve universitare, vetëm për programet e studimit Master Profesional, Master Ekzekutiv dhe programet e studimit me karakter

| |
|---|
| profesional.UV ka ofruar më parë programe studimi me kohë të pjesshme kryesisht në fushat (ekonomi, juridik). Në UV funksionon qendra RDC [E1.82], si një qendër studimore ndërdisiplinore e zhvillimit rajonal (Neni 12 i Statutit UV), e cila ka si synim kryesor zhvillimin e misionit të tretë të Universitetit, përfshirë organizimin, menaxhimin dhe zhvillimin e aktiviteteve të edukimit dhe trajnimit të vazhdueshëm për studentet, alumni, akademikët, profesionistët dhe komunitetin e gjerë. (Neni 12, pika 2, gërma a – Statuti UV-së) [E1.83, E1.84]. |
| **Programet e studimeve ofrohen në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit.** *(Kreu I Standardi I 3)*<br><br>UV ka miratuar strategjinë e vetë të zhvillimit për periudhën 2018-2024 [E1.66,E1.67]. Në këtë dokument përcaktohet qartësisht se përmbushja e rolit dhe misionit të UV-së bazohet në disa shtylla kryesore (mësimdhënia dhe studimi; profili institucional; edukimi i vlerave, kërkimi shkencor; infrastruktura; bashkëpunimi/partneriteti; ndërkombëtarizimi; sigurimi i cilësisë dhe standarteve; përfshirje dhe përgjegjësi sociale). Oferta akademike e UV-së shkon në kah të politikës dhe strategjisë Institucionale të zhvillimit të Universitetit. Programet e studimit në UV, të cilat përbëjnë bazën e misionit të mësimdhënies, i përkasin fushave të ndryshme dhe duhet të sigurojnë dhe përgatisin studentët me njohje dhe kompetenca akademike për një karrierë të qëndrueshme profesionale. Objektivat e këtyre programeve duhet të jenë në të njëjtën linjë me strategjinë e UV-së, në tërësinë e proçesit të mësimdhënies [E3.17, fq 11]. Mbi bazën e këtyre parimeve është mbështetur oferta didaktike e UV-së. Aktualisht njësitë bazë dhe kryesore të UV-së kanë hartuar strategjitë e tyre të zhvillimit [E3.18a, E3.18b, E3.18c, E3.18d, E3.18e].<br>Strategjia e zhvillimit institucional mbështetet në tre linja strategjike zhvillimi; Ndërkombarizim/Globalizim i UV-së; Smart UV dhe Lidership profesional [E3.19]. Skenari i tretë i zhvillimit (Lidership Profesional), parashikon se Universiteti do të synojë të shndërrohet në një institucion lider përsa i takon formimit profesional në përputhje me standardet Europiane ESCO (Standardi Europiani Kualifikimit të Kompetencave/Aftësive profesionale dhe Punësimit) që përcaktojnë qartësisht setin e kompetencave profesionale dhe atyre interpersonale që duhet të fitojnë të diplomuarit. Plotësimi i këtyre standardeve kërkon rishikim të programeve të studimit për t'i përshtatur me kërkesat e tregut të punës në kontekstin Europian, rishikim dhe përmirësim të proçesit të mësimdhënies bazuar në krijimin e kompetencave profesionale përmes përdorimit të metodave interaktive që nxisin kreativitetin dhe të menduarin kritik dhe jo thjesht dhënien e njohurive të bazuara në tekste [E3.19, fq 32,33]. Edhe në strategjitë e njësive kryesore dhe bazë, theksohen kërkesat për aftësimin e studentëve [E3.18a, E3.18b, E3.18c, E3.18d, E3.18e].<br>Oferta akademike e UV-së integron në mënyrë koherente të gjithë informacionin për diplomat e ofruara (përfshirë kurrikulën, planin mësimor, programin, sylabuset) [E3.20](https://univlora.edu.al/programi-mesimor-bachelor-ne-infermieri-mami/). |
| **Programet e studimeve ofrohen në përputhje me objektivat kombëtarë dhe ndërkombëtarë.** *(Kreu I Standardi I.4)*<br><br>UV funksionon vetëm si institucion qëndror dhe nuk ka patur dhe nuk ka filiale të tij në vend. Politika e zhvillimit të UV-së, orientohet qartazi në krah të politikave kombëtare. Në UV programet e studimit ofrohen në përputhje me objektivat kombëtare dhe ndërkombëtare, siç përshkruhet edhe në strategjinë dhe në statutin e tij. Strategjia e zhvillimit të UV-së mbështetet gjerësisht në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI 2015-2020), Strategjinë |

| |
|---|
| Kombëtare për Implementimin e SDG (Sustainable Development Goals) - Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Programi për Zhvillim (UNDP), ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar [E3.19]. Të gjitha programet e studimit synojnë të ruajnë dhe konsolidojnë traditën kombëtare shqiptare. Ato ofrohen në përputhje me kornizën kombëtare dhe europiane të kualifikimeve.<br>Oferta didaktike e UV-së është e larmishme, ku programet e studimit synojnë të jenë programe gjithëpërfshirëse aktivitetesh, ku multidisiplinariteti është tipar i këtyre programeve për zhvillimin e aftësive të studentëve. Multidisiplinariteti konsiderohet si pikë e fortë e ofertës didaktike të UV-së (sidomos programet e ciklit të parë), çka lehtëson transferimin dhe fluiditetin në ndjekjen e programeve të ciklit të dytë dhe të tretë. Gjuha e huaj është një disiplinë e pranishme në të gjitha programet e studimit të ciklit të parë [E3.9 (.a ÷ .f)]. Në ciklin e dytë dhe të tretë studentët e UV-së duhet të japin edhe provimin e gjuhës së huaj sipas testeve të njohura ndërkombëtarisht [E3.21, E3.22]. Strategjia e ndërkombëtarizimit thekson faktin se UV synon të bëhet strehë e vlerave dhe pikë takimeve kulturore, duke forcuar jo vetëm bashkëpunimin ndërkombëtar, por edhe duke u bërë nxitës i tolerancës ndaj respektit dhe njohjes së kulturave të ndryshme [E1.57, fq 3]. UV nuk ka ofruar programe studimi të përbashkëta me IAL të tjera, por ka përpjekje dhe inciativa në kuadrin e projekteve ndërkombëtare, për ofrimin e programeve të përbashkëta. (**https://www.mards.ucg.ac.me/workflow.html**) [E3.23]. UV do të vazhdoj të jetë e interesuar për ofrimin e programeve të studimit të përbashket, me partner ndërkombëtare në kuadrin e financimeve dhe bashkëpunimeve Erasmus (Joint Master degree, Joint Phd). |
| **Programet e studimeve ofrohen në përputhje me kapacitetet e institucionit.** *(Kreu I Standardi I.5)*<br><br>Në të gjitha njësite bazë të UV-së ngarkesa e pedagogëve caktohet në përputhje me aktet nënligjore (**Udhëzim nr. 29, datë 10.9.2018, i ndryshuar**), sipas kategorive të personelit akademik As-Lektor, Lektor, Profesor (Profesor i Asociuar dhe Profesor Doktor [E3.24].<br>Në UV e gjithë ngarkesa mësimore shtesë e pedagogëve financohet nga burimet e brendshme të institucionit, duke respektuar aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi [E3.25]. Programet e studimit dhe planifikimi i kohës vjetore të punës të personelit akademik organizohen në mënyrë që të harmonizojnë mësimdhënien e normuar, kërkimin shkencor dhe mbështetjen institucionale, e cila formalizohet nëpërmjet marrëveshjes që lidhet me fillimin e vitit të ri akademik midis personelit akademik dhe përgjegjësit të departamentit [E3.26]. |
| **Programet e studimeve janë lehtësisht të kuptueshme dhe objektivat e tyre janë të përcaktuar qartë.** *(Kreu I Standardi I.6)*<br><br>Në UV studentët kanë mundësinë që lehtësisht të jenë në dijeni të përmbajtjes së programit të studimit, kurrikulës dhe programit të lëndës, pasi përmbajtja e programit mësimor, plani mësimor dhe sylabuset janë të publikuara në faqen web të çdo departamenti përgjegjës për zbatimin e programit të studimit.(www.univlora.edu.al). Gjithashtu plani mësimor afishohet në stendat përkatëse në ambientet e fakulteteve. Në UV është traditë që lektori i çdo lënde orën e parë të fillimit të lëndës informon studentët lidhur me syllabusin e lëndës (njohuritë dhe aftësitë, përmbajtjen, mënyrën e vlerësimit, etj). Informacioni i përmbajtjes së programit të studimit, mund të sigurohen lehtësisht nga studentët edhe nëpërmjet sekretarisë mësimore dhe këshilltarit akademik të studentëve në Departamente. |

VLORË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"

Programet e studimit kanë objektiva të përcaktuara qartësisht, të cilat përcaktohen në Rregulloret e Programeve të studimit, si dhe në formularët e aplikimit për hapjen e programeve të reja të studimit. [E3.27 (.a – .d) ,E3.10 (.a,.b)]. Këto objektiva përshkruajnë bashkësinë e dijeve, aftësimeve e kompetencave profesionale që studentët duhet të fitojnë në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin kulturor e profesional të programit të studimit. Për të gjitha programet e studimit që ofrohen nga UV përcaktohen qartësisht kriteret e pranimit. Statuti i UV-së, përcakton parimet e përgjithshme të pranimit të studentëve në të tre ciklet e studimit (Neni 58; Neni 60; Neni 62) [E1.1].
Në programet e studimit të ciklit të parë kriteri kryesor është ai i notës mesatare të shkollës së mesme.Kriteret e pranimit në ciklin e parë për çdo program studimi pasqyrohen edhe në portalin u-albania. Në programet e studimit të ciklit të dytë kriteret bazë që aplikohen janë nota mesatare dhe fusha e studimit [E3.5, E3.6, E3.7, E3.8].

**Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen e studentëve me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme.** *(Kreu I Standardi I.7)*

Statuti i UV-së (neni 56, pika a) thekson se studimet në UV organizohen në tre cikle të njëpasnjëshme referuar niveleve 6,7,8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK). Neni 60, pika 1.a (Statuti i UV-së) paraqet qartazi kalimin progresiv nga cikli i parë në ciklin e dytë të studimeve.
Të gjitha programet e ciklit të parë janë të organizuara me 180 kredite [E3.9 (.a ÷ .f)] dhe japin akses në ofertën didaktike të ciklit të dytë të ofruar nga UV dhe IAL të tjera brenda dhe jashtë vendit [E3.28,E3.29]. Diversiviteti i disiplinave të ofruara në programet e studimit të ciklit të parë mundëson një diversivitet të oportuniteteve të studentëve për ndjekjen e studimeve të ciklit të dytë.
Ndarja e disiplinave në të gjitha programet e studimit të ciklit të parë ndjek rigorozisht ndarjen në disiplina të parashikuara nga **VKM Nr.41, datë 24.1.2018,** si disiplina bazë, disiplina karakterizuese, disiplina ndërdisiplinore, disiplina plotësuese dhe detyrime përmbyllëse), duke pajisur studentët me njohuritë bazë, mbi metoda dhe parime shkencore të përgjithshme dhe formimin e shprehive të veçanta. Në **VKM-në Nr.41, datë 24.1.2018** përcaktohen modulet lëndore që përfshihen në secilën prej disiplinave, peshat në % dhe kreditet.
Neni 69 (Statuti UV-së),(https://univlora.edu.al/statuti/) jep informacion orientues për studentët lidhur me mundësitë që kanë për transferimin e programeve të studimeve apo të krediteve të fituara brenda UV-së dhe midis IAL-ve të tjera në vend. Studentët e UV-së informohen edhe nëpërmjet Koordinatorit të studentëve pranë çdo Departamenti lidhur me mundësitë që kanë për transferimet e studimeve brenda dhe jashtë UV-së [E3.30].
Skenari i lidertt professional i përcaktuar në strategjinë e zhvillimit të UV-së thekson se UV synon të jetë një institucion aktiv në implementimin e dijes, gjenerimin e ideve krijuese dhe nxitjen e shkencës në territorin e Shqipërisë. Ky objektiv synohet te arrihet nëpërmjet mësimdhënies bashkëkohore sipas të gjitha standardeve ndërkombëtare, standarteve Europiane ESCO, Deklaratës së Bolonjës dhe Kornizës Shqiptare të Kualifikimit, si dhe zbatimit të programeve të studimit të përshtatshme me kërkesat e tregut të punës në kontekstin Europian.
Praktikë e mirë për këtë është programi i studimit Bsc. Inxhinieri Navale, hartuar duke marrë në konsideratë kurset standarte të "International Maritime Organisation" (IMO), shoqëruar edhe me

guidën e studentit ku evidentohen mundësitë e punësimit, në një treg pune jo vetëm kombëtar por edhe ndërkombëtar [E3.31(.a ; .b)].

**Programet e studimeve të ciklit të parë hartohen në mënyrë të tillë që të lehtësohet ambjentimi i studentit me mjedisin universitar.** *(Kreu I Standardi I.8)*

UV në strukturën organizative ka edhe sektorin e kurrikulave dhe sherbimit ndaj studentëve (SKSHS), si dhe sektorin e SKKAAK [E2.30], sektorë të cilët ndër funksionet e tyre operative kanë edhe ndjekjen e ecurisë së studentëve.
Në UV studentët me rezultate shumë të mira, studentët që studiojnë në fusha prioritare dhe studentët në nevojë përfitojnë bursë sipas legjislacionit në fuqi [VKM 39, 23.01.2019, VKM 40 , 23.01.2019; VKM 780, 26.12.2018] [E3.32]. Për të mbështetur studentët me ecuri të mirë UV u mundëson studentëve mobilite studimore në Universitetet me të cilët UV ka marrëveshje bashkëpunimi (Erasmus, etj) Kriteri i meritës (nota mesatare) aplikohet për përzgjedhjen e studentëve për këto mobilitete [E1.62]. Një tjetër aspekt i mbështetjes së ecurisë së studentëve, janë edhe organizimi i konferencave studentore dhe ngritja e laboratorëve në mbështetje të proçesit mësimor [E2.57, E3.33].
Studentët e viteve të para me fillimin e vitit akademik orientohen nga stafi akademik dhe ndihmës akademik per mbarëvajtjen e jetës së tyre akademike në UV [E3.34].
Rregullorja e UV-së dhe Rregulloret e Programeve të Studimit përmbajnë rregulla të qarta në lidhje me regjistrimet në kurse, kalimin në vitet pasardhëse, të drejtat dhe detyrimet e studentit, etj. Sistemi i Menaxhimit të UV-së, në të cilin studentët kanë akses të plotë, është i konceptuar që të minimizoj gabimet e mundshme të studentëve dhe të lehtësoj proçedurat. Pranë çdo Departamenti ka këshilltar akademik i cili orienton studentët për probleme të ndryshme të ecurisë së tyre akademike [E3.30]. Stafi Akademik në Departamente ka orë konsultimi me studentët. Zyrat e studentit pranë çdo Fakultetit orientojnë studentët për problematika të ndryshme. Guida e studentit, është një tjetër mundësi orientimi për studentët e UV-së [E3.35].
Stafi akademik i UV-së përveç formës tradicionale të mësimdhënies, e cila është mbizotëruese, aplikon edhe forma alternative/interaktive. Kjo realizohet duke shfrytëzuar kapacitetet teknologjike nëpërmjet prezantimeve audiovizive, komunikimeve online, internetit, rrjeteve sociale etj. Gjithashtu ka fakultete (si FSHP/FSHT) që kanë simulatorë në ndihmë të proçesit mësimdhënës [E1.81]
Kriteret e punësimit për personel akademik në UV [E3.36 (.a - ÷ .d ] parashikojnë vlerësimin me pikëzim shumë herë më të lartë të kandidatëve për personel akademik të cilët zotërojnë gradën shkencore "Doktor", ose janë në vazhdim të studimeve doktorale. Gjithashtu, edhe kandidatë të cilët kanë botime në revista shkencore me faktor impakti dhe revistat me bord editorial vlerësohen në pikëzimin e kandidatit. Kjo proçedurë e bën kandidatin me gradën shkencore doktor dhe që angazhohet në veprimtaritë kërkimore shkencore, prioritar ndaj kandidatëve të tjerë.
Personelii akademik i punësuar me kohë të plotë në UV përbën 94% të personelit akademik që angazhohet në mësimdhënie, cikli I (FSHT 93%, FE 96%, FSHH, 91% dhe FSHP 94.5%) [E3.37].

**Programet e studimeve të ciklit të dytë mbështeten mbi kërkimin dhe për realizimin e tyre institucioni bashkëpunon me aktorë të fushës ekonomike.** *(Kreu I Standardi I.9)*

Nr i pedagogëve me gradën shkencore "Doktor" dhe titujt akademik "Profesor" dhe "Profesor i Asociuar" është 176 me grada dhe tituj kundrejt 275 pedagogëve në total. Ky është tregues se pedagogët e angazhuar në veprimtari kërkimore-shkencore përbëjnë mazhorancën e stafit akademik të UV. Mesatarja për fakultet e stafit akademik me tituj dhe grada, për vitin akademik 2017-2018 ishte 63%, kurse për vitin akademik 2018-2019 ishte 64%, me një rritje prej 1% [E1.74 fq115] Evidencat [E1.86,E1.87,E1.88,E1.89] paraqesin një panoramë të numrit të stafit akademik me grada dhe tituj në njësitë bazë dhe kryesore të UV.

Në UV hartimi dhe rishikimi i programeve të ciklit të parë dhe të dytë bazohet mbi grupet e punës, të cilat ngrihen në njësitë bazë, ku synohet që stafi akademik me grada dhe tituj dhe me eksperiencë në fushat përkatëse të jetë pjesë e grupeve të punës [E3.38]. Mazhoranca e stafit akademik me grada dhe tituj shkencore është treguesi më i mirë se ky personel akademik merr pjesë në zbatimin e programeve të studimit. Me vendim të senatit të UV personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie duhet të ketë kualifikim të ciklit pasardhës [E3.39].

Programet "MS" janë në koherencë me Strategjinë e Zhvillimit dhe Ndërkombëtarizimit të UV-së, strategjinë e kërkimit shkencor dhe strategjitë e njësive bazë dhe kryesore [E1.57],[E1.56],[E1.66],[E1.79]. Programet "MS" janë hapur në ato fusha në të cilat ekzistojnë burime të mirë kualifikuara të stafit akademik, si dhe ekzistojnë indikacione për partneritete në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Njësitë baze dhe kryesore të UV kanë marrëveshje bashkëpunimi edhe me sektorin privat dhe kompanitë shtetërore për tu mundësuar studentëve realizimin me sukses të praktikave mësimore dhe punimeve të diplomave [E1.103]; [E1.41]. Sektori SKKAAK i cili ndër funksionet e tij ka atë të krijimit të një rrjeti të studentëve të diplomuar në vite dhe ruajtjen e vazhdueshme të lidhjeve mes tyre dhe UV, ka bazë të dhënash në lidhje me punësimin e studentëve të diplomuar nga UV [E1.98,E 1.96,E1.97]

UV-ja ka në politikën e saj institucionale, bashkëpunimin me aktorë nga fusha e biznesit apo nga fusha të tjera. Përfaqësues nga këto fusha janë të mirëpritur për tu angazhuar në proçesin e mësimdhënies sapo ka një shfaqje interesi nga ana e tyre. Edhe UV me inisiativën e saj fton këto personalitete në auditorët e saj. Angazhimi i këtyre figurave në mësimdhënien në programet e studimeve MP kushtëzohet edhe nga kërkesat ligjore për angazhimin në mësimdhënie në ciklet e dyta të stafit akademik me diploma të ciklit të tretë. Evidenca [E2.3] paraqet një listë të angazhimit të këtyre figurave në mësimdhënie në UV.

Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën në UV 84% të personelit akademik që angazhohet në mësimdhënie, cikli II (FSHT 85%, FE 79%, FSHH, 84%, FSHP 88%) [E3.40].

**Programet e studimeve synojnë të nxisin mobilitetin e studentëve Shqiptarë në Evropë dhe më gjerë.** *(Kreu I Standardi I.10)*

Në UV të gjitha programet e studimit ofrohen në përputhje me proçesin e Bolonjës, në tre cikle studimi, Bachelor, Master, Doktoratë, referuar niveleve 6,7,8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (Statut: UV-së Neni 56).

Në UV programet mësimore organizohen për të dhënë informacione të detajuara. Formati i organizimit të programeve të studimit përmban për çdo modul numrin e krediteve ECTS, ngarkesën në auditor, ngarkesën jashtë auditorit, ngarkesën javore (leksione,seminare,laboratore) [E3.9 (.a ÷.?)]. Programet e studimit përgjithësisht janë në dy gjuhë. Në faqen WEB të UV

pasqyrohet vetëm versioni në gjuhën shqipe. Syllabuset nuk disponohen në të gjitha programet edhe në gjuhën angleze.
Për të gjitha programet e studimit në UV është përgatitur në dy gjuhë suplementi i diplomës [E3.41]. Në përfundim të çdo programi studimi, studentët pajisen me Diplomën dhe listën e notave. Suplementi i diplomës u jepet studentëve përgjithësisht me kërkesën e tyre.
Diversiviteti i disiplinave brenda programeve të studimeve, të ofruara nga UV, dhe konsultimi i programeve të ngjashme të Universiteteve perëndimore dhe programeve të tjera të ngjashme në vend garantojnë një prej parimeve kryesore të proçesit të Bolonjës, mobilitetin e studentëve, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Programet e studimit të ofruara me të njëjtën fushë, cikël, emërtesë, me IAL të tjera, synohet të kenë shkallë përafrimi në masën 70% në formë dhe në përmbajtje(sylabuse), (neni 86, pika2 ligji i arsimit të lartë) [E3.42, E3.43].
Të gjitha programet e studimit në UV kanë module lëndore të gjuhës së huaj [E3.9 (.a ÷.f)]. Në disa programe studimi studentët mund të zgjedhin një prej 5 gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian. Të gjithë studentët e cikleve të dyta dhe të treta japin provimin e gjuhës angleze, sipas testeve të njohura ndërkombëtarisht [E3.21, E3.22].
UV ka angazhim maksimal për të respektuar detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet me IAL-të e huaja për mobilitete studentësh në kuadër të programeve ndërkombëtare [E3.44]. Statuti i UV-së, neni 69, paraqet mundësinë që u ofrohen studentëve për transferimin e studimeve, njohjen dhe njehsimin e periudhave të studimit. Shembuj të proçedurës për transferimin dhe ekuivalentimin e periudhës së studimeve të studentëve paraqiten në [E3.45 (.a ÷ .d)]

**Programet e studimeve mundësojnë aplikimin në praktikë të njohurive dhe aftësive të fituara nga studentët në kurset teorike.** *(Kreu I Standardi I.11)*

Të gjitha programet e studimit kanë të planifikuar zhvillimin e orëve të seminareve, ushtrimeve, laboratorëve, ku studentët mundësojnë aplikimin në praktikë të aftësive të fituara në orët e leksioneve [E3.9 (.a ÷.f)]. Në shumicën e programeve të ciklit të parë dhe të dytë janë të parashikuara module lëndore për zhvillimin e praktikave mësimore. Evidenca [E1.103] paraqet listën e marrëveshjeve për zhvillimin e praktikave.
Në UV Sistemi Europian i Krediteve aplikohet prej një periudhe të gjatë. Tashmë mund të thuhet se sistemi paraqitet efektiv, duke lehtësuar mobilitetet e studentëve, njohjen dhe transferimin e studimeve të plota apo të pjesshme [E3.44, E3.45 (.a ÷ .d)]. Sistemi është efektiv pasi ndërgjegjëson studentët në lidhje edhe me ngarkesën jashtë auditorit dhe punën e pavarur të tyre.
Të gjitha programet e studimit në UV përfundojnë me detyrimin përmbyllës [E3.9 (.a ÷.f)]. Prej vitit akademik 2016-2017 me vendim të senatit të UV-së [E3.46] është vendosur kriteri i notës mesatare për përgatitjen e tezave të diplomave në përfundim të programeve Bsc dhe MP. UV angazhohet për aktivitete kulturore dhe edukative me studentët. Institucioni është i angazhuar për gjallërimin e jetës studentore [E3.47].

**Programet e studimeve synojnë përgatitjen e studentëve për punësim.** *(Kreu I Standardi I.12)*

**VKM Nr. 41, datë 24.1.2018,** referuar të cilës janë riorganizuar programet e studimit në UV, detyron njësitë bazë dhe kryesore të përfshijnë në programet e studimeve disiplina karakterizuese(me karakter të mirëfilltë profesional) në rreth 90 – 99 kredite (50-55%) dhe

disiplina integruese me disiplinat karakterizuese (21 - 27 kredite 12-15 %), lëndë plotësuese (18 – 27 kredite 10-15%) ku mund të përfshihen module lëndore të kulturave juridike, ekonomike. Shumica e programeve të studimit (cikli I+II), nëUV, të riorganizuara sipas **VKM Nr. 41, datë 24.1.2018,** përfshijnë praktikat mësimore si pjesë integrale e tyre [E3.9 (.a ÷.f)]. Në UV të gjitha programet e studimit në shkencat mjekësore, teknike, natyrore përfshijnë laboratore, detyrat laboratorike [E3.48].

**Përfundimet dhe Vlerësimi**

Në UV programet e studimit organizohen për të përmbushur standartet kombëtare të cilësisë, duke respektuar në formë dhe përmbajtje kërkesat që burojnë nga aktet ligore dhe nënligjore. Ato janë në përputhje me objektivat e zhvillimit institucional. Përmbajtja e programeve të studimit të ofruara nga UV synon të përmbush skenarin e lidershipit profesional të parashikuar në planin strategjik të zhvillimit institucional. Programet e studimit hartohen që të lehtësohet mobiliteti i studentëve brenda dhe jashtë vendit. Gjatë hartimit të këtyre programeve merren në konsideratë nevojat dhe kërkesat e lidhura me tregun e punës, informacionet e marra nga burime të ndryshme jashtë Universitetit, përvojat e Universiteteve të huaja, burimet në dispozicion si dhe objektivat strategjike të zhvillimit institucional. Programet e studimit kanë objektiva të qarta formimi dhe aftësimit të studentëve. Rregullat e ecurisë së përparimit në programet e studimit parashikohen në formularët e aplikimit për hapjen e programeve të reja, në rregulloret e programeve të studimit dhe në rregulloren e UV-së. Në UV programet e studimit analizohen për të vlerësuar përfomancën tyre dhe nxjerrjen e përfundimeve përkatëse. Bazuar në këto përfundime, indikacioneve që vijnë nga burime brenda dhe jashtë UV-së, si dhe ndryshimeve që pësojnë këto programe në universitete të tjera brenda dhe jashtë vendit, programet e studimit në UV i nënshtrohen përmirësimit të vazhduar. Personeli akademik i UVsë është garancia për sigurimin e cilësisë akademike në këto programeve studimi.

Bazuar mbi analizat dhe evidencat e raportuara në këtë raport, Grupi i Vetëvlerësimit konkludon se në UV *standartet për fushën e Kurrikulave plotësohen* **PLOTËSISHT.**

# 4 FUSHA E VLERËSIMIT: MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KËRKIMI

| **Organizimi i Programeve të Studimeve** |
|---|
| **Programet e studimeve të shpallura zbatohen në kushte të përshtatshme.** *(Kreu I Standardi II.1)* |
| UV siguron organizimin dhe dokumentimin efikas të planit mësimor të programeve të studimeve. Mënyra e organizimit të studimeve të ofruara nga UV dhe dokumentimi mësimor në formë të shkruar janë të përcaktuara qartë në statutin (Neni 78) dhe rregullore të UV [E1.1, E1.5, E1.6, E1.7]. Ndërkohë rregulloret e njësive bazë të UV [E1.11, E1.12, E 1.13] sigurojnë zbatimin në kushte të përshtatshme të programeve të studimit që ofrojnë në përputhje me standartet kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë. Dokumentimi efikas i çdo programi studimi sigurohet nëpërmjet dosjes së programit të studimit që përmban të gjithë informacionin e nevojshëm (informacion për institucionin, programin e studimit, strukturat akademike përgjegjëse dhe të tjera bashkëpunuese, kuadrin e përgjithshëm formues të programit të studimit, personelin akademik për realizimin e programit, planin mësimor, infrastrukturën në dispozicion të programit, kriteret e pranimit, planin mësimor, syllabuset e moduleve, rregulloren e programit të studimeve dhe suplementin e diplomës) [E3.9d]. Zbatimi korrekt sigurohet edhe nëpërmjet shpalljes së orarit të përgjithshëm që bëhet çdo fillim semestri ku janë përcaktuar qartë format e mësimdhënies, dita, ora edhe salla ku do zhvillohet si dhe pedagogu përkatës [E4.1]. Orari publikohet në faqen web të UV [E4.1a] dhe afishohet në mjediset e UV.<br><br>Regjistrimi i studentëve në modulet mësimore realizohet nëpërmjet sistemit elektronik UVMS ku çdo student dhe staf akademik i UV disponon llogarinë e tij personale dhe manualin e plotë sesi mund të aksesojnë apo të përdorin modulet të sistemit [E2.55].<br>Dokumentimi efikas i programeve të studimit në UV është parashikuar në statut (Neni 78) ndërkohë që për dokumentimin dhe ruajtjen e proçesit mësimor është miratuar dhe një rregullore e posatcme nga senati akademik [E2.48]. Sipas kësaj rregulloreje Sekretaritë mësimore të Departamentit kryejnë funksionet e sekretari- arkivit dhe administrimit të dokumentacionit të proçesit mësimor ku përfshihen: Regjistri themeltar i studenteve; Regjistri i Arritjeve Akademike; Plani mësimor; Kurrikula; Struktura e vitit akademik dhe oraret e provimeve; Procesverbale të mbledhjeve, vendimet, udhëzimet e të komisioneve të krijuara në bazë departamenti; dokumentacionin elektronik dhe çdo dokumentacion tjeter të nevojshëm për mbarëvajtjen e proçesit mësimor<br>Institucioni bashkërendon punën e personelit akademik për të siguruar koherencë të përmbajtjes duke përputhur kualifikimin e stafit akademik me specifikat e kursit. Për realizimin e programit në dosjen e çdo programi studimi është përcaktuar dhe personeli akademik sipas fushës së specialitetit [E3.9d]. UV garanton kapacitete të mjaftueshme për realizimin e formimit praktik e profesional të studentëve. Formimi praktik e profesional i studentëve realizohet nëpërmjet punëve laboratorike që mundësohen në laboratorët e njësive bazë. UV ka në total 25 laboratore [E2.56, E2.57] ndërkohë që praktikat mësimore mundësohen sipas specifikave dhe në terren në sajë të marrëveshjeve të bashkëpunimit që UV ka me institucione të ndryshme [E1.103, E1.125]. Praktikat mësimore mbikëqyren nga pedagogu përkatës që mund të jetë staf i brendshëm apo i jashtëm i UV [E4.2]. Studentëve si të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve që përmbushin kriterin e pragut të notës |

mesatare që u jep të drejtën që të diplomohen duke përgatitur dhe mbrojtur një temë diplome [E3.46] u caktohet udhëheqësi shkencor i cili udhëheq dhe mbikëqyr punën kërkimore të studentit [E4.3]. Programi i doktoraturës në UV ka rregulloren e saj ku janë të përcaktuara qartë rregullat dhe kriteret e diplomimit [E1.29]. Literatura e nevojshme bazë dhe mbështetëse për programin e studimeve u vihet në dispozicion studentëve për çdo modul mësimor jo vetëm nëpërmjet pasqyrimit të saj në syllabusin e lëndës [E3.14], dhënies së informacionit që në orën e parë të leksionit por edhe nëpërmjet bibliotekës së UV [E4.4]. Çdo fillim viti akademik në çdo departament miratohet literatura bazë që do të përdoret për programin e studimit [E4.5] ndërkohë që UV me vendim SA [E2.66] ka përcaktuar qartë standartet dhe kriteret që duhet të përmbushi literatura që stafi akademik sjell për tu shqyrtuar dhe miratuar në departament [E4.6] dhe që mund të përdoret si literaturë bazë. Literatura e nevojshme mbështetëse u sigurohet dhe nga pasurimi i vazhdueshëm me literaturë ku sipas kërkesave të fakulteteve mundësohet blerja e tyre nga fondet e UV por edhe nga donacione të ndryshme [E4.7, E4.7a]. Tashmë nëpërmjet platëformës digjitale U L I B R A R Y https://ulibrary.rash.al/ ku të gjithë studentët e UV kanë akses, mund të gjejnë edhe literaturën mbështetëse ndihmëse për programin mësimor dhe jo vetëm.

**Institucionet e Arsimit të Lartë pajisin studentët që kanë shlyer të gjitha detyrimet e një programi studimi, me diplomën përkatëse, e cila është dokument zyrtar.** *(Kreu I Standardi II.2)*

Rregullat dhe kërkesat për diplomim janë të përcaktuara qartë në rregulloren e UV [E1.5, E1.6, E1.7] në rregulloret e njësive bazë [E1.14, E1.15, E1.16, E1.17], të programeve të studimit dhe në rregulloret e provimeve që janë të shpallura publikisht dhe u bëhen të njohura studentëve që në orën e parët e para mësimore të çdo moduli [E3.27, E4.8]. Gjithashtu studentët njihen dhe me proçedurën dhe mënyrën e vlerësimit si dhe kur mund të pajisen me diplomën përkatëse. Rregulla apo specifika të provimeve si dhe proçedurat dhe format e vlerësimit përcaktohen dhe në syllabusin e lëndës nga pedagogu përkatës [E3.14]. Ndërkohë që, kriteret dhe proçedurat e diplomimit bëhen të njohura publikisht, qoftë nëpërmjet afishimit në këndet e informacionit në fakultete por edhe nëpërmjet faqes Web të UV. Kriteret për çdo program studimi mund të shikohen dhe nëpërmjet portalit U-Albania, Universitet [https://ualbania.al/Universitet/Info/7?fakultetID=61&degaID=253]. Vlerësimi i njohurive në UV kryhet nëpërmjet provimeve të lëndëve dhe vlerësimit të vazhduar që ku bëjnë pjesë vlerësimet e punëve praktike, laboratorike dhe seminareve. Provimet semestrale organizohen në dy pjesë, në provimet e pjesshme dhe provimin final. Anonimati në provimet semestrale nuk respektohet në asnjë fakultet të UV përveç provimit të diplomimit në FSHP (për ciklin e parë të studimeve dhe për ciklin e dytë - master profesional) [E4.8a]. Pavarësisht nga mungesa e anonimatit në provime, rezultatet e provimeve duhet të përpunohen jo më shumë nga 48 orë nga kryerja e tij ku dhe u bëhen të njohura studentëve. Studentët mund të konsultojnë tezën në prani të pedagogut dhe nëse nuk pajtohen me vlerësimin kanë të drejtën e ankimimit duke drejtuar një kërkesë me shkrim drejtuesit të departamentit të programit përkatës. E drejta e ankimimit për rezultatin e provimeve është qartë e përcaktuar edhe në rregulloren e provimeve [E1.7, E1.15]. Bazuar në rregulloren e provimeve në rast ankimimi brenda 48 orëve krijohen grupet ad-hoc në nivel departamenti që shqyrtojnë ankesën [E4.8b]. Përmes sistemit elektronik UVMS studentët kanë akses në rezultatet e provimeve. Parimi i konfidencialitetit sigurohet nëpërmjet llogarisë personale në sistem ku çdo student ka username dhe password personal [https://uvms.univlora.edu.al/user/login]. Në rastet kur aksesi në sistem për arsye teknike nuk është i disponueshëm brenda 48 orëve nga kryerja e

provimit, studenti mund ta marri vlerësimin nga lektori i lëndës, gjithmonë duke respektuar parimin e konfidencialitetit.

**Programet e studimeve janë objekt i përmirësimit të vazhdueshëm të tyre në funksion të rritjes së cilësisë.** *(Kreu I Standardi II.3)*

Në strukturën e re organizative të miratuar UV [E1.22] ka në përbërje Drejtorinë e Sigurimit të Cilësisë dhe Zhvillimit institucional e cila ka në organikë Njësinë e sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional (NJSBC) përgjegjëse për sigurimin dhe rritjen e vazhdueshme të cilësisë për programet e studimit që UV ofron. Kjo njësi vlerëson rregullisht pedagogët për zbatimin cilësor të programeve të studimit që UV ofron nëpërmjet pyetësorit studentor në zbatim të nenit 103 të LAL80/15. Ky pyetësor organizohet çdo fund semestri apo para sezonit të provimeve. Të dhënat e mbledhura nga pyetësori përmblidhen në një raport i cili ka për qëllim jo vetëm vlerësimin e cilësisë së programeve mësimore por edhe përmirësim të vazhdueshëm të tyre nëpërmjet identifikimit të pikave të forta dhe të dobta [E4.9]. Në UV studentët përfshihen nëpërmjet një proçedure të miratuar nga SA, [E4.10] në vlerësimin e pedagogëve dhe në atë të zbatimit të programeve të studimit nëpërmjet plotësimit të pyetësorit për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi të UV. Formulari i pyetësorëve të studentëve i miratuar në senatin akademik [E2.49a] hidhet në sistem në Sektorin e anketimeve. Ndërkohë që pyetësori është subjekt i ndryshimeve dhe përmirësimeve të vazhdueshme në funksion të përmbushjes së kërkesave të kohës dhe të studentëve [E4.11]. NJSBC pas analizimit të pyetësorëve harton raportin e detajuar të rezultateve [E4.9] që ia përcjell Rektorit për shqyrtim dhe miratim [E4.12] bashkë me projekt – propozimet për rritjen e cilësisë së programeve të studimit. Ndërkohë që Rektori e dërgon te drejtuesitë e njësive kryesore për diskutim dhe propozime të mëtejshme në nivel njësie bazë. Në mbledhje departamenti të njësive kryesore diskutohen rezultatet, evidentohen praktikat e mira dhe dobësitë dhe dalet me një material përfundimtar dhe projekt propozime që i përcillen rektoratit për shqyrtim dhe propozime përfundimtare në formën e planit të masave që duhet të merren për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në programet e studimit dhe mësimdhënies [E4.12a]. Ky plan masash miratohet në SA [E1.25]. Në UV rezultatet e provimeve dhe konkurseve duke ruajtur anonimatin dhe respektuar konfidencialitetin publikohen online dhe afishohen në mjediset e institucionit. Me vendim të SA renditja e kandidatëve kryhet nga njësitë bazë të universitetit me asistencën e sektorit të shërbimeve teknologjike dhe zhvillimit në UV [E4.13]. Cilësia e programeve të studimit vlerësohet jo vetëm duke marrë për bazë rezultatet e vlerësimit të tyre nga personeli akademik dhe studentët nëpërmjet pyetësorit të organizuar nga NJSBC [E3.12] por edhe nga statistikat e punësimit të të diplomuarve në programet e studimit. Nëse i referohemi FSHP, sipas informacioneve zyrtare të marra nga UISH (shkresa nr 41/1 datë 14.02.2017) numri i infermierëve që parashikohen të punësohen në qarkun e Vlorës në shërbimin parësor dhe dytësor gjatë periudhës 2017-2022 është 196 [E1.93]. Në përputhje me tregun e punës merren parasysh dhe kërkesat e studentëve për përmirësim dhe përshtatje të kurrikulave mësimore [E1.94, E1.95]. Në funksion të rritjes së cilësisë së programeve shërben dhe baza e të dhënave të të diplomuarve të UV që mundësohet nga Sektori i Këshillimit të Karrierës, ALUMNI nëpërmjet monitorimit dhe gjurmimit të ish studentëve të UV [E1.98].

**Institucioni ndjek një politikë të qartë për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.** *(Kreu I Standardi II.4)*

Institucioni ka struktura ndihmëse të cilat promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies. Përveç NjSBC dhe vlerësimit periodik të institucionit për standartet e cilësisë [E4.14] në UV funksionon dhe Qendra e Zhvillimit Rajonal [E1.82] në të cilën është integruar dhe qëndra e formimit profesional. Kjo qendër referuar rregullores se saj ka si objektiv mbështetjen e edukimit dhe trajnimit të vazhdueshëm të stafit akademik, studentëve dhe komunitetit [E1.83]. Ndërkohë që, me vendim SA në përmbushje dhe të rekomandimeve të RVJ të UV-së, Mars 2017 është miratuar dhe udhëzuesi mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme të mësimdhënies për të gjitha fushat e studimit në UV [E3.17]. Ky udhëzues i përgatitur në nivel institucional përmban rekomandime për përmirësimin, zhvillimin dhe implementimin e metodave të reja duke respektuar ligjin e Arsimit të lartë, rregulloren, statutin e UV-së dhe lirinë akademike. Ky Udhëzues u është përcjell dhe njësive bazë të cilët pasi e kanë konsultuar dhe diskutuar në mbledhje kanë dalë me plan masash në zbatim të këtij udhëzuesi dhe gjithmonë duke respektuar dhe lirinë akademike të stafit [E4.15].

Eksperimentimi në mësimdhënie dhe edukimi në vazhdim është pjesë e strategjive afatmesme të fakulteteve [E1.68]. Ndërkohë që përdorimi i metodave inovative të mësimdhënies synon përmirësimin e cilësisë së proçesit mësimor. Shembull i praktikës së mirë është qendra simulatore e FSHP për trajnimin e studentëve infermierë dhe mami [E1.81]. Shembuj të tjerë janë Klinika e Ligjit, te Departamenti i Drejtësisë FSHH [E2.26] si dhe grupi pilot i programit të studimit Bachelor Infermieri e Përgjithshme, FSHP ku moduli Bazat e Infermieristikës ofrohet në gjuhën angleze [E4.16] Organizimi i aktiviteteve të edukimit në vazhdim ku stafi i UV është lektor /trajner ofron jo vetëm shërbim ndaj të tretëve po në të njëjtën kohë kualifikon dhe veten. Shembuj të praktikës së mirë janë seminaret TEAVET të ofruara nga Qendra e Zhvillimit Rajonal të cilat trajnojnë mësuesit e arsimit parauniversitar si dhe seminaret e edukimit në vazhdim që ofrohen nga FSHP për profesionistët e shëndetit të akredituara nga Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim për Profesionistët e Shëndetit [E3.15, E3.16]. Për periudhën 2017-2020, FSHP ka organizuar 10 seminare të akredituara të edukimit në vazhdim ku janë angazhuar 25 lektorë të FSHP dhe kanë përfituar në total 516 profesionistë shëndeti (mjekë, infermierë, mami, teknikë laboratori, farmacistë, etj) [E3.16]. UV kualifikon personelin akademik në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Kjo reflektohet te ofrimi i programeve të ciklit të tretë të studimeve por edhe në lehtësirat që UV i krijon stafit për rimbursim të veprimtarive kërkimore shkencore të personave në proçes doktorature apo për tituj të tjerë [E1.32, E2.20] Përveç kësaj politika e UV për rekrutim të stafit akademik [E2.5, E3.39] ku u jepet përparësi personave që kanë njohuri dhe eksperiencë në metodat bashkëkohore të mësimdhënies ose që kanë eksperienca të mëparshme në mësimdhënie synojnë përmirësimin e vazhdueshëm të saj [E4.17]. Gjithashtu, trajnimi i vazhdueshëm i personelit akademik për përmirësimin e mësimdhënies është pjesë e politikave institucionale. Në përmbushje të rekomandimeve të RVJ, Mars 2017,Vendim Nr.246, datë 28.09.2017 dhe protokollit të UV datë 29.09.2017 me Nr 1020/3 si dhe planit të veprimit të UV bazuar në Rekomandimet e Bordit të Akreditimit të miratuar nga SA me Nr,prot 72214 datë 06.06.2018, për zbatimin e një sistemi efektiv për të zhvilluar të gjithë stafin akademik mësimdhënës, UV ka miratuar me vendim të SA strategjinë e integrimit dhe trajnimit të stafit të ri të rekrutuar nga UV [E1.33]. Në mbështetje të trajnimit të personelit akademik në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies është dhe miratimi i strategjisë për trajnimin e vazhdueshëm të kërkuesve të rinj në UV [E4.18]. Përveç kësaj, marrëveshjet e mobilitetit që UV ka me universitetet e huaja veçanërisht në kuadër të programeve

| |
|---|
| ERASMUS – KA1 mundëson jo vetëm në shkëmbimin e praktikave më të mira të mësimdhënies por edhe trajnimin e vazhdueshëm të stafit akademik. Vetëm për vitin akademik 2018-2019, kanë përfituar 27 personel mësimdhënës nga UV dhe 19 personel për trajnim [E4.19]. Miratimi i rregullores për implementimin e marrëveshjeve ndërinstitucionale në kuadër të programeve Erasmus+ KA107 ICM në UV [E1.60, E1.61] dhe kriteret e politikave për aplikim në mobilitete mundësojnë që i gjithë stafi akademik të këtë mundësi pjesëmarrje [E1.109]. Përveç kësaj UV mundëson dhe zhvillimin e seminareve trajnuese për rritje kapacitetesh të stafit akademik si në mësimdhënie dhe në kërkim shkencor [E4.19, E4.20]. UV është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe këtë e garanton nëpërmjet strukturave përkatëse. NjSBC është një nga struktura përgjegjëse të cilësisë e cila në rregulloren e saj ka përcaktuar qartë rregullat për ruajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në UV [E1.48]. Kjo njësi verifikon, vlerëson dhe krahason standartet në realizimin dhe organizimin e programeve të studimit. Gjithashtu, aplikimi për akreditimin periodik si institucional dhe për programet e studimit janë pasqyrim i përgjegjësisë së UV për ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies [E4.14, E4.21]. Realizimi i programeve të studimit bëhet i mundur nëpërmjet infrastrukturës së nevojshme për programet e studimit që UV disponon vetë (Godina A, B, C, D ku përfshihen salla leksionesh, laboratore, biblioteka etj) [E2.57] por edhe nëpërmjet bashkëpunimit me institucione të tjera si bankat, institucionet shëndetësore ku studentët e programeve të ndryshme të studimit kryejnë praktikat mësimore [E1.105]. Për përmirësimin e mësimdhënies dhe zbatimin e programeve të studimeve nuk angazhohet vetëm stafi akademik por edhe stafi ndihmës mësimor-shkencor dhe personeli administrativ. Karakteri i profilit të personelit ndihmësakademik është i përcaktuar në statutin e UV, neni 49. Personeli me karakter administrativ ndihmësakademik funksionon në nivel institucioni, në nivel njësie kryesore (sekretaritë mësimore të njësive kryesore, asistent i dekanit dhe në nivel njësie bazë (sekretaritë në Departamentin e Drejtësisë dhe të Gjuhëve të Huaja). Kurse, personeli ndihmësakademik me karakter mësimor funksionon në nivel njësie kryesore dhe bazë (laborantët dhe specialistët e QKSH) [E1.1]. Strukturat ndihmës akademike me karakter administrativ në nivel institucioni të UV janë miratur me vendim SA [E1.22]. Në organikën e vetë çdo njësi kryesore ka staf ndihmës mësimor - shkencor dhe personel administrativ (kryesekretare, sekretare dekani, sekretare mësimore të departamenteve) [E4.22]. Sekretaritë mësimore të departamenteve janë përgjegjëse për administrimin e dokumentacionit të proçesit mësimor. Personeli ndihmësakademik me karakter akademik dhe administrativ vlerësohet për cilësinë e punës [E4.23]. Pyetësori i vlerësimit është miratuar në SA [E4.24]. Për vitin akademik 2019-2020 UV ka të punësuar 35 personel administrativ dhe 74 personel ndihmës akademik [E4.25]. |
| **Kërkimi: Rezultatet e kërkimit, përhapja, vlerësimi dhe transferimi i tyre.** |
| **Departamenti, si njësi bazë e institucionit, evidenton anët e tij të forta dhe dobësitë në fushën e kërkimit shkencor.** *(Kreu II Standardi I.1)* |
| UV në strukturë ka 16 departamente [E1.1]. Departamenti është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe punës kërkimore shkencore dhe e bazon veprimtarinë e tij në rregulloren e brendshme të miratuar nga SA [E1.14, E1.15, E1.16, E1.17]. Departamenti përcakton dhe fushat e tij të kërkimit që synojnë zhvillimin dhe pjesëmarrjen në kërkime shkencore dhe projekte Evropiane. Fushat e kërkimit pasqyrohen në planin strategjik të zhvillimit të departamentit [E1.80] dhe në strategjinë 5 vjeçare (2017-2020) të kërkimit shkencor të UV [E1.79]. Departamenti organizohet në grupe mësimore e kërkimore. Grupet mësimore e kërkimore janë ministruktura të |

departamentit që zhvillojnë veprimtari në funksion dhe në përputhje me misionin e departamentit [E4.26]. Me vendim të SA, në përputhje me ligjin Nr.80/2015 për arsimin e lartë është kryer dhe riorganizimi i grupeve mësimore dhe kërkimore të njësive bazë të UV [E4.27]. Grupet mund të jenë dhe vetëm kërkimore si grupet e kërkimit në departamentin e gjuhëve të huaja dhe të edukimit [E4.28, E4.29]. Departamenti nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor duke respektuar lirinë akademike dhe të drejten e personelit akademik për të shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare në dispozicion të realizimit të programit të studimit. Çdo anëtarë i stafit akademik plotëson marrëveshjen për organizimin e punës vjetore të punës për personelin akademik në IAL publike. Kjo marrëveshje nënshkruhet nga anëtari i stafit akademik dhe nga drejtuesi i departamentit. Në këtë marrëveshje përveç mësimdhenies së normuar vjetore vlerësohet edhe veprimtaria kërkimore shkencore dhe për zhvillim e transferim teknologjie apo krijuese [E3.26].

Departamenti përgjigjet për ecurinë e punës kërkimore shkencore të grupeve kërkimore. Në analizën vjetore të departamentit [E3.42] vlerësohet dhe ecuria e punës kërkimore shkencore të stafit. Në të njëjtën kohë kërkimi shkencor është pjesë e vlerësimit të performancës së stafit akademik nga drejtuesi i departamentit [E4.30]. Në fillim të vitit akademik në departamente hartohet plani kërkimor shkencor ku përcaktohen dhe prioritetet e kërkimit si dhe buxheti përkatës [E4.31]. Anëtarët e stafit akademik pjesë të grupeve kërkimore i shpërndajnë rezultatet e kërkimeve të propozuara dhe të realizuara në formën e artikujve të botuar në revista kombëtare apo ndërkombëtare si dhe në formën e prezantimeve në aktivitete shkencore brenda dhe jashtë vendit [E2.20].

Çdo grup mësimor apo grup i përhershëm/i përkohshëm me karakter kërkimor shkencor ka përgjegjësin e tij të zgjedhur (nga kategoria e personelit akademik "Profesor" dhe "Doktor"), sipas kritereve dhe proçedurave të propozuara nga vetë departamentet dhe fakultetet respektive, të pasqyruara në Statutin dhe Rregulloren UV- së. Përgjegjësi i grupit mësimor apo i grupit të përhershëm/ të përkohshëm me karakter kërkimor-shkencor trajtohet me pagë shtesë, në bazë të VKM nr. 507, datë, 01. 08. 2012 [E4.31a]. Mbështetja financiare e grupeve kërkimore nga UV reflektohet në shumë drejtime. Në bashkëfinancimin e projekteve ku grupet kërkimore janë partnere në projekte të ndryshme ndërkombëtare [E1.59]. Në miratimin e një granti shtesë për veprimtarinë kërkimore shkencore rrjedhojë e planit të veprimit për kërkimin shkencor në kuadër të rekomandimeve nga bordi i akreditimit shtojca 71, datë 21.09.2018 [E1.24]. Dhe në planifikimet buxhetore të UV ku pasqyrohet mbështetja financiare dhe transparente e institucionit për veprimtarinë kërkimore shkencore në nivel njësie kryesore dhe bazë [E2.34, E4.32]. Departamenti bazuar në rezultatet e punës sugjeron vazhdimësinë ose ndërprerjen e bashkëpunimit me grupet kërkimore shkencore. Në UV, si pasojë e riorganizimit rishtazi të këtyre grupeve për plotësim të numrit minimal prej 5 pedagogësh me kohë të plotë [E4.27] ende nuk ka vlerësim të produktit të punës së tyre kërkimore.

**Institucioni inkurajon zhvillimin, dinamizmin dhe kërkimin shkencor.** *(Kreu II Standardi I.2)*

UV mbështet grupet dhe projektet kërkimore shkencore të reja. Përvec miratimit të strategjisë së trajnimit të kerkuesve të rinj në UV [E4.18], NJSBC dhe Sektori i Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë siguron trajnime për kërkuesit e rinj në shkrimin e projekt propozimeve kërkimore [E4.19, E4.20]. Gjithashtu, kjo zyrë ofron asistencë dhe konsulencë për pjesëmarrje dhe aplikime

të stafit akademik në projekte të ndryshme kërkimore. Çdo vit (2017-2020) numri i aplikimeve të UV që kanë nevojë për bashkëfinancim në projekte Evropiane është në rritje. Në vitin 2020 UV ka aplikuar në 22 projekte ERASMUS+, në 2019 në 33 projekte dhe në vitin 2018 në 21 projekte. Aktualisht UV është duke implementuar 11 projekte me financim nga programet evropiane e më gjerë; (5) projekte ERASMUS+, dy (2) INTERREG IPA Cross Border Albania-Greece, një (1) INTERREG Adriatiko-Jonian, një (1) EASME, një (1) projekt të financuar nga Ministria e Jashtme e Norvegjisë dhe një (1) projekt i financuar nga Global Bridges [E1.57]. Inkurajimi i zhvillimit dhe dinamizmit për kërkimin shkencor në UV sigurohet nëpërmjet bashkëpunimit me struktura të tjera kërkimore brenda dhe jashtë vendit. Miratimi i Strategjisë së Ndërkombëtarizimit të UV 2016-2020 [E1.57] synon nxitjen e bashkëpunimit për kërkimin shkencor për shkëmbim dhe përfitim të praktikave më të mira. Gjithashtu, në funksion të zhvillimit të kërkimit shkencor UV ndërvepron me struktura dhe institucione të ndryshme. Për periudhën kohore 2017-2020, UV ka nënshkruar 40 marrëveshje me institucione jashtë Shqipërisë [E1.60]. Shembuj të bashkëpunimeve në nivel kombëtar janë bashkëpunimi me Certipass digital skills për platformën Europiane EiPASS, bashkëpunimi me Qendrën për Nismën Ligjore Qytetare si dhe marrëveshja me Drejtorinë e Përgjithshme e Pronave Intelektuale (DPPI) [E1.101, E1.102]. UV për kërkimin shkencor bashkëpunon me IAL të tjera kombëtare [E1.103] si në pjesëmarrje në projekte Evropiane [E1.59] por edhe në organizimin e aktiviteteve të përbashkëta kërkimore. Sektori i Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë nëpërmjet shpërndarjes së thirrjeve të ndryshme për pjesëmarrje në projekte shërben si urë lidhëse midis Agjensisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit dhe Stafit akademik të UV [E4.33].

**Institucioni përqendrohet në ndërkombëtarizimin e kërkimit** *(Kreu II Standardi I.3)*

UV angazhohet për mbledhjen dhe shpërndarjen e informacionit në laboratorët e tij. UV mbështet pjesëmarrjen e stafit akademik dhe kërkuesve shkencor në konferenca/symposium/workshop-e/trajnime si dhe publikime në revista me faktor impakti. Ndërkombëtarizimi i kërkimit në UV gjen mbështetje dhe në financimin e stafit akademik për pjesëmarrje në aktivitete shkencore ndërkombëtare [E2.20, E4.34, E4.34a]. Në 2019 Qendra Kërkimore Shkencore e FSHP organizoi konferencën risi që synonte përhapjen e rezultateve të kërkimeve shkencore të kryera nga stafi i qendrës [E4.35].

UV angazhohet për t'iu përgjigjur ofertave evropiane në fushën e kërkimit shkencor. Shembuj të këtij angazhimi janë implementime të projekteve të ERASMUS+ të bashkëfinancuara nga bashkimi Evropian si Përmirësimi i potencialit kërkimor të Arsimit të Lartë që kontribuon në rritjen e mëtejshme të rajonit të Ballkanit Perëdimor (Re@WBC) [http://rewbc.ni.ac.rs/]. Si dhe në implementimin e projekteve të tjera kërkimore [E1.59]. Për të ndërkombëtarizuar kërkimin, UV ka organizuar në numër të konsiderueshëm konferencash kombëtare dhe ndërkombëtare me fokus dhe tematika të ndryshme [E1.31]. UV është përfaqësuar edhe në konferenca ndërkombëtare nëpërmjet prezantimit të punimeve të stafit akademik [E1.73, E1.74, E4.36]. Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet e huaja të arsimit të lartë kanë si qëllim shkëmbimin e përvojës në kërkim, rritjen e kapaciteteve dhe mundësisë në partneritete në projekte [E1.106]. UV organizon takime ceremoniale lidhur me arritjet e tij në fushën e kërkimit shkencor. Takimet cerimoniale janë pjesë e promovimit jo vetëm në fushën e kërkimit shkencor por edhe të arritjeve të institucionit. Festimet për 25 vjetorin e themelimit të UV përfshinë një sërë aktivitetesh. Persona që kanë kontribuar në UV u vlerësuan me çertifikata "Nder i Universitetit" dhe "Mirënjohje e

| |
|---|
| Universitetit" [E1.34]. Në vite jubile UV ka organizuar dhe një sërë konferencash [https://univlora.edu.al/botime-te-ndryshme/]. Punimet kërkimore shkencore të personelit akademik të UV publikohen në revista shkencore ndërkombëtare. Në 2017-2018 stafi akademik i UV ka publikuar 237 artikuj në revista shkencore jashtë vendit, 67 artikuj në revista me faktor impakti dhe 96 artikuj në revista shkencore brenda vendit [E1.73]. |
| **Institucioni përcakton fushat parësore të kërkimit shkencor.** *(Kreu II Standardi I.4)*<br><br>Departamenti dhe grupet kërkimore përcaktojnë prioritetet që ka institucioni në fushën e kërkimit shkencor. UV në përbërje të tij ka 16 departamente të cilat organizohen në grupe kërkimore që përcaktojnë dhe fushat e kërkimit shkencor [E4.37]. Në total në UV ka 27 grupe kërkimore shkencore të organizuara në nivel departamenti, 5 grupe të FE, 10 FSHT dhe 12 FSHH [E4.27]. Fushat dhe prioritetet e kërkimit janë pjesë të strategjisë kërkimore shkencore të departamentit të reflektuara dhe në strategjinë kërkimore të UV [E1.79, E1.80]. UV ndjek një politikë mbështetëse për inovacionet/shpikjet. Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet DPPI dhe UV synon rritjen e zhvillimit në fushën e shkencës dhe teknologjisë dhe inkurajimit të punës shkencore të studentëve dhe stafit akademik për të drejtat që ata gëzojnë mbi punët e tyre [E1.101]. UV favorizon debatin shkencor në fushat parësore të kërkimit shkencor. Fushat e kërkimit dhe grupet e punës përcaktohen në diskutime në departament [E4.38]. |
| **Institucioni zbaton prioritetet kërkimore shkencore.** *(Kreu II Standardi I.5)*<br><br>UV nëpërmjet laboratorëve të tij dhe stafit ndihmës akademik siguron mjetet për zbatimin e prioriteteve kërkimore shkencore të përcaktuara prej tij. Në organikën e tij UV nëpër fakultete ka 25 laboratore me paisje elektronike dhe IT [E2.56, E2.57]. Personeli ndihmës akademik në UV për periudhën 2018-2019 është 80 kurse për periudhën 2016-2017 në UV ka qënë të punësuar 69 veta personel ndihmësademik dhe për periudhën 2017-2018 78 veta [E4.25].<br><br>Çdo anëtar i stafit akademik dhe ndihmës akademik në UV është i pajisur me logjistikën e nevojshme dhe akses në internet për përmbushjen e detyrave profesionale përfshirë dhe punën kërkimore shkencore [E2.57]. Pranë FSHT gjendet QKSH e cila është e pajisur me laboratorë të fushave të ndryshme si kimi, biologji, mjedis, inxhinjeri etj [E2.57]. Strategjia e zhvillimit 2018-2024 e UV synon ofrimin e shërbimeve më cilësore për studentët por edhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet praktikave të mira me rezultate konkrete që përfshijnë rekrutim të stafit akademik me grada dhe tituj apo të diplomuar në Universitete të njohura dhe të vlerësuara ndërkombëtarisht [E1.66]. Në funksion të strategjisë institucionale të zhvillimit, UV rekruton personel akademik të kualifikuar në fushën e kërkimit shkencor. Aktiviteti shkencor dhe studimet e ciklit të III-të janë pjesë e skemës së vlerësimit të kandidatëve për rekrutim [E4.39, E4.40, E4.40a]. Ndërkohë që të paturit e gradës Prof.Dr.,Prof.Asoc., Dr., konsiderohet kriter preferencial në përzgjedhjen e kandidatëve për personel akademik [E4.40b]. Përveç kësaj prioritetet në fushën e kërkimit shkencor gjejnë zbatim dhe në projekte të ndryshme ku UV është partner [https://univlora.edu.al/sektori-projekteve/lista-e-projekteve/] Projekti MARDS është një nga shembujt e mirë pasi synon rindërtim të studimeve të doktoraturës në përputhje me parimet e Salzburgut si krijim të shkollave pilote, të përbashkëta ndërmjet vendeve partnere në projekt. Gjithashtu ky projekt në përputhje me strategjinë e zhvillimit të UV synon të zbusi dhe një pikë të dobët në UV siç është mungesa e programeve në të tre ciklet e studimit. |
| **Institucioni siguron vazhdimësi në fushën e kërkimit shkencor.** *(Kreu II Standardi I.6)* |

| |
|---|
| Prioritetet e kërkimit shkencor janë në fokus të objektivave institucionale të UV. Plani strategjik i zhvillimit të UV 2018-2024 i hartuar bazuar në propozimet e ardhura nga njësitë bazë dhe kryesore synon rritjen e aktiviteteve kërkuese në departamente dhe qendra kërkimore, rritjen e numrit të botimeve shkencore në revista të indeksuara me faktor impakti, nxitje dhe motivim të stafit kërkues në zgjidhjen e problemeve ekonomike dhe sociale të rajonit [E1.55]. Vazhdimësia në fushën e kërkimit shkencor në UV sigurohet në përputhje me kapacitetet e tij. Me vendim të SA stafi akademik i UV ka detyrim që për vitin akademik të botoj një artikull në revistë shkencore dhe të marri pjesë me punim në aktivitete shkencore të tipit konferencë/kongrese. Miratimi i formularit të performancës së stafit akademik ku përfshihet dhe vlerësimi i veprimtarisë kërkimore shkencore të stafit gjithashtu synon sigurimin e vazhdimësisë në fushën e kërkimit shkencor [E2.49a]. Veprimtaria kërkimore shkencore në UV është jo vetëm frut i punës së stafit akademik por edhe i politikës bashkëpunuese me organizma të ndryshëm shkencorë [E1.103, E1.105, E1.106]. Integrimi efektiv i doktorantëve dhe studiuesve të rinj në grupet kërkimore shkencore dhe në projekte [E4.38], zhvillimi i ministudimeve për diplomim kryesisht në ciklin e dytë të studime nga studentët është reflektim i politikës intitucionale për vazhdimësinë në kërkimin shkencor [E4.41]. Nëpërmjet strategjisë së zhvillimit [E1.66] UV angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave rajonale dhe kombëtare. Linja strategjike Nr.1 e Partneritetit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar është reflektim i kësaj politike. Gjithashtu, miratimi i Strategjisë së Ndërkombëtarizimit synon realizimin e objektivave strategjikë për nxitjen dhe mbështetjen e bashkëpunimeve ndërkombëtare në fushën e kërkimit, zhvillimit, zhvillimit dhe transferimit të njohurive dhe teknologjive [E1.57]. Përveç kësaj, institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e personelit akademik që angazhohet në veprimtari kërkimore shkencore [E4.42]. Institucioni për zhvillimin e veprimtarisë kërkimore shkencore i mundëson stafit akademik vitin sabatik. Për periudhën kohore 2017-2020 personeli akademik me vit sabatik është 5-së [E2.21]. Në funksion të nxitjes së rritjes së cilësisë dhe ndërkombëtarizimit të studimeve UV fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik të huaj. Për periudhën kohore 2016-2020 në FSHH, FSHT dhe FE kanë ardhur respektivisht 25. 33 dhe 47 personelë akademik i ftuar [E1.114a, E1.114b, E1.114c]. Ndërkohë që si rrjedhojë e ICM-ve Erasmus+ për periudhën kohore 2018-2019 për mësimdhënie dhe trajnim në UV kanë ardhur 16 lektorë të huaj [E1.63] https://univlora.edu.al/sektori-projekteve/statistika/. Antarësimet e institucionit në rrjete ndërkombëtare universitare dhe organizata të ndryshme synojnë jo vetëm shkëmbimet e stafit mësimdhënës dhe hulumtues por edhe shkëmbimin e studentëve universitarë dhe pasuniversitarë[ https://univlora.edu.al/sektori-projekteve/rrjete-nderkombetare/]. |
| **Institucioni bën të njohura rezultatet në fushën e kërkimit shkencor.** *(Kreu II Standardi I.7)* |
| UV ndjek një politikë mbështetëse për organizimin e seminareve, konferencave, simpoziumeve shkencore, kombëtare dhe ndërkombëtare në financimin që u bën aktiviteteve si kur UV është organizator por edhe bashkëpuntor [E1.31, E4.43]. Politika mbështetëse e institucionit për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor shprehet në mundësinë që i jep stafit akademik për të botuar në buletinin e UV (pa pagesë dhe e aksesueshme nga të gjithë) si dhe në librat e konferencave të organizuara që dalin si edicione speciale të buletinit [E1.31]. Gjithashtu, institucioni mbështet përhapjen e rezultateve kërkimore të studimeve të stafit nëpërmjet financimit të tyre, në formën e konferencave dhe artikujve [E2.20]. UV ndjek një politikë të promovimit të |

kulturës kërkimore në nivel rajonal dhe kombëtar. UV ka qenë dhe është pjesëmarrës në disa projekte ndërkombëtare [E1.59].

**Institucioni ndjek një politikë të vlerësimit dhe transferimit të rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.** *(Kreu II Standardi I.8)*

UV vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor. Emërimi i Zv.Rektorit për kërkimin shkencor dhe zhvillimin institucional dhe emërimet e zv.dekanëve të kërkimit shkencor në nivel njësie bazë janë zbatim i politikave të institucionit për vlerësimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor [E4.44, E4.44a]. Sektori i promovimit akademik dhe botimeve shkencore në UV disponon një bazë të dhënash të kërkimit shkencor të kryer nga stafi akademik. Kjo bazë të dhënash është subjekt i përditësimeve vjetore [E1.31]. Kërkimi është dhe pjesë e analizës vjetore të institucionit [E1.73, E1.74]. UV ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, nëpërmjet organizimit të konferencave dhe mbështetjen financiare të stafit për pjesëmarrje në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare për të prezantuar rezultatet e studimeve të tyre shkencore [E2.20]. Politika e mbrojtjes së pronësisë intelektuale si dhe praktika e mirë në veprimtarinë kërkimore – botuese në UV pasqyrohet në miratimin e disa dokumentave të rëndësishme si: Kodi i Etikës në kërkim, vendimin për standartet që duhet të përmbushin botimet e UV, plagjatura si dhe krijimi i Këshillit të Etikës në Kërkim [E1.38, E2.67, E4.45]. UV ndjek një politikë inkurajuese për kërkuesit e rinj duke i nxitur ata në ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor. Kjo reflektohet në mbështetjen që u jepet studentëve të ciklit të dytë dhe të tretë të studimeve që diplomohen me temë diplome, në organizimin e konferencave studentore nga UV, në pjesëmarrje të studentëve në simpoziume jashtë vendit ku shpenzimet mbulohen nga UV si dhe në trajnimin e kërkuesve të rinj [E4.46, E4.46a]. Studimet e ndryshme shkencore që ndërmerren nga kërkuesit e UV sipas fushave të ndryshme janë dhe frut i bashkëpunimit të institucionit me biznesin vendas dhe të huaj si dhe me faktorët ekonomikë dhe socialë. Marrëveshjet e bashkëpunimit që UV ka me institucione të ndryshme shërbejnë jo vetëm për kryerjen e praktikave mësimore por edhe për zhvillimin e studimeve të ndryshme nga ana e studentëve dhe stafit [E1.103, E1.105]. Veprimtaria botuese shkencore e institucionit është buletini i UV, ku stafi dhe studentët mund të botojnë pa pagesë [https://univlora.edu.al/buletini-shkencor/]. Buletini i UV për t'ju përgjigjur standarteve bashkëkohore ka qënë pjesë e ristrukturimit [E4.47]. Ndërkohë që gjatë kësaj periudhe ka dalë në edicione speciale për konferenca dhe aktivitete të ndryshme të organizuara nga UV [E1.31]. Analizat vjetore në nivel njësie bazë, kryesore dhe institucionale si dhe marrëveshjet për vlerësimin vjetor të punës të stafit akademik janë burimi i informacionit të UV për kërkimin shkencor [E.3.42, E1.93, E1.74]. Kjo shërben jo vetëm për të identifikuar pikat e forta, dobësitë, pengesat por dhe adresimin e tyre.

**Përfundimet dhe Vlerësimi**

UV ka instaluar një sistem efektiv për zbatimin në kushte të përshtatshme të programeve të studimit që ofron. Studentët që kanë shlyer të gjitha detyrimet e një programi studimi pajisen me dokumentin zyrtar që është diploma përkatëse. Programet e studimit në funksion të rritjes së cilësisë janë objekt i përmirësimit të vazhdueshëm duke marrë për bazë vlerësimet e studentëve, nevojat dhe kërkesat e tregut të punës si dhe integrimin efektiv të teorisë me praktikën. Në përmbushje të rekomandimeve të Raportit të Vlerësimit të Jashtëm (Maj 2017), për përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, UV ka instaluar tashmë një skemë efektive nëpërmjet miratimit

të strategjisë së integrimit dhe trajnimit të stafit të ri të rekrutuar dhe strategjisë për trajnimin e vazhdueshëm të kërkuesve të rinj. Gjithashtu, miratimi i udhëzuesit për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve siguron, mbështet dhe inkurajon të mësuarit me studentin në qendër. Edhe pse anonimati zbatohet pjesërisht, studentët vlerësohen drejtë bazuar në qendrueshmërinë dhe transparencën e rregullave. UV ka një strategji të kërkimit shkencor dhe stafit akademik i siguron mundësitë që veprimtaria kërkimore shkencore të kryhet në përputhje me standartet e pranuara kombëtare dhe ndërkombëtare. UV inkurajon frymën e bashkëpunimit në kërkimin shkencor midis stafit, studentëve dhe institucioneve të tjera kërkimore brenda dhe jashtë vendit.

Bazuar mbi analizat dhe evidencat e raportuara në këtë raport, Grupi i Vetëvlerësimit konkludon se standartet per *fushën e mësimdhënies, mësimnxënies, vlerësimit dhe kërkimit plotësohen* **PLOTËSISHT**.

REPUBLIKA E SHQIPERISË - UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

# 5 FUSHAT E VLERËSIMIT: STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| **Studentët: Nga regjistrimi deri te punësimi** |
|---|
| **Institucioni ndjek një politikë korrekte për pranimin e studentëve të rinj.** *(Kreu I Standardi III.1)* |
| UV ndjek një politikë korrekte për pranimin e studentëve të rinj, duke iu referuar kornizës ligjore në fuqi. Krahas kërkesave të përgjithshme, që burojnë prej ligjit dhe akteve nënligjore, UV është përzgjedhës në standardet e pranimit dhe aplikon po ashtu edhe kriteret e propozuara nga njësitë bazë dhe të miratuara me vendim senati [E5.1]. UV ofron programe gjithëpërfshirëse dhe në aplikimin e kritereve është i kujdesshëm që të ofrojë mundësi të njëjta si për studentët tradicional dhe për ata jo tradicional. Ky qëllim theksohet edhe në Statutin [E1.1neni5] dhe Strategjinë [E1.66 fq16] e UV-së. Në kuadër të Strategjisë së Ndërkombëtarizimit [E1.57], UV i ka dhënë rëndësi të veçantë edhe shkëmbimit të studentëve bazuar në programin ERASMUS, duke u vizituar kështu nga një numër i konsiderueshëm studentësh të huaj në cikle të ndryshme studimi, për çdo vit [E1.62], por edhe duke bërë të mundur përfitimin e një eksperience ndryshe për studentët e tij. Përveç studentëve që përfitojnë nga programet Erasmus, një kategori tjetër studentësh janë edhe studentët e huaj apo shqiptarë që kanë përfunduar ose kanë vazhduar studimet në një shtet tjetër. Afrimi i këtyre studentëve bëhet i mundur përmes procedurave të konvertimit të diplomave si dhe mundësisë së ekuivalentimit të lëndëve e parashikuar kjo sipas statutit [E1.1 neni46]. Krahas qëllimit të funksionimit të tij si Institucion Publik i Arsimit të Lartë, të shprehur në Ligjin për arsimin e lartë dhe në Statutin e tij, UV ka hartuar Planin strategjik, i cili paraqet politikat afatmesme bazuar në të cilat do të zhvillohet më tej institucioni. Në këtë plan strategjik është parashikuar se vizioni i ri i UV-së do të jetë jo vetëm ai i një qendër mësimdhënie por si "një pol i rëndësishëm i zhvillimit të territoreve, përmes kërkimit shkencor në përputhje me nevojat e tregut, një bashkëpunimi të ngushtë me të gjithë aktorët publikë dhe private në territor si dhe rritjes dhe zgjerimit të kooperimit ndërkombëtar" [E1.55 fq5]. Në politikat e zhvillimit të UV theksohet rëndësia që ka ofrimi i një ofertë didaktike të larmishme dhe e programeve multidisiplinare që lehtësojnë transferimin e studimeve por edhe mundësi për të ndjekur programe të shumëllojshme studimi të ciklit të dytë dhe të tretë. [E1.66 fq12]. Universitetit Ismail Qemali, ka ngritur Sektorin e Këshillimit të Karrierës Alumnit dhe Aktiviteteve Sportive dhe Kulturore (SKKAAK) [E1.22; E1.85] si një strukturë përgjegjëse për informimin e studentëve të ardhshëm. Cdo vit SKKAAK organizon ditët e hapura me maturantët, e cila ka për qëllim ti informojë ata mbi programet e ofruara nga institucioni si dhe me facilitetet e tjera që UV ofron [E2.29]. Informimi i studentëve të ardhshëm bëhet edhe përmes takimeve informuese që realizohen nga zyra e këshillimit dhe karrierës së bashku me përfaqësues të stafit akademik të njësive bazë, çka i mundëson maturantët të marrin informacionin e nevojshëm mbi programet e ofruara [E2.28a; E2.28b]. Informimi realizohet edhe përmes shpërndarjes së broshurave informuese të cilat paraqesin programet e ofruara nga Institucioni dhe vlerësohen se kanë një impakt më të gjatë në kohë dhe i shërbejnë si material plotësues ditëve të takimeve të hapura [E2.14]. Statusi i studentit në UV fitohet në momentin e regjistrimit të tij. Sapo studenti fiton këtë status, UV menjëherë vë në lëvizje mekanizmat |

pritës dhe integrues për studentit duke i dhënë atij të njëjtin status me atë të studentëve të tjerë. Menjëherë studenti pajiset nga sekretaria mësimore me ID personale të tij. UV organizon takime mirëpritje [E2.28c] me studentët që sapo e kanë fituar këtë status me qëllim orientimin e tyre jo vetëm mbi programet por edhe mbi të gjitha facilitetet që UV ofron. Rregullorja e UV-së [E1.5 neni58] thekson rëndësinë e këshillimit akademik si një rol dhe mision i udhëheqjes profesionale dhe akademike. Në këtë rregullore është parashikuar edhe struktura e Këshilltarit Akademik (KA) [E3.30] pranë çdo departamenti. KA së bashku me përgjegjësin e departamentit kujdesen të realizojnë një takim informues me studentët e rinj, me qëllim informimin e tyre rreth programit por edhe mbi të drejtat që ata gëzojnë me fitimin e statusit të studentit [E1.1]. Studenti menjëherë me përfitmin e këtij statusi ka të drejtën të zgjedhi dhe të zgjidhet në organet përfaqësuese, ka të drejtën të marri pjesë në workshope, trajnime, projekte, në biseda të hapura me stafin akademik, në dhënien e mendimit për çdo vendimarrje që ndikon mbi statusin e tyre si student dhe në aktivitete të tjera që UV. Me qëllim realizimin e politikave të afrimit të maturantëve, UV mban lidhje me Drejtoritë Arsimore Rajonale mbi informimimin e tyre por edhe për realizimin e praktikave profesionale për programet e mësuesisë [E109] Gjithashtu këto lidhje shërbejnë edhe për realizimin e praktikave profesionale dhe punësimin e të diplomuarve. UV ka ngritur struktura të vecanta për pritjen, informimin dhe pranimin e studentëve të rinj. Këto struktura gjenden të vendosura në rektorat dhe pranë njësive bazë. Drejtoria e Komunikimit për ciklin e parë dhe te dytë dhe dy seksionet në varësi të saj; Sektori i kurrikulave dhe shërbimit ndaj studentëve (SKSHS) dhe sektori i Këshillimit, Karrierës,Alumni dhe aktiviteteve kulturore dhe sportive (SKKAAK) janë sektorët kryesorë të vendosur në rektorat që informojnë në plan të parë studentët e interesuar për programet e ofruara nga UV [E1.85] Zyrat kryesore që realizojnë pranimin e studentëve të rinj janë sekretaritë mësimore të cilat janë përgjegjëse për regjistrimin e studentëve në programet përkatëse të studimit, pajisjen e tyre me ID si dhe orientimin e tyre mbi facilitet e tjera që ofrohen [E5.2]. Këshilltari Akademik është një tjetër strukturë informuese dhe orientuese [E3.30]. Në rolin e Këshilltarit akademik është një pedagog i departamentit përkatës, ku studenti është regjistruar. Çdo pedagog ka detyrimin e respektimit të një orari të caktuar pritje me studentët, gjatë të cilit ata mund të kërkojnë informacion apo asistencë jo vetëm në lidhje me kursin përkatës por edhe me programin apo me shërbime të tjera të ofruara nga institucioni [E5.3]. Miratimi i Strategjisë së Ndërkombëtarizimit [E1.57] ka ardhur si rrjedhojë e orientimit të UV-së ndaj një përqasjeje të re, atë të hapjes së institucionit duke lehtësuar mundësinë e përthithjes dhe integrimit të studentëve të huaj, mundësi kjo e parashikuar edhe në Rregulloren e UV-se. [E1.5 neni56]. Në kuadër të kësaj strategjie UV synon të ndjekë një politikë të afrimit dhe mirëpritjes së studentëve të huaj dhe synon nxitjen e mobiliteteve të studentëve të huaj, përmes marrëveshjeve ndërinstitucionale. Kjo arrihet jo vetëm përmes marrëveshjeve të UV-së në kuadër të programeve Erasmus [E1.61], por edhe përmes ofrimit të kurseve në gjuhë të huaj [E1.112] si dhe lehtësimit të procedurave të pranimit dhe integrimit të studentëve të huaj përmes procedurave të njohjes dhe ekuivalentimit të diplomave apo periudha të studimit [E1.62; E3.44; E3.45]. Rregullorja e UV-së, [E1.5 neni83.2] përcakton si detyrim për të gjithë personelin akademik, që për një numër të arsyeshëm orësh, çdo javë duhet të jetë në dispozicion të studentëve për konsultim në zyrën e vet [E5.3]. Pedagogu ka detyrimin ti bëj të njohura këto orare pranë sekretarisë mësimore ose ti komunikojë ato gjatë zhvillimit të kursit. Oraret e pritjes me studentët për cdo pedagog

afishohen në stendën e njoftimeve pranë cdo departamenti si dhe bëhen të ditura edhe nga Këshilltari Akademik. Politikave të pranimit të studentëve i përgjigjet edhe një staf akademik i mirëplanifikuar bazuar në standarde. Qëllimi i UV është të garantojë standarde të larta të mësimdhënies edhe duke patur parasysh raportin student/pedagog. Ky raport për çdo fakultet vijon si në tabelat e pasqyruara [E5.4].

**Institucioni ndjek një politikë të informimit të studentëve dhe siguron komunikimin ndërmjet tyre dhe personelit akademik.** *(Kreu I Standardi III.2)*

Pranimi i studentëve realizohet nga dy struktura kryesore të vendosura në Rektorat dhe nga disa të tjera të vendosura pranë njësive bazë. SKKAAK [E1.85] është zyra që këshillon studentët rreth regjistrimit, të drejtave dhe detyrimeve që u lindin nga përfitimi i statusit të studentit, rregulloren dhe statutin e universitetit, modulet që mund të përzgjedhin, aspektet financiare dhe aktivitet shkencore dhe kulturore brenda UV- së [E5.5]. Sektori i IT-së [E1.85], po ashtu e vendosur pranë Rektoratit është përgjegjëse për krijimin, menaxhimin dhe administrimin e llogarisë personale të çdo studenti prej nga e cila studenti informohet mbi proçesin mësimor [E2.55]. Më tej sekretaritë mësimore janë zyrat që realizojnë regjistrimin dhe informimin e tyre mbi programet e lëndëve dhe aktivitet e tjera që organizohen nga njësia bazë [E5.2]. Po ashtu KA pranë njësive bazë janë subjekte që informojnë dhe mbajnë kontakte me studentët për çfarëdo problemi në lidhje me jetën e tyre studentore si dhe ofrojnë këshillime edhe për programet e studimit [E3.30]. Komunikimi dhe informimi në UV realizohet përmes publikimeve në faqen zyrtare www.univlora.edu.al . Publikimi i dokumentave të rëndësishëm të UV-së si dha aktiviteteve të saj bën më të aksesueshëm informacionin jo vetëm nga stafi dhe studentët por edhe nga të tretët që janë të interesuar të informohen rreth UV-së. Në përpjekje për të rritur aksesin dhe informimin UV është po ashtu aktive edhe në mediat sociale përmes adresave në facebook, twitter dhe instagram. Po ashtu për të gjithe ata që kërkojnë një informacion më zyrtar UV disponon mjete shkresore të komunikimit si dokumentat shkresore të protokolluara [E2.79], si dhe të pajisura me firmën e autoritetit drejtues, vulën dhe logon e Institucionit. Si mjete për të realizuar komunikimin e jashtëm shërbejnë edhe telefonatat, email dhe tele-konferencat. Krahas formave të jashtme të komunikimit edhe mjetet e komunikimit të brendshëm janë të larmishme. Komunikimi i brendshëm mund të realizohet përmes akteve dhe njoftimeve shkresore me shpërndarjen e tyre tek organet, autoritetet drejtuese apo të gjithë personelit akademik dhe administrativ përkundrejt nënshkrimit përkatës mbi marrjen ne dijeni. Komunikimi i brendshëm mund të jetë edhe verbal, për çështje, natyra e të cilave e mundëson këtë lloj komunikimi. Për komunikimin e brendshëm UV përdor edhe komunikimin virtual përmes emailit, njoftimet dhe komunikimet në "Këndin e Njoftimeve" kryesisht për studentët, si dhe përmes faqes zyrtare të UV www.univlora.edu.al [E2.55; E2.79]. Rregullorja e UV-së [E1.5 neni7] përcakton mënyrën e komunikimit të punonjësve të institucionit. Sipas përcaktimeve respektive komunikimi dhe njoftimet e çdo lloji drejtuar personelit akademik dhe personelit të institucionit realizohet edhe përmes postës elektronike zyrtare emër.mbiemër@univlora.edu.al si dhe përmes publikimit në faqen zyrtare të internetit www.univlora.edu.al [E2.55]. Faqja zyrtare dhe adresa elektronike, bazuar në nenin 55 të Rregullores [E1.5], mirëmbahet dhe përditësohet nga Drejtoria e IT-së. Bazuar në nenin 54 të Rregullores së UV-së [E1.5], dosja personale dhe të dhënat personale të çdo studenti administrohen nga sekretaria mësimore, e cila është e detyruar të administrojë dhe përditësojë

vazhdimisht dosjen e çdo studenti nga momenti, që ai merr një status të tillë [E2.79]. Regjistri bazë i studentëve mban të dhënat personale të tyre, vlerësimet e marra gjatë ndjekje së programit të studimit, të dhëna mbi diplomën ose diplomat e marra bashkë me suplementin e diplomës Sekretaria mësimore duhet të bëj një administrim me përgjegjshmëri të kësaj dosje [E2.79] duke marrë në konsideratë detyrimin mbi mbrojtjen e të dhënave personale, bazuar edhe në Rregulloren e Mbrojtjes së të Dhënave Personale [E2.53]. Përveç të dhënave personale të studentit që administrohen nga sekretaria mësimore, disa të dhëna të tjera që lidhen edhe me vlerësimet dhe ecurinë akademike të studentit administrohen nga Drejtoria e IT-së [E2.55]. Sekretaritë mësimore përgjegjëse për administrimin e të dhënave personale të studentit disponojnë adresën elektronike të studentit emër.mbiemër@univlora.edu.al e cila shërben si një formë komunikimi midis institucionit dhe studentit. Por në formularin e regjistrimit [E2.79] të studentit disponohet edhe adresa personale e emailit si dhe numri i telefonit i cili mund të përdoret në raste kur ka nevojë për njoftime urgjente apo nëse studenti nuk e ka marrë njoftimin elektronik.

**Institucioni ndjek një politikë të orientimit dhe këshillimit të studentëve.** *(Kreu I Standardi III.3)*

UV i jep një rëndësi të madhe orientimit dhe këshillimit të studentëve të vet. UV merr përsipër orientimin e studentëve për çdo zgjedhje aspo aplikim që lidhet me programe të tjera studimi. UV synon që studentëve të vet t'ju japi prioritet në vazhdimin e cikleve të mëtejshme të studimit [E5.1]. Për këtë arsye SKKAAK orienton dhe këshillon studentët në aplikimet e tyre për vazhdimin e mëtejshëm të cikleve të tjera të studimit [E5.5]. SKKAAK angazhon studentët në trajnime të shumta dhe ofron informacion mbi mënyrën e përgatitjes për tregun e punës, përgatitjen e CV-së personale, panairet e punës dhe mundësi të ndryshme punësimi, mbi programet e studimit dhe mundësitë për të kaluar nga një program studimi në një tjetër brenda apo jashtë UV-së, mbështetje dhe këshillim për aplikimet për vazhdimin e ciklit të studimit ose të cikleve të tjera të studimit në Institucione të arsimit të lartë jashtë vendit [E2.28]. Në bashkëpunim me Alumnit SKKAAK realizon takime të përbashkëta me studentët e sapodiplomuar për të orientuar ata drejt tregut të punës dhe për të ofruar modele suksesi [E1.92]. Është menduar që orientimi dhe këshillimi i studentëve të realizohet në dy nivele; ajo e SKKAAK në nivel rektorati dhe ajo e KA, në nivel njësie bazë, në mënyrë që struktura e KA të jetë sa më e prekshme nga studentët dhe ti shërbejë përditshmrisë së problemeve studentore, në lidhje me oraret, komunikimin me pedagogët, literaturën e përzgjedhur, aktivitete shkencore dhe informuese që realizon njësia bazë etj [E5.6].
Programet e studimit UV i ka riorganizuar në përputhje me Ligjin e arsimit të lartë Nr. 80/2015si dhe me VKM nr. 41, datë 24.01.2018 "Për Elementët e Programeve të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë". Bazuar në këtë riorganizim programet synojnë adaptimin progresiv të studentit duke ofruar fillimisht lëndë të formimit të përgjithshëm, lëndë ndërdisiplinore si dhe lëndë karakterizuese e lënda plotësuese në përqindjet e përcaktuara në VKM. Kjo i jep mundësinë studentit që kurs pas kursi të formohet në specialitetin e tij [E3.41]. Një ndër format e informimit të studentëve, e përdorur nga strukturat e UV-së është edhe ajo e shpërndarjes së materialeve informuese. SKKAAK pergatit dhe shpërndan broshura informuese për programet e studimit që ofrohen nga UV por edhe për shërbimet e tjera që UV ofron [E2.13]. Po ashtu SKKAAK zhvillon aktivitete të ndryshme informuese me studentët,

ku krahas të qënit pjesmarrës ata pajisen edhe me materialet e nevojshme informuese [E2.11; 2.13]

Bazuar në Nenin 89 të Ligj Nr 80/2015 UV parashikon mundësinë e ndryshimit të programit të studimit përmes proçedurës së transferimeve brenda dhe jashtë institucionit me kushtin, që transferimi të bëhet në programe të përafërta studimi [E1.1 neni28- 30, 56 - 59, E1.5 neni56]. Sipas përcaktimeve që bën Statuti dhe Rregullorja, transferimi në programe të përafërta studimi është i mundur si për studentët brenda UV ashtu edhe në Institucione të tjera të arsimit të lartë. Të drejtën për transferim e kanë vetëm studentët që kanë siguruar të paktën 30 kredite. Proçedura e transferimit realizohet përmes Komisionit Ad' Hoc të ngritur në Rektorat si dhe Komisioneve të ngritura pranë njësive bazë, të cilat kontrollojnë programin dalës të studimit dhe atë në të cilin studenti kërkon të aplikojë. Komisioni i Ekuivalentimit, i ngritur pranë Njësisë Bazë realizon njësimin e lëndëve dhe përcakton detyrimet, që studenti ka për të shlyer. Lista e aplikuesve më pas përcillet sërish në Rektorat dhe miratohet nga Rektori [E3.45]. UV mbështet studentët e tij në të gjitha ciklet e studimeve që ofrohen, duke u dhënë përparësi në ciklin e dytë dhe të tretë të studimit, studentëve të po këtij Institucioni [E3.28]. SKKAAK si dhe KA mbështesin studentët gjatë të gjithë jetës së tyre studentore në UV. Kjo zyrë orienton dhe këshillon studentët përgjatë të gjitha cikleve të studimit, si dhe përgjatë kalimeve nga cikli i parë i studimit në ciklin e dytë dhe të tretë [E5.5]. SKKAAK orienton studentët për daljen e tyre në tregun e punës dhe i ndjek ata edhe pas përfundimit të studimeve [E1.96].

**Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për kategori sociale të veçanta.** *(Kreu I Standardi III.4)*

